



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria –Vlada-Government

Ministria e Ekonomisë dhe Financave
Ministarstvo za Privredu i Finansije
Ministry of Economy and Finance

KORNIZA AFATMESME E SHPENZIMEVE

2011-2013

Qershor, 2010

Lista e shkurtesave

AAC	Autoriteti i Aviacionit Civil
AKK	Agjensioni Kosovar kundër Korrupsionit
AKP	Agjensioni Kosovar i Privatizimit
AKP	Agjensioni Kosovar i Pronave
APK	Agjensioni i Pyjeve të Kosovës
APP	Agjensioni i Prokurimit Publik
ART	Autoriteti Rregullativ i Telekomunikacionit
ASHAK	Akademia e Shkencave dhe e Arteve të Kosovës
ATK	Administrata Tatimore e Kosovës
BDMS	Sistemi i Zhvillimit dhe Menaxhimit të Buxhetit
BKK	Buxheti i Konsoliduar i Kosovës
BPV	Bruto Produkti Vendor
BSL	Ndërtimi i Burgut të Sigurisë së Lartë
CEER	Këshilli i Rregullatorit të Energjisë Evropiane
DD	Departamenti i Drejtësisë
EPK	Ekipet Përgatitor Komunal
ERRE	Asociacioni Regjional i Rregullatorëve të Energjisë
EU	Unioni Evropian
FMN	Fondi Monetar Ndërkombëtar
FSK	Forca e Sigurisë së Kosovës
GJKK	Gjykata Kushtetuese e Kosovës
HVK	Të Hyrat Vetanake të Komunave
ICO	Përfaqësuesi Civil Ndërkombëtar
IGJK	Instituti Gjygjësor i Kosovës
IKAP	Instituti Kosovar për Administratë Publike
IPA	Koordinimi i Programit të Asistencës
KEK	Korporata Energjetike e Kosovës
KGJK	Këshilli Gjyqësor i Kosovës
KKK	Komisioni Kosovar i Konkurrencës
KKTK	Këshilli Kosovar për Trashëgimi Kulturor
KNJ	Komisioni për Ndihmë Juridike
KPI	Agjensioni Kosovar i Pronave
KPM	Komisioni i Pavarur për Media
KPMM	Komisioni i Pavarur i Minierave dhe Mineraleve
KQZ	Komisioni Qendror i Zgjedhjeve
KRPP	Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik
KZPA	Komisioni Zgjedhor për Parashtrësia dhe Ankesa
LFPL	Ligji i Financave të Pushtetit Lokal
LMFPP	Ligji mbi Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësi
MAP	Ministria e Administratës Publike
MAPL	Ministria e Administratës të Pushtetit Lokal
MASHT	Ministria e Arsimit Shkencës dhe Teknologjisë
MBPZHR	Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural
MEF	Ministria për Ekonomi dhe Financave
MEM	Ministria e Energjisë dhe e Minierave
MFSK	Ministria e Forcës së Sigurisë së Kosovës

MKK	Ministria për Komunitete dhe Kthim
MKRS	Ministria e Kulturës Rinisë dhe Sportit
MMPH	Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor
MPB	Ministria e Punëve të Brendshme
MPJ	Ministria e Punëve të Jashtme
MPMS	Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale
MSH	Ministria e Shëndetësisë
MTI	Ministria e Tregtisë dhe Industrisë
MTPT	Ministria e Transportit dhe Post Telekomunikacionit
NSH	Ndërmarrjet Shoqërore
OSHP	Organi Shqyrtues i Prokurimit
PIP	Programi për Investime Publike
PTK	Posta dhe Telekomunikacioni i Kosovës
PVPE	Plani i Veprimt për Partneritet Evropian
QIF	Qendra e Inteligjencës Financiare
QKUK	Qendra Klinike Universitare e Kosovës
RGJM	Rishikimi gjashtëmuor
SEQ	Statistikat Financiare të Qeverisë
TI	Teknologji Informative
TVSH	Tatimi mbi Vlerën e Shtuar
UNMIK	Misioni i Administratës së Përkohshme i OKB-së në Kosovë
UP	Universiteti i Prishtinës
ZAP	Zyra e Auditorit të Përgjithshëm
ZK	Zyra e Kryetarit
ZKM	Zyra e Kryeministrit
ZKTMK	Zyra e Koordinatorit të TMK-së
ZNKE	Zyra Ndërlidhëse e Komisionit të Evropës
ZP	Zyra e Presidentit
ZRE	Zyra e Rregullatorit të Energjisë
ZRP	Zyra e Auditorët të Përgjithshëm
ZRUM	Zyra Rregullative për Ujë dhe Mbeturina

Përmbajtja:

I. KORNIZA MAKRO-FISKALE	1
II. MARRËDHENIET FISKALE NDËRQEVERITARE	24
III. STRATEGJITË E SHPENZIMEVE SEKTORIALE DHE NDËRSEKTORIALE	41
 KORNIZA AFATMESME E SHPENZIMEVE 2011-2013.....	41
 SEKTORI I ZHVILLIMIT EKONOMIK	53
MINISTRIA E TRANSPORTIT DHE POSTË-TELEKOMUNIKACIONIT.....	56
MINISTRIA E TREGTISË DHE INDUSTRIË	61
MINISTRIA E BUJQËSISË, PYLLTARISË DHE ZHVILLIMIT RURAL.....	65
MINISTRIA E ENERJISË DHE E MINIERAVE.....	68
MINISTRIA E MJEDISIT DHE PLANIFIKIMIT HAPSINOR	70
AUTORITETI I AVIACIONIT CIVIL	73
ZYRA RREGULLATORE PËR UJË DHE MBETURINA	75
ZYRA RREGULLATIVE E ENERJISË	77
AGJENCIA KOSOVARE E PRIVATIZIMIT	79
KOMISIONI I PAVARUR PËR MINIERA DHE MINERALE	82
NJËSIA PËR MONITORIMIN E NDËRMARRJEVE PUBLIKE	84
RADIO TELEVISIONI I KOSOVËS	89
AUTORITETI RREGULLATIV I TELEKOMUNIKACIONIT	90
 SEKTORI I ARSIMIT DHE KULTURËS.....	91
MINISTRIA E ARSIMIT SHKENCËS DHE TEKNOLOGJISË	94
MINISTRIA E KULTURËS, RINISË DHE SPORTIT.....	98
UNIVERSITETI I PRISHTINËS	101
AKADEMIA E SHKENCAVE DHE ARTEVE TË KOSOVËS	104
KËSHILLI I KOSOVËS PËR TRASHËGIMI KULTURORE	106
 SEKTORI I RENDIT DHE SIGURISË PUBLIKE.....	108
MINISTRIA E DREJTËSISË.....	111
GJYKATA KUSHTETUESE E KOSOVËS	114
KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS.....	116
INSTITUTI GJYQËSOR I KOSOVËS	118
KOMISIONI PËR NDIHMË JURIDIKE	120
MINISTRIA E PUNËVE TË BRENDSHME	122
MINISTRIA E FORCËS SË SIGURISË SË KOSOVËS.....	125
 SEKTORI I MIRËQENIES SOCIALE DHE SHËNDETËSISË	128
MINISTRIA PUNËS DHE MIRËQENIES SOCIALE	130
MINISTRIA E SHËNDETËSISË.....	133
 SEKTORI I SHËRBIMEVE TË PËRGJITHSHME PUBLIKE.....	136
KUVENDI I REPUBLIKËS SË KOSOVËS	138
ZYRA E PRESIDENTIT	140
ZYRA E KRYEMINISTRIT	142
MINISTRIA E EKONOMISË DHE FINANCAVE.....	144
MINISTRIA E PUNËVE TË JASHTME	147
MINISTRIA PËR INTEGRIME EVROPIANE	150
MINISTRIA PËR KOMUNITETE DHE KTHIM	152

MINISTRIA E ADMINISTRATËS PUBLIKE.....	154
MINISTRA E ADMINISTRIMIT TË PUSHTETIT LOKAL.....	157
ZYRA E AUDITORIT TË PËRGJITHSHËM	159
OMBUDSPERSONI.....	164
SEKTORI I ORGANIZATAVE TË TJERA BUXHETORE TË NIVELIT QENDROR	166
KOMISIONI RREGULLATIV I PROKURIMIT PUBLIK	168
AGJENSIONI KOSOVAR KUNDËR KORRUPSIONIT	170
AGJENSIONI I PROKURIMIT PUBLIK.....	172
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT	174
KOMISIONI KOSOVAR I KONKURENCËS	176
QENDRA INFORMATIVE FINANCIARE	178
AGJENCIONI KOSOVAR I PRONAVE	180
AGJENCIONI KOSOVAR I INTELEGGJENCËS	182
KOMISIONI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA	183
FONDI I RINDËRTIMIT – OBJEKTET E KULTIT.....	185

I. KORNIZA MAKRO-FISKALE

PJESA E PARË

KORNIZA MAKROEKONOMIKE, PRIORITET E POLITIKËS SË QEVERISË DHE PROJEKSIONET FISKALE

Hyrje

Korniza afatmesme e shpenzimeve (KASH) për periudhën 2011– 2013, është përpiluar si vazhdimësi e kornizave të viteve paraprake. Ajo përcakton analizat e mjedisit makroekonomik të Kosovës si dhe prezanton një përmbledhje të burimeve të projektuara që janë në dispozicion për financimin e prioriteteve politike të Qeverisë.

Efektet e krizës ekonomike botërore, në ekonominë e Kosovës ishin relativisht të kufizuara. Tashmë u dëshmuar që viti 2009 u përball me rënie të ndjeshme të dërgesave nga diaspora. Megjithatë, depozitat e sektorit bankar të Kosovës kanë vazhduar të zgjerohen edhe pse shkalla e rritjes së tyre ka qenë më e ulët. Gjatë vitit 2009, eksportet shënuan rënie, mirëpo tashmë ka disa shenja të rikthimit të eksporteve në nivelin e mëparshëm. Përshtypja e përgjithshme është se kombinimi i bazës së ulët të eksporteve, ndikimi i ulët i Investimeve të Huaja Direkte (IHD), sektori relativisht i ri dhe i jo i sofistikuar financiar, së bashku me efektet balancuese të ekonomisë jo-formale dhe ekonomive të vogla ekzistente, kanë kufizuar mekanizmin e transmetimit të krizës përmes së cilit janë afektuar shumë vende të tjera.

Duke pasur parasysh shfrytëzimin e valutës Euro në Kosovë dhe duke mos pasur bankë të zakonshme qendrore ose qasje në instrumentet e politikës monetare, ekonomia mbetet edhe më tutje e rrezikuar lartë nga goditjet e jashtme ekonomike, prandaj situata është monitoruar për së afërmi si nga aspekti i aktiviteteve në sektorin real të ekonomisë po ashtu edhe nga disponueshmëria e likuiditetit.

Parashikimi i tanishëm i KASH-it, supozon rikthim në trendin e mëparshëm rritës të dërgesave nga diaspora, pas rënies së supozuar të tyre prej rreth 10% gjatë vitit 2009. Përveç kësaj, supozohet të ketë rikthim si në nivelin e eksporteve po ashtu edhe në nivelin e investimeve të huaja direkte.

Historiku i Shkurtër Ekonomik

Rritja mesatare ekonomike në Kosovë gjatë viteve 2006-2009 ishte 4.8%. Të dhënat nga vitet e kaluara kanë dëshmuar që vendimi për të rritur nivelin e shpenzimeve publike për më se 120% gjatë vitit 2008 ka qenë shtytësi kryesor i rritjes ekonomike. Për më tepër kjo zhvendosje në nivelin e shpenzimeve publike është dëshmuar të jetë një nxitje në momentin e duhur për ekonominë gjatë vitit 2009, duke ruajtur mundësinë për të gjeneruar rritje ekonomike mbi 4% në kohën kur shumica e vendeve në regjion janë përballur me recesion ekonomik. Pas rritjes së nivelin të çmimeve gjatë vitit 2008, çmimet u ulën gjatë vitit 2009, gjë që ndikoj në

ngritjen e fuçisë blerëse dhe kompensimin e efekteve negative nga rënia e eksporteve dhe financimeve nga jashtë, siç janë Investimet e Huaja Direkte dhe të hyrat nga diaspora (remitancat).

Politikat Qeveritare deri më tani kanë arritur sukses në rritjen e nivelit të shfrytëzimit më efikas të faktorëve të prodhimit në ekonomi. Ndarjet buxhetore për vitet 2008 dhe 2009 kanë qenë të nxitura nga një strategji që në vetvete ka pasur dy qëllime. Nga njëra anë është ofruar një nxitje afatshkurtër përmes efekteve të drejtpërdrejta të projekteve investive, që përfshijnë shfrytëzimin më efikas të faktorëve të prodhimit përmes ndërtimit të infrastrukturës shkollore dhe asaj të rrugëve. Dhe, në të njëjtën kohë është shtruar një bazë e qëndrueshme për ndryshim afatgjatë në rritjen e mundshme ekonomike, çka pritet të çojë drejt një rritjeje të lartë ekonomike në periudhë afatgjate. Megjithatë, Kosova ende përballet me disa probleme ekonomike që vijnë si pasojë e ekzistimit të çekuilibrit në tregun e faktorëve të prodhimit, e që kërkon vëmendje të posaçme. Ky ç'ekuilibër nuk është në kontrollin direkt dhe të menjëhershëm të politikave qeveritare, prandaj duhet të adresohet me një angazhim kolektiv përmes implemmentimit të reformave më se të nevojshme strukturore.

Përkundër një niveli optimal të rritjes ekonomike të arritur gjatë tri viteve të fundit, shkalla e papunësisë në Kosovë vazhdon të mbetet e lartë, për arsye se numri i të rinjve që çdo vit hyjnë në tregun e punës është dukshëm më i lartë se sa ai i shteteve në rajon. Vlerësohet se numri i njerëzve të rinj të cilët futen në tregun e punës për çdo vit është aq i lartë sa që rritja reale ekonomike prej së paku 7.0 përqind në vit do të nevojitej vetëm sa për të filluar me absorbimin e tyre dhe për ti kontribuar zvogëlimit të pjesës ekzistuese të të papunëve. Për më tepër, një performancë e tillë e rritjes së lartë ekonomike do duhej të mbahej për vite me radhë. * Me qëllim të arritjes së shkallës së dëshiruar të rritjes ekonomike Qeveria duhet të vazhdojë me fokusin e saj aktual të orientimit të buxhetit drejt investimeve kapitale. E rëndësisë së posaçme është bashkëpunimi në mes të Qeverisë dhe sektorit privat drejt udhëheqjes së reformave strukturore, që do të shpie drejt përshtatjeve në tregun e punës dhe në të njëjtën kohe do të krijoj vende të mjaftueshme të punës për të absorbuar edhe të rinj që hyjnë në tregun e punës edhe punëkërkuessit aktual, gjë që do të çojë drejt uljes së normës së papunësisë .

Përveç këtij disporporcioni në tregun e punës, shihet edhe një mospërputhje e mëtutjeshme në bilancin tregtar të mallrave dhe shërbimeve, i cili është rreth 40 përqind e BPV-së. Dihet mirë se baza konkurruese e ekonomisë ka qenë e ndikuar nga prezenca e donatorëve dhe të hyrat nga diaspora. Veç kësaj, gjatë nëntë viteve të shkuara, sektori publik ka qenë forca shtytëse e ekonomisë.

Nevojë thelbësore tani është prezantimi i politikave që do të fillojnë me adresimin e këtyre disporporcioneve dhe që do të krijojnë kushte që do ta inkurajojnë sektorin privat, pasi që ky do të jetë burim i kryesor i vendeve të reja të punës. †

Veç kësaj, ekzistojnë disa kufizime të cilat parandalojnë realizimin e procesit të rritjes së qëndrueshme ekonomike. Rëndësi parësore këtu ka energjia që aktualisht krijon situatë të pafavorshme si për prodhuesit vendor ashtu edhe për investuesit potencial të huaj. Strategjia e

* Shih “ Tregun e Punës në Kosovë: Një Projekt i Marrëdhënies në mes të Rritjes së GDP-së dhe Papunësia” Buletini Makroekonomik [], Ministria e Ekonomisë dhe Financave, Kosovë

† Analizat Interne nga departamenti i Makroekonomisë në MEF sugjeron se gjatë gjashtë viteve të kaluara, përmirësimet *kumulative* në konkurrueshmëri (norma efektive reale e këmbimit) ka qenë e ulët prej vetëm 11.0 përqind. fuçisë dhe efekt të padëshiruar të rezervimit të rregullimet me të cilat duhet të përballet.

energjisë është finalizuar dhe implemtimi i saj është kyç për arritjen e qëllimeve ekonomike dhe realizimit të potencialit rritës të Kosovës.

Parimet Kryesore të Politikës

Prioritetet strategjike të Qeverisë të përfshira në Kornizën Afatmesme të Shpenzimeve 2011-2013 synojnë të sigurojnë bazën për zhvillim të qëndrueshëm të Republikës së Kosovës brenda periudhës së ardhshme afatmesme .

Republika e Kosovës ka perspektive të qartë të anëtarësimit në BE ndërsa ky është angazhim dhe prioritet i Qeverisë. Anëtarësimi në BE në një periudhë sa më të shkurtër dhe në kuadër të procesit dhe instrumenteve të para-anëtarësimit është bindje dhe orientimi i popullit të Kosovës. Populli i Kosovës dhe institucionet janë të gatshëm të punojnë shumë drejt arritjes së këtij synimi ndërsa që Qeveria e Kosovës është e përkushtuar të ndërmarrë të gjithë hapat e nevojshëm për përmbushjen e obligimeve të veta me qëllim të arritjes së këtij objekti madhor.

Për shkaqe të ditura Kosova tani përballet me sfida të shumta ekonomike, me një nivel shumë të lartë të deficitit tregtar që arrin mbi 40% të BPV-së, me shkallën më të lartë të papunësisë në rajon dhe me shifra të larta të varfërisë. Prandaj në vazhdimësi është kërkuar mbështetja ndërkombëtare në përkrahje të prioriteteve tona, në arritjen e qëndrueshmërisë si në aspektin ekonomik po ashtu edhe në atë politik.

Megjithatë, gjatë këtyre viteve të fundit, Kosova ka shënuar një numër të zhvillimeve pozitive. Në sferën e ekonomisë këto zhvillime lidhen me reformën e sistemit tatimor, rritjen e investimeve kapitale si dhe kapaciteteve për ekzekutimin e tyre, anëtarësimin e Kosovës në institucionet ndërkombëtare siç janë Banka Botërore dhe Fondi Monetar Ndërkombëtar, zgjerimi dhe stabiliteti i sektorit bankar etj. Të gjitha këto zhvillime që kanë ndodhur kanë rezultuar në rritje pozitive ekonomike gjatë këtyre viteve, ku duhet veçuar vitin 2009, ku përkundër efekteve të krizës ekonomike globale, Kosova arriti të shënoi një rritje ekonomike pozitive prej 4.4%.

Procesi i prioritizimit të politikave

Përmbushja e prioriteteve strategjike të Qeverisë, do të shpije drejt zbatimit të politikave të definuara sektoriale si dhe drejt zhvillimit dhe zbatimit të legjislacionit. Prioritetet dhe politikat sektoriale duhet të respektojnë kufijtë e shpenzimeve që rezultojnë nga projeksionet e të hyrave në KASH si dhe zotimet për mbështetje nga donatorët.

Rezultati final i këtyre politikave sektoriale do të shihet në implementimin e projekteve specifike përmes planeve vjetore të shpenzimeve të ministrive dhe institucioneve tjera, përmes procesit buxhetor i cili do të mbështetet po ashtu edhe përmes Programit të Investimeve Publike (PIP).

Politikat prioritare

Qeveria është e bindur se implementimi i prioriteteve të përcaktuara më poshtë, do të krijojë parakushtet për rritje të qëndrueshme ekonomike, përmirësojë mjedisin përbrenda të cilit

zhvillohen aktivitetet e shtuara të sektorit privat, përmirësojë pozitën e qytetarëve dhe gjithë kjo do të kontribuojë procesit të integritit evropian të Kosovës.

Rritja ekonomike

Në mënyrë që Republika e Kosovës të arrijë dhe të ruaj nivelet e rritjes ekonomike të cilat janë tipike për rajonin, duhet të ndërmerren reforma dhe përshtatje në politikat sektoriale. Me qëllim të mbajtjes dhe zhvillimit të këtyre trendëve, në kuadër të politikave sektoriale do të punohet në drejtim të eliminimit të mëtejme të barrierave dhe faktorëve të cilët mund të pengojnë zhvillimin ekonomik.

Kosova ka trashëguar një sistem të amortizuar dhe të pazhvilluar të rrjetit të transportit. Edhe përkundër investimeve substanciale në vitet e fundit, investimet e mëtutjeshme në fushën e transportit janë të domosdoshme për përmirësimin e rrjetit të transportit.

Investimet në këtë sektor krijojnë lidhje më të mira me rajonin dhe gjerë dhe janë faktorë ndikues në rritjen ekonomike të Kosovës. Për këtë qëllim Kosova duhet të përmirësojë rrjetin e saj të transportit me përqendrim të veçantë në projektet nacionale. Në këtë drejtim, lidhjet më të mira me korridoret pan-evropiane VIII (përmes auto-rrugës Morinë - Merdare) dhe korridorit X (Prishtinë – Shkup) janë prioritet të qarta të Kosovës.

Nevojat aktuale dhe afatmesme të Kosovës për furnizim me energji elektrike janë më të larta se mundësitë aktuale të furnizimit. Ngritja e kapaciteteve të furnizimit me energji elektrike është katalizator i rritjes së vazhdueshme ekonomike dhe është faktor i rëndësishëm i cili ndikon në rritjen e sigurisë së investimeve vendore dhe të jashtme. Furnizimi i sigurt me energji elektrike është një nga objektivat tona parësore. Kjo do të arrihet përmes reformave, privatizimin dhe ndërtimit të burimeve të reja të energjetikës.

Më shumë se 50 përqind e popullatës në Kosovë janë nën moshën 25 vjeçare, dhe më shumë se 75% janë më të rinj se 35 vjeç. Nga aspekti krahasues, Kosova ka fuqinë më të re punëtore në rajon dhe më gjerë. Ky potencial i madh paraqet mundësi të reja të shfrytëzimit të resurseve të Kosovës për të tërhequr investime dhe si rezultat për të pasur një rritje të qëndrueshme ekonomike. Evitimi i pengesave të identifikuar dhe ngritja e cilësisë së edukimit dhe ngritja e shkathtësive bazuar në kërkesat e tregut janë faktorë të cilët ndikojnë në rritjen e kapaciteteve ekonomike të Kosovës. Qeveria e Republikës së Kosovës është e përkushtuar në përkrahjen dhe zhvillimin e programeve në sektorin e arsimit, të cilat synojnë ngritjen e cilësisë së arsimit dhe përshtatjen e tij konform nevojave të tregut.

Sistemi juridik i Republikës së Kosovës bazuar në Kushtetutë është unik megjithëse është tërësia e akteve juridike të cilat shpeshherë nuk janë në përputhje dhe konsistentë me njëra tjetrën. Për më tepër mekanizmat institucionale të zbatimit të ligjit vazhdojnë të jenë në proces të ngritjes së funksionalitetit dhe efikasitetit të tyre, pasi që këto institucione vazhdojnë të ballafaqohen me sfida të shumta.

Funksionimi i institucioneve të zbatimit të ligjit dhe krijimi i një sistemi të parashikueshëm ligjor janë katalizatorë të krijimit të një klime të favorshme për investime dhe rritje ekonomike. Investuesit e jashtëm dhe të brendshëm kërkojnë një mjedis ligjor të qartë dhe të parashikueshëm. Prandaj, sundimi i ligjit nga Qeveria shihet si çelës për integrimin më të shpejtë me Evropë dhe për tërheqje të investimeve në Kosovë.

Ne zotohemi gjithashtu për krijimin e një mjedisi të favorshëm dhe konkurrues për investime. Reforma fiskale e ndërmarrë në vitin 2009, do të kompletohet edhe me plotësime shtesë në këtë fushë.

Tash për tash Kosova karakterizohet me një nivel të lartë të ekonomisë jo formale e cila sipas hulumtimeve shkon prej 26-34% të BPV-së*. Kjo gjendje është si pasojë e një periudhe të gjatë të funksionimit ekonomik paralel dhe jo strukturor. Ndikimet e saj prekin çdo aspekt të rregullimit socio-ekonomik në Kosovë. Prandaj, Luftimi i ekonomisë jo formale është kusht themelor për mbarëvajtjen dhe për të siguruar një cikël të vazhdueshëm të zhvillimit ekonomik si dhe të barazisë sociale në vend. Andaj Qeveria është e angazhuar për të vazhduar reformat në këtë fushë. Implementimi i projektit për pajisjen e të gjitha bizneseve me Arka Fiskale pritet të implementohen në tërësi gjatë tre viteve vijuese.

Qeverisja e mirë

Objektiva strategjike e Qeverisë është krijimi i një administrate efikase, profesionale, transparente në pajtim me parimet demokratike dhe e orientuar drejt ofrimit të shërbimeve sa më të mira për qytetarët. Reforma e administratës publike është një përkushtim i vazhdueshëm i Qeverisë së Republikës së Kosovës i zbatuar përmes një procesi dhe kornize të definuar të planifikimit strategjik që ndër të tjera i kontribuon edhe zbatimit të obligimeve që dalin nga Partneritetit Evropian për Kosovën.

Financat publike janë të definuar dhe të rregulluara përmes sistemit të aranzhimeve financiare të sektorit publik, në bazë të praktikave më të mira. Të gjitha të hyrat e buxhetit dhe shpërndarja e tyre janë të kanalizuar përmes “Llogarisë së vetme” të Thesarit, ndërsa kontrolli i menaxhimit të financave publike bëhet nga ana e sistemit të auditimit dhe raportimit i cili është bazuar në bazë të praktikave më të mira ndërkombëtare dhe Evropiane. Megjithatë, sistemi kërkon përmirësim dhe jemi të vetëdijshëm për sfidat para nesh. Jemi të përkushtuar të vazhdojmë me sukseset e arritura deri tani dhe të adresojmë mangësitë e identifikuar në Vlerësimin Financiar dhe të Shpenzimeve Publike (PEFA) përmes planit të Planit i Veprimit për Reformën në Menaxhimin e Financave Publike.

Ne e kuptojmë mirë që kapaciteti ynë për shpenzime të ndarjeve buxhetore të aprovuara ka nevojë të përmirësohet tutje. Ky kapacitet aktual për shpenzime është rezultat i shumë faktorëve që tashmë janë identifikuar. Pra, menaxhimi i financave publike me theks të veçantë në politikat e prokurimit publik do të jenë në fokus të punës tonë.

Sigurimi i mbështetjes nga donatorët, që krijon bazë për rritje ekonomike është një faktor mjaft i rëndësishëm. Deri me tani Kosovës iu është ofruar një asistencë të konsiderueshme teknike nga ana e donatorëve (vlerësohet se rreth 80 për qind e ndihmës aktuale shkon për asistencë teknike). Kjo formë e ndihmës nga donatorët është e mirëseardhur, megjithatë konsiderojmë se ndihma e huaj duhet të orientohet më tepër në përkrahje të prioritetëve tona qeveritare dhe përmes sistemit tonë qeveritar. Për të realizuar këtë ne jemi të përkushtuar të ngrisim llogaridhënien dhe kapacitetet tona administrative.

Luftimi i korrupsionit do të vazhdojë të jetë një nga prioritetet e Kosovës në funksion të zbatimit të ligjit dhe në kuadër të kornizës së përcaktuar me Strategjinë Kundër-Korrupsion

* Studim mbi shtrirjen dhe parandalimin e ekonomisë jolegale dhe pastrimin e parave në Kosovë, Studim i realizuar nga Projekti i Komisionit Evropian.

dhe paraqet njërin nga parakushtet e integritit të evropian përmes prioriteteve të partneritetit Evropian për Kosovën.

Kohezioni social

Edhe përkundër angazhimeve të vazhdueshme të Qeverisë dhe ndarjes së një përqindje që përfshin rreth 15 % e buxhetit për përkrahje të shtresave sociale, niveli i përkrahjes së shtresave të ndryshme sociale është i ulët gjë që ndikon në moszgjidhjen e problemeve të trashëguara në sferën sociale.

Shkalla e lartë e papunësisë ndikon drejtpërdrejtë në problemet sociale me të cilat ballafaqohet Kosova. Nga analizat vërehet se pensionet në Kosovë janë më të ulëta se ato në rajon, kurse treguesit shëndetësor në krahasim me vendet tjera janë më të dobët që sjellin deri te një situatë e pafavorshme për kategorinë e pensionistëve. Kategoria e pensionistëve është njëra ndër kategoritë e cila do të trajtohet me kujdes në kuadër të prioriteteve qeveritare. Avancimi i politikave sociale mbetet përkushtim dhe prioritet i vazhdueshëm i Qeverisë së Republikës së Kosovës i përfshirë edhe në Planin e Veprimit për Partneritet Evropian dhe aktivitetet përcjellëse të tij qoftë të karakterit të politikave apo legjislativ.

Përbrenda një kornize të qëndrueshme fiskale të prezantuar në KASH, Kosova është e përkushtuar në zhvillimin dhe analizimin e opsioneve më të mira për përmirësim të kushteve për personat në pozitë më të pafavorshme. Me qëllim të adresimit më të mirë të këtyre kategorive në periudhën afatmesme është paraparë një përkujdesje më e mirë për Invalidët e Luftës, Pensionistët kontributpages, si dhe një rritje e përkrahjes për të gjitha kategoritë tjera sociale.

Marrë parasysh shkallën e problemit, përmirësimi i përgjithshëm i politikave sociale dhe zbatimi efikas i tyre është një prioritet i përhershëm në periudhën afatgjate për Qeverinë. Prandaj synimi ynë është të punojmë ngushtë me partnerët tanë ndërkombëtarë në zhvillimin e reformave strukturale për përmirësim të treguesve socialë.

Përmbledhje e projeksioneve të KASH-it, skenari bazë

Projeksionet makro-fiskale për vitet 2011-2013 përfshijnë parashikimet e paraqitura më poshtë dhe synojnë të paraqesin skenarin bazë përfaqësues i cili përfshijë projektin madhor për autostradën. Projeksionet makro-fiskale marrin parasysh përmirësimin e konsiderueshëm në efikasitetin e ekzekutimit të shpenzimeve të Qeveritare. Po ashtu, këto projeksione marrin parasysh kthimin pozitiv në të hyrat të cilat pritet të rezultojnë nga investimet e konsiderueshme të cilat janë projektuar përgjatë periudhës afatmesme.

Tabela e mëposhtme paraqet përmbledhjen e projeksioneve afatmesme fiskale dhe masat e nevojshme për financimin e kësaj kornize të shpenzimeve.

Tabela 1. Përmbledhje e Projekcionit Fiskal Afatmesëm, 2009-2013, në miliona euro

Përshkrimi	2009	2010	2010	2011	2012	2013
	Aktuale	Buxheti fillestar	Buxheti i rishikuar	Proj	Proj	Proj
1. TE HYRAT E PERGJITHSHME	1,146	1,029	1,106	1,150	1,263	1,356
2. SHPENZIMET E PERGJITHSHME	1,110	1,157	1,254	1,423	1,523	1,571
3. DEFICITI PRIMAR	36	-127	-148	-273	-260	-215
4. PAGESA E INTERESIT (Borxhi i jashtëm)	1	15	10	10	11	16
5. KREDITË PER NDERMARRJET PUBLIKE	79	70	60	45	0	0
6. DEFICITI/SUFICITI I PERGJITHSHEM	-44	-212	-218	-328	-271	-231
7. FINANCIMI	-87	212	218	328	271	231
8. GJENDJA E BILANCIT BANKAR	342	210	243	356	256	209
9. PRAGU I NEVOJSHEM I BILANCIT PANKAR	200	200	241	354	309	343
10. BOSHLLIEKU FINANCIAR ("-" mnusi nenkupton suficit	0	0	-2	-2	53	134

Burimi: Departamenti i Makroekonomisë, MEF

Kategoritë e paraqitura në tabelën më lartë do të shtjellohen më hollësisht në sektorin fiskal të KASH, ndërsa më poshtë është paraqitur një shpjegimin i shkurtër i supozimeve kryesore makro fiskale.

○ Programi i Fondit Monetar Ndërkombëtar (FMN-së)

Korniza e paraqitur makro-fiskale përmban vlerësime që kanë rezultuar nga marrëveshja e Qeverisë së Republikës së Kosovës me FMN-në. Procesi i planifikimit të kësaj kornize ka ngërthyer në vete dëshirën për të implementuar një plan ambicioz zhvillimi dhe në të njëjtën kohë vëmendjen për të siguruar qëndrueshmërinë e një plani të tillë duke minimizuar rreziqet që e përcjellin. Kjo do të thotë se shpenzimet e planifikuara është dashur të përzgjidhen në bazë të kriterit të prioritetëve të përcaktuara nga Qeveria. Po ashtu, kjo kornizë ishte bazë për fillimin e programit të parë në mes Qeverisë së Kosovës dhe FMN-së. Ky program do sigurojë përkrahje financiare në vlerë prej €106 milion për ruajtjen e qëndrueshmërisë fiskale. Programi do jetë çelës për rimbursimin e përkrahjes së premtuar buxhetore nga donatorët në vlerë prej €210 milion gjatë tre viteve të ardhshme. Por, mbi të gjitha, ky program do ngrit kredibilitetin e politikave Qeveritare, kredibilitet ky esencial për të siguruar implementimin e Kornizës së paraqitur.

○ Projekcioni i të hyrave

Projeksionet e të hyrave të prezantuara në KASH për vitet 2011-2013 janë të bazuara në skenarin makroekonomik i cili është ndërtuar duke supozuar vazhdimësinë e performancës së mëparshme pozitive të agjensioneve që janë përgjegjëse për grumbullimin e të hyrave, vazhdimësinë e politikave aktuale të Qeverisë, implementimin e projektit të autostradës dhe financimin shtesë për përmirësimin e mirëqenies sociale. Është supozuar se politike e re kryesore në ndryshim nga KASH-i i kaluar është vendimi për të ndërtuar autostradën, çka do të siguroj një stimulim për ekonominë, e që do të reflektohet gjithashtu edhe në nivelin e të hyrave.

○ **Efektet e autostradës në totalin e shpenzimeve publike**

Korniza makro-fiskale parasheh ndërtimin e autostradës Merdare- Morinë për periudhën e planifikuar 2011-2013. Projekti është vlerësuar të ketë një rëndësi kyçe në rigjallërimin e ekonomisë, meqë ai nxit integrimin dhe përmirëson konkurrueshmërinë e ekonomisë së Kosovës. Qeveria e Kosovës ka nënshkruar kontratën me konzorciumin ndërkombëtar, përmes së cilës kontratë sigurohet që projekti do implementohet duke shfrytëzuar maksimalisht resurset vendore.

Projekti do të financohet përmes tri burimeve kryesore: rialokimit të buxhetit, të hyrave nga privatizimi, si dhe më vonë nga huamarrja. Për shkak të implikimeve financiare dhe kthimeve të pritura, vlerësohet se ky projekt të siguroj bazën për një zhvendosje pozitive në trendin e rritjes ekonomike; së pari duke ofruar nxitje reale për sa i përket formimit të kapitalit dhe më vonë duke siguruar infrastrukturë më kualitative. Vlerësimet e Ministrisë së Ekonomisë dhe Financave sugjerojnë se implementimi i projektit të autostradës do të ngrit rritjen e normës së BPV-së me përreth 1.5%, duke krahasuar me skenarin bazë i cili parasheh implementimin e të gjitha politikave dhe projekteve tjera duke përfshirë vetëm projektin për ndërtimin e autostradës.

○ **Ndryshimet në Shpenzimet Rrjedhëse**

Që nga viti 2008, Qeveria ka përpiluar dhe implementuar politika që kanë për synim stimulimin e rritjes së BPV-së përmes investimeve publike, ndërsa që në të njëjtën kohë Qeveria ka qenë e matur ndaj kërkesave sociale që rrjedhin e zhvillimit të dëshiruar ekonomik. KASH për vitet 2011-2013, në përputhje me prioritetet afatmesme të Qeverisë, parasheh shpenzime shtesë rrjedhëse që duhet të adresojnë nevojat sociale të menjëhershme të qytetarëve të Kosovës. Këto shpenzime shtesë nevojiten për të mbështetur politikat e reja të cilat do të akomodonin më mirë nevojat sociale, do të siguronin qeverisje dhe shërbime publike më të mira, ndërsa nuk do të rrezikonin qëndrueshmërinë fiskale të kornizës.

Gjatë periudhës së KASH-it për vitet 2011-2013, pritet të aprovohen dhe implementohen ligje dhe politika të reja për të adresuar nevojat e lartpërmendura. Në këtë mënyrë, kjo kornizë makro-fiskale e është rifreskuar për të përfshirë mbështetjen shtesë financiare për vendimet siç vijojnë: implementimi i Ligjit për Martirët e Luftës dhe Ligjit të Policisë që përfshijnë përfitime më të larta për invalidët e luftës dhe paga më të larta për policinë; aprovimin e Ligjit mbi Pensionet dhe Shërbyesve Civil, të cilat ligje përfshijnë diferencimin e nivelit të pensioneve /rrogave; dhe aprovimin e Ligjit të Punës.

○ **Dividenda nga PTK-ja dhe Aeroporti**

Së bashku me të hyrat e rregullta, një pjesë e financimit të autostradës Merdare-Morinë që është kërkuar të financohet nga buxheti i Qeverisë, do të mbështetet nga dividendat e jashtëzakonshme nga PTK dhe Aeroporti, dy ndërmarrje publike ku Qeveria e Kosovës është pronare e të gjitha aksioneve. Duhet të bëhet me dije se këto të hyra në vlerë prej €85 milion t do të jetë të disponueshme vetëm për vitin 2010, meqë është parashikuar se pronësia e këtyre kompanive ose do të transferohet ose do të ndahet me investitorët e sektorit privat.

○ **Huamarrja**

Huamarrja për financimin e projektit të autostradës mbetet si mundësi e fundit në listën e burimeve të financimit për këtë projekt. Për më shumë, siç mund të shihet edhe në shpjegimin e pjesës së financimit, është bërë përpjekje që në rast nevojë një veprim i tillë të fillojë pas vitit 2011. Kjo sepse, programi me FMN-në do ngriste besueshmërinë e kreditorëve në qëndrueshmërinë fiskale dhe financiare të Republikës së Kosovës, çka edhe do mundësonte marrjen e kredive me kushte shumë më të përshtatshme. Është lënë me qëllim si veprim opcional, sepse nevoja ose jo për hyrje në kredi do varet nga aftësia e qeverisë për ngritur kursimet brenda buxhetore, si dhe nga faktorët e jashtëm që ndikojnë ekonominë kosovare.

○ **Interesi dhe Amortizimi i Borxhit të Trashëguar**

Në krahasim me parashikimet e mëparshme, KASH (2011-2013) siguron vlerësime më të sakta mbi obligimet e ardhshme rreth servिसimit të borxhit. Plani i amortizimit të borxhit të trashëguar është përdorur për alokimin e servिसimit të borxhit në të ardhmen. Duhet të theksohet se një pjesë e borxhit është paguar me mbështetjen nga jashtë. Praktika e planifikimit përmes ndarjes së parave (një llogari të besueshme) për servिसimin e borxhit të jashtëm, është braktisur në prani të një plani specifik të amortizimit.

○ **Të hyrat nga privatizimi i ndërmarrjeve publike**

Me përfshirjen e projektit të autostradës në kornizën makroekonomike si dhe me synimin e adresimit të nevojave sociale, gjenerohet një boshllëk i madh i financimit. Megjithatë, qëndrueshmëria e kësaj kornize është siguruar me financimin e shpenzimeve të jashtëzakonshme përmes të hyrave të jashtëzakonshme që rrjedhin nga proceset e privatizimit. Qeveria e Kosovës tashmë ka kontraktuar një kompani këshilluese (këshilltarët e transaksionit) për analizimin e opsioneve rreth pjesëmarrjes së sektorit privat në PTK dhe KEK. Procesi është në progres dhe në pajtim me planin e paraparë, PTK pritet të privatizohet deri në fund të vitit 2010.

○ **Kredia e KEK –ut dhe mbështetja ndaj energjisë**

KASH për vitet 2011-2013, parashihet përfshirjen e investitorëve privat në KEK. Me qëllim të evitimit të problemeve eventuale në realizimin e projekteve të nisura në këtë kompani Qeveria ka paraparë reduktim të kredisë së KEK-ut në 45 milion për vitin 2011, që do të jetë viti i fundit i kreditimit të KEK-ut. Për më tepër, subvencionet për familjet të cilat nuk janë në gjendje të paguajnë faturat e energjisë elektrike do të mbahen përgjatë periudhës së projekcionit.

○ **Rezerva për Stabilitet**

Qeveria e Kosovës është zotuar të ruaj rezervën për stabilitet fiskal në atë nivel që është konsideruar të jetë i mjaftueshëm për të menaxhuar riskun e likuiditetit sistematik dhe për të siguruar menaxhimin e duhur të parasë së gatshme të Buxhetit të Qeverisë. Kosova është ekonomi e eurozonës prandaj veprimet e matura janë thelbësore në përcjelljen e politikës fiskale. Mbajtja e rezervës për stabilitet është e rëndësishme si për kredibilitetin e politikave po ashtu edhe për ekonominë në tërësi.

○ **Bilanci Fiskal dhe Boshllëku i projektuar i financimit**

Korniza fiskale e përdorur për hartimin e këtij KASH-i është përpiluar për të adresuar prioritetet kryesore të përcaktuara nga Qeveria e Kosovës. Nëse planet e shpenzimeve të përpiluara për të adresuar këto prioritete do të ekzekutoheshin komplet, atëherë mesatarja e deficitit të përgjithshëm do të jetë -5.0% e BPV-së së planifikuar. Boshllëku i projektuar financiar do të ngushtohet në një nivel të pranueshëm dhe të përgjegjshëm fiskal përmes financimit të siguruar nga bilanci i akumuluar i parasë së gatshme, nga proceset e privatizimit, mbështetja e pritshme buxhetore dhe nga huamarrjet e jashtme nga institucionet ndërkombëtare financiare.

Korniza Makrofiskale 2011-2013

Korniza Makrofiskale e shtjelluar në këtë seksion është planifikuar duke shfrytëzuar modelin makroekonomik të Ministrisë së Ekonomisë dhe Financave, i cili model është përdorur që nga viti 2006 për parashikimin ose planifikimin e treguesve kryesor makroekonomik. Skenarë të shumta makroekonomike janë zhvilluar si parashikime të KASH-it për vitet 2011-2013, me skenarin e fundit bazë, i cili është zgjedhur si skenar gjithëpërfshirës, brenda së cilës kornizë të gjitha vendimet mbi politikat ekonomike janë konsistente.

Projekti i autostradës tashmë është përfshirë në kornizë si politikë e re e cila ka efektin më të madh në treguesit makroekonomik, krahasuar me ata indikatorë të cilët janë planifikuar me kornizat paraprake makroekonomike. Përveç ndërtimit të autostradës, ekzistojnë edhe katër supozime bazë afatgjate që janë të përfshira në këto projeksione:

- Politikat pro-tregut do të sjellin më shumë të hyra në ekonomi;
- Një proces i zgjerimit të ekonomisë formale do të mundësojë një mjedis më të mirë për investime private;
- Finalizimi i procesit të privatizimit do të kontribuojë në ringjalljen e shumë ndërmarrjeve brenda sektorit privat;
- Ekziston një mundësi e rritjes së eksportit për shkak të bazës së ulët ekzistuese, krijimit në vazhdimësi të marrëveshjeve të tregtisë dhe trendit të para-krizës.

Në bazë të këtyre parashikimeve, konsumi i planifikuar, investimet private dhe publike, të gjitha këto pritet të rriten duke u pasuar nga rritja e të hyrave nga jashtë siç janë transferet neto dhe Investimet e Huaja direkte.


Sektori Real

Projeksionet e fundit makroekonomike sugjerojnë se rritja mesatare reale e BPV-së përgjatë periudhës së planifikuar 2011-2013 pritet të jetë 5.6%. Grafiku i paraqitur më poshtë tregon kontributin e çdo komponenti të BPV-së në normën reale të rritjes ekonomike. Ngjashëm me vitet paraprake, pritet që fillimisht konsumi të sigurojë kontributin më të madh në rritjen reale të BPV-së, sidomos në vitin 2010 dhe 2011, por duke filluar nga viti 2012 pritet që konsumi të shënojë rënie graduale si shtytës kryesor i rritjes ekonomike, duke u zëvendësuar me komponentë tjerë si investimet dhe eksportet. Investimet do të jetë kontribuuesi i dytë më i madh dhe në periudhën afatmesme, ku pritet ngritje më e lartë efektive gjatë viti 2011 për

shkak të ngritjes së shkallës së implementimit të projektit të autostradës. Ngritja e parashikuar në veçanti e shpenzimeve kapitale dhe koncentrimi i këtyre shpenzimeve në projekte të mëdha parashihen të jetë një ndër shtytësit kryesor të rritjes së investimeve në përgjithësi. Në vitin 2013 parashihet që niveli i investimeve të jetë më i lartë se në vitin 2012, por në këtë skenar finalizimi i projekteve të mëdha publike do të zëvendësohet me investime të reja private, megjithatë në një trend më të ngadalësuar në krahasim me dy vitet e mëparshme.

Për shkak të pjesëmarrjes së lartë të importit në investimeve kapitale, gjatë vitit 2011, kontributi negativ i importeve në rritjen reale të BPV-së për këtë vit pritet të jetë më i lartë, duke u pasuar me rënie relative të importeve gjatë vitit 2012 dhe 2013. Ndryshimi në përbërjen e importeve më tepër drejt mallrave kapitale, do të ngrisë kapacitetin prodhues dhe si pasojë pritet ekonomia pritet të fillojë me zëvendësimin e importit, kryesisht në mallrat konsumuese.

Figura 1. Kontributi në rritjen reale të GDP-së 2009-2013



Burimi: Departamenti i Makroekonomisë, MEF

Konsumi si një ndër përbërësit kryesor të rritjes së GDP-së, parashihet të mbetet i qëndrueshëm gjatë periudhës së planifikimit. Si rezultat i parashikimit të ringjalljes së ekonomisë nga kriza e vitit 2009 dhe mbështetja nga jashtë në formën e remitancave, pritet ngritje e besimit të konsumatorëve, duke shtuar prirjen për konsumin privat. Kjo do të shpie në ngritje të vazhdueshme të konsumit gjatë periudhës së planifikuar. Konsumi privat parashihet të ngritet në një mesatare vjetore prej rreth 4.5%, në terme reale, dhe 6.8% në terme nominale gjatë periudhës së projekcionit. Ndërsa si pjesë ndaj GDP-së, konsumi privat në terme reale është planifikuar të mbetet konstante me rreth 76%. Investimet e përgjithshme janë planifikuar të ngritën gjatë periudhës së planifikimit. Investimet e përgjithshme si pjesëmarrje në BPV do ngritën nga 35% në vitin 2010 deri në 38% në vitet 2011-2013. Kjo nënkupton një përmirësim të raportit kapital/produkt (ICOR); që paraqet një rënie nga 7.5 në 6.5. Kjo ngritje në investimin e përgjithshëm gjatë periudhës 2011-2013 reflekton një zhvendosje të theksuar në nivelin e investimeve publike gjatë këtyre viteve. Në përgjithësi, gjatë periudhës së planifikuar, shpenzimet kapitale të Qeverisë pritet të luajnë një rol të rëndësishmen në nivelin e investimeve të përgjithshme. Investimet kapitale të financuara nga Qeveria parashihet të ngritën gjatë periudhës së projektuar, nga 494 milion euro vitin 2010 në një mesatare prej mbi 630 milion euro gjatë viteve 2011 dhe 2013. Njëkohësisht, pjesëmarrja e investimeve private në BPV është planifikuar të rritet nga 22% gjatë vitit 2010 në rreth 24% gjatë vitit 2013. Ky është një reflektim i efekteve të parashikuara të multiplikatorit të ekzekutimit të projekteve të

konsiderueshëm kapitale të planifikuara. Përveç kësaj, të hyrat nga IHD priten që të rikthehen në nivelin e tyre të para krizës. Këto të hyra nga IHD janë të ndërlidhura me privatizimin e iniciuar të një numri të NP-ve.

Parashihet që eksportet e mallrave të ngritën në mënyrë më të shpejtë në raport me nivelin e para krizës. Eksportet e përgjithshme parashihet të ngritën gjatë periudhës së planifikuar, prej 653 milion euro në vitin 2010 në 813 milion euro gjatë vitit 2013, një rritje prej 24%. Importet do të rriten përkohësisht si rezultat i efektit të të ardhurave. Sido që të jetë pjesëmarrja e tyre ndaj GDP-së, parashihet të ulet gradualisht. Me një rritje në kapacitetin e prodhimit të Kosovës, çmime relativisht më të ulëta dhe si rrjedhojë konkurrencë të përmirësuar, ekonomia parashihet të filloj të gjeneroj zëvendësim të importit.

Tabela 2. Treguesit kryesor makroekonomik, 2010-2013, në miliona euro

Pershkrimi	2009 Proj.	2010 Proj.	2011 Proj.	2012 Proj.	2013 Proj.
Bruto Produkti Vendor (BPV)	3,945	4,243	4,600	4,982	5,332
Konsumi	4,313	4,496	4,743	5,055	5,359
Investimet	1,349	1,480	1,739	1,917	2,030
Eksportet	552	653	698	753	813
Importet	2,269	2,387	2,580	2,742	2,871
Deflatori i BPV-se	-3.4%	2.8%	2.3%	2.4%	2.1%
IÇK	-2.4%	1.8%	2.3%	2.5%	2.0%
Rritja reale e BPV-se	4.4%	4.8%	6.1%	5.7%	4.9%


Burimi: Departamenti i Makroekonomisë, MEF

Çmimet dhe Kostoja

Pas arritjes në 9.4% gjatë vitit 2008, inflacioni ka vijuar me një rënie gjatë vitit 2009 (eventualisht duke u kthyer në deflacion) dhe është planifikuar të mbetet në këtë nivel gjatë periudhës së parashikuar. Megjithatë, me ringjalljen e ekonomisë globale, çmimi i naftës dhe komoditeteve tjera në tregjet ndërkombëtare mund të bëhen përsëri burime të ngritjeve të çmimeve, dhe për këtë arsye, ato paraqesin burim të rëndësishëm të pasigurisë.

Edhe pse çmimet e konsumit kanë vijuar trend negativ gjatë vitit 2009, ato janë planifikuar të jenë pozitive gjatë vitit 2010, në momentin kur inflacioni duhet të arrijë 1.8%. Përveç kësaj, inflacioni është planifikuar të ketë mesataren 2.3% gjatë periudhës së projektuar;

Figura 2. Niveli i inflacionit dhe projeksionet, 2007-13



Burimi: Burimi: Departamenti i Makroekonomisë, MEF dhe SOK

Lëvizjet në kostot vendore, që rezultojnë nga inflacioni në rroga, shfaqen si të parashikuara në çmimet e përgjithshme në Kosovë. Megjithatë, ngritja e ndjeshme e rrogave nominale nuk ka pasur një efekt të theksuar në çmimet e përgjithshme. Në këtë kontekst, projeksioni i inflacionit varet shumë në lëvizjet e çmimit të importit. Deflatori i BPV-së pritet të mbetet konstant gjatë periudhës së projektuar (shih Figurën 2).

Bilanci i Pagesave

Rënia e kërkesës globale është reflektuar në performancën e sektorit të jashtëm të Kosovës. Në anën tjetër, një rënie e vogël në kërkesën vendore gjatë vitit 2009, dhe veçanërisht shkurtimi i investimeve private, ka pasur ndikim në importe. Gjithashtu, zvogëlimi në volumet e importit nuk ka kompensuar komplet ndikimin negativ të eksportit në ekonomi. Kjo nënkupton se eksportet neto kanë kontribuar në mënyrë negative në rritjen e ekonomisë për vitin 2009.

Shikuar më tutje, modeli i rritjes së BPV-së parashihet të varet pjesërisht nga sektori i jashtëm. Kjo tregon se paralel me ringjalljen e fuqishme të kërkesës globale dhe me ngritjen e çmimeve të mallrave, çmimet e metaleve në veçanti, eksportet parashihet të rriten gjatë këtij viti dhe do të vazhdojnë të rriten gjatë periudhës së planifikuar.

Eksportet e mallrave dhe shërbimeve janë planifikuar të rriten me një mesatare prej rreth 8% në periudhën e projektuar.

Importet e mallrave dhe shërbimeve janë planifikuar të rriten dukshëm gjatë vitit 2010, duke reflektuar nivel të lartë të investimeve qeveritare. Padyshim, vlera nominale e importeve parashihet të rritet me 5% dhe 8% gjatë vitit 2010 dhe 2011, respektivisht, duke u pasuar me një rritje më të ngadalshme prej 5% gjatë vitit 2013.

Duke marrë parasysh të gjitha këto parashikime, kontributi i eksporteve neto ndaj rritjes së BPV-së, parashihet të jetë negativ gjatë periudhës së planifikuar dhe vetëm gjatë vitit 2013 do

të ketë kontribut pozitiv të neto eksporteve. Për më tepër, duke pasur parasysh se eksportet e mallrave dhe shërbimeve janë parashikuar të rriten më shpejt se importet, pjesëmarrja e bilancit tregtar ndaj GDP-së pritet të përmirësohet gradualisht, duke arritur 38.5% gjatë vitit 2013, apo 2 përqind më i ulët nga sa ishte niveli i saj në vitin 2009.

Llogaria e të hyrave (të hyrat neto) është parashikuar të përmirësohet pas rënies gjatë vitit 2009. Pagesat e interesit në borxhin publik që pritet të bëhen gjatë vitit 2010, pritet të kompensohen nga të hyrat e investimeve të cilat janë parashikuar të rriten në saje të pritjeve se normat e interesit do të rriten.

Pavarësisht nga pritjet që remitancat do të rriten si rezultat i ringjalljes së ekonomisë botërore, llogaria e transferit pritet të zvogëlohet pak gjatë vitit 2010 dhe do të vazhdoj edhe më tutje në këtë mënyrë. Në fakt, parashihet se UNMIK-u do të reduktohet edhe me tutje deri në fund të vitit 2010, ndërsa EULEX dhe donatorët tjerë pritet të mbeten të pandryshuar për sa i përket numrit të tyre.

Tabela 3. Zhvillimet kryesore në sektorin e jashtëm 2009-2013, në miliona euro

Pershkrimi	2009 Proj.	2010 Proj.	2011 Proj.	2012 Proj.	2013 Proj.
Llogaria rrjedhese	-860	-885	-1,058	-1,142	-1,201
Bilanci tregtar (mallrat dhe shërbimet)	-1,727	-1,736	-1,879	-1,986	-2,055
Te hyrat	51	46	49	53	53
Transferet	815	806	772	791	801
<i>n/c dërgesat nga jasht</i>	<i>356</i>	<i>392</i>	<i>411</i>	<i>432</i>	<i>440</i>
Llogaria kapitale dhe financiare	204	527	988	574	588
<i>n/c IHD</i>	<i>271</i>	<i>312</i>	<i>628</i>	<i>300</i>	<i>326</i>
<i>Stoku i MHN te sistemit bankar</i>	<i>1,380</i>	<i>1,179</i>	<i>897</i>	<i>672</i>	<i>429</i>

Burimi: Departamenti Makroekonomik –MEF dhe IMF

Perspektiva e investimeve të paparashikuara dhe shtrëngimi i kushteve kreditore që rezultuan nga kriza ekonomike dhe financiare kanë qenë disa nga arsyet që investimet e huaja direkte kanë qenë dekurajuese gjatë vitit 2009. Edhe pse pritjet kanë qenë të larta se me marrjen e statusit të Kosovës, rrjedha e të hyrave nga IHD do të rritet dukshëm, Kosova ka përjetuar rënie të konsiderueshme të kësaj rrjedhje të të hyrave. Pas arritjes së nivelit prej 6.9% të BPV-së gjatë vitit 2009, rrjedha e të hyrave nga IHD-të janë projektuar për t'u ringjallur shpejt gjatë vitit 2010 (ne një rritje prej 15% nga sa ishin në 2009) dhe pritet të rriten edhe më tutje. Në veçanti, IHD pritet kalojnë dyfishin e 2010-ës në vitin 2011 ngase privatizimi i ndërmarrjeve të mëdha publike pritet të sjellë një fluks të lartë të IHD. Pas 2011, niveli do ulet por përsëri do jetë dukshëm më i lartë se në vitin 2010 pasi që IHD në vitin 2011 do jenë kryesisht pagesa për transferimin e aksioneve, ndërsa investimet për zhvillimin e këtyre ndërmarrjeve do vazhdojnë edhe në vitet vijuese.

Sektori Financiar

Sektori bankar në Kosovë vazhdon të jetë një ndër sektorët më të produktiv dhe më të qëndrueshëm. Pavarësisht nga shtrëngimi i kushteve të huadhënies, kreditë e lejuara nga bankat komerciale janë rritur për sa i përket volumit të tyre. Megjithatë, likuiditeti i bankar nuk ka qenë i mjaftueshëm për të akomoduar kërkesën në rritje të kreditimit të lartë. Ashtu sikurse në vitet paraprake, bankat komerciale kanë vazhduar me zgjerimin e rrjetit të tyre operacional,

duke hapur nëndegë të reja; megjithatë, kjo rritje ka qenë më e ngadaltë gjatë vitit 2009 krahasuar me dy vite paraprake.

Përgjatë viteve të kaluara, është shënuar një rritje në asetet e bankave komerciale ku kreditë përfaqësojnë pjesën më të madhe. Edhe pse bankat komerciale nuk janë ndikuar nga kriza globale financiare, shihet një normë më e ngadalshme e rritjes së kreditimit. Në fakt, gjatë vitit 2009, kreditë janë rritur me 8.9% krahasuar me vitin 2008, vit në të cilin është shënuar rritje prej 32.6%. Ngjashëm, depozitat në bankat komerciale kanë shënuar ngritje vjetore prej 11.2% gjatë vitit 2009 në krahasim me vitin 2008 ku kjo rritje ka qenë prej 23.6%. Megjithatë, pritet që gjatë periudhës së planifikuar bankat të rrisin volumin e huadhënies pasi që niveli i depozitave pritet të shënoj ngritje. Ky është rezultat i një rritjeje të pritur të remitancave dhe një ringjalljeje të ekonomisë globale, çka do ndikojë në rritjen e eksportit nga kompanitë vendore dhe në hyrjen e investimeve nga investitorët e huaj.

Të Hyrat dhe Shpenzimet e Projektuara Qeveritare

Projeksionet e të hyrave Buxhetore

Sistemi tatimor i Kosovës karakterizohet me norma të ulëta dhe me bazë të gjerë tatimore. Qeveria planifikon ti mbahet këtyre parimeve gjatë periudhës së parashikuar në këtë KASH, duke synuar zgjerimin e mëtutjeshëm të bazës tatimore.

Duke filluar nga viti 2009, Qeveria ka filluar implementimin e reformës tatimore, e cila ka reduktuar tatimin në korporata prej 20% në 10%. Norma e tatimit në të hyra është zvogëluar në mënyrë progresive nga 0, 5, 10, 20% në 0, 4, 8, dhe 10%. Kjo reformë tatimore është implementuar në mënyrë të suksesshme nga dy institucione: Administrata Tatimore dhe Shërbimi i Doganave të Kosovës. Pavarësisht nga ndryshimet në norma, performanca e përgjithshme e të hyrave gjatë vitit 2009 ka qenë mjaft e mirë, me një nivel arkëtimi prej 100% të planit të parashikuar.

Kriza globale ekonomike gjatë vitit 2009 ka pasur ndikim negativ në performancën e arkëtimit të të hyrave në të gjitha vendet e rajonit. Shumica e këtyre vendeve tani kanë rishikuar planet e tyre të arkëtimit të të hyrave. Në rastin e Kosovës, Administrata Tatimore dhe Shërbimi Doganor kanë qenë mjaft të suksesshëm në realizimin e planit të buxhetit për arkëtimin e të hyrave për vitin 2009. Kjo performancë pritet të përmirësohet edhe më tej gjatë periudhës së projektuar.

Projeksionet e të hyrave për periudhën 2011 – 2013 janë bazuar në zhvillimet e treguesve kryesor makroekonomik, duke aplikuar për çdo instrument të politikës tatimore normën efektive tatimore ndaj bazës përkatëse tatimore, dhe duke llogaritur gjithashtu ndryshimet e politikës tatimore. Për më tepër, janë marrë parasysh parashikimet lidhur me përmirësimet në efikasitetin e arkëtimit të hyrave nga Administrata Tatimore e Kosovës (ATK) dhe nga Shërbimi Doganor.

Është e qartë se të hyrat varen shumë nga aktiviteti i importeve. Megjithatë, performanca e përmirësuar gjithashtu ndikohet shumë nga faktorët e jashtëm, siç janë niveli i inflacionit dhe

zhvillimet aktuale në sektorin e ekonomisë globale. Orientimi i arkëtimit buxhetor drejt të hyrave nga tatimet vendore mbetet sfida kryesore afatgjate e Qeverisë së Kosovës.

Tabela në vijim përmbledh projeksionet për periudhën 2009 – 2013.

Tabela 4. Të hyrat Buxhetore, 2009-2013, në miliona euro

Pershkrimi	2009	2010	2011	2012	2013
	Aktuale	Buxheti i rishikuar	Proj	Proj	Proj
1. TE HYRAT E PERGJITHSHME	1,146	1,106	1,150	1,263	1,356
Te hyrat tatimore	816	891	998	1,097	1,178
Te hyrat vendore	207	216	236	263	282
Te hyrat nga kufiri	635	702	792	866	930
Rikthimet e Tatimeve	-26	-28	-30	-32	-34
Te hyrat jo tatimore dhe te hyrat vetanake		130	152	165	178
Dividentat	200	85	0	0	0

Burimi: Departamenti Makroekonomik dhe i Thesarit-MEF

Krahasuar me vitin 2009, të hyrat e përgjithshme janë projektuar të rriten për 18% deri në vitin 2013, duke arritur shumën prej 1,356 milion euro. Rritja e efikasitetit të grumbullimit del të ketë qenë edhe më e shpejtë nëse lëmë mënjanë dividendën e PTK-së (200 milion euro) që u arkëtua brenda të hyrave të përgjithshme gjatë vitit 2009. Të hyrat parashikohen të mbeten të qëndrueshme pavarësisht nga rritja nominale si pjesëmarrje në BPV. Arkëtimi i dividendës së PTK-së gjatë vitit 2009 ka shkaktuar rritje të përkohshme të të hyrave si përqindje e BPV-së, rritje kjo prej 4%, duke ngitur pjesëmarrjen e të hyrave në BPV në 29%. Përgjatë periudhës 2010-2013 është paraparë që kjo pjesëmarrje të mbetet në mesataren e qëndrueshme prej 25%. Te hyrat e përgjithshme për vitin 2010, përfshin në vete edhe vlerën e dividendes së deklaruar nga dy ndërmarrjet publike, atë të PTK-së dhe Aeroportit ndërkombëtar te Prishtinës..

Arkëtimi i të hyrave tatimore vendore parashihet të shënoj rritje gjatë periudhës së planifikuar (2010-2013) në pothuajse 36%, duke arritur 282 milion euro deri në fund të vitit 2013. Kjo rritje e arkëtimit të taksave vendore është paraparë të vjen nga dy faktor kryesor: implementimi i plotë i reformës tatimore që ka filluar në vitin 2009 dhe përmirësimi i efikasitetit të Administratës Tatimore. Masa të ndryshme janë konsideruar me qëllim të zvogëlimit të nivelit të shmangies së tatimeve. Në fund të vitit 2009 janë lëshuar numra fiskal për të gjitha bizneset aktive dhe për të gjitha bizneset do të instalohen arka fiskale.

Të hyrat tatimore kufitare janë paraparë të rriten rreth 42%, nga €35 milion euro sa kanë qenë gjatë vitit 2009 deri në €930 milion euro gjatë vitit 2013. Kjo rritje e arkëtimit të tatimit në kufi pritet të vijë nga parashikimet se niveli i importeve do të rritet si pasojë e implementimit të projektit të ri të autostradës, apo më saktësisht, nga kërkesa shtesë për mallra dhe shërbime të importuara që do rezultojë nga ndërtimi i autostradës. Pritet se do të ketë edhe ngritje të çmimeve në tregun ndërkombëtar, çka do rezultojë në arkëtime më të larta të të hyrave nga tatimet kufitare. Supozimet për këtë ngritje të theksuar të të hyrave nga kufiri, reflektojnë vendimin që pritet të ndërmarr Qeveria për ngritjen e normave të akcizës në disa produkte luksoz siç janë nafta, duhani, alkooli, etj. Këto ndryshime pritet të jenë efektive që nga 1 Korriku i vitit 2010. Kjo ngritje e normave të akcizës është një prej kriterëve që Qeveria është e obliguar të përmbush në harmoni me marrëveshjen me FMN-në.

Të hyrat vetanake dhe të hyrat jo-tatimore janë planifikuar të rriten përgjatë periudhës së projektuar në KASH 2011-13; kjo rritje i dedikohet kryesisht përmirësimeve në arkëtimin e tatimeve në pronë, si arkëtimit më efikas të obligimeve tjera nga ana e komunave. Kjo kategori

e të hyrave ka treguar trend të rritjes së vazhdueshme në periudhën paraprake, duke reflektuar administrim më të mirë nga institucionet qendrore dhe vendore, të cilat janë përgjegjëse për arkëtimin e këtyre taksave dhe tarifave.

Duhet vënë re se për periudhën e ardhshme 2011-2013, ne nuk presim të arkëtojmë të hyra shtesë nga PTK, për shkak të faktit se kjo kompani pritet të privatizohet deri në fund të vitit 2010.

Shpenzimet Buxhetore

Shpenzimet Buxhetore janë projektuar të shënojnë rritje gjatë periudhës në vijim, më së shumti për shkak të rritjes së investimeve kapitale në infrastrukturë, rritjes në transferet sociale dhe në kategori tjera ekonomike. Politika e shpenzimeve është e orientuar në mbajtjen e nivelit të lartë të shpenzimeve kapitale, kryesisht në infrastrukturë.

Tabela 5. Shpenzimet totale 2009-2013, në miliona euro

Pershkrimi	2009	2010	2011	2012	2013
	Aktuale	Buxheti i rishikuar	Proj	Proj	Proj
2. SHPENZIMET E PERGJITHSHME	1,110	1,256	1,423	1,520	1,571
Shpenzimet rrjedhese	694	721	787	846	907
Pagat dhe Mëditjet	264	299	316	351	378
Mallrat dhe Sherbimet	173	183	193	206	220
Nga te cilat konunalit	19	22	24	25	25
Subvencionet dhe transferet	257	239	279	289	309
Transferet sociale	180	197	238	268	288
Subvencionet per NP-te	77	42	41	21	21
Projekti I Bankes Boterore		8			
IDA Projekti		2	2	2	0
Shpenzimet Kapitale	400	494	611	650	641
Nga te cilat autostrada		131	275	297	272
Rezerva	0	12	3	4	4
MM te Organizatave Buxhetore niveli qendror THV	0	19	20	20	20
Anetaresimi ne FMN	16	0	0	0	0
3. DEFICITI PRIMAR	36	-150	-273	-257	-215
4. PAGESA E INTERESIT (Borxhi i jashtem)	1	10	10	11	16
5. KREDITË PER NDERMARRJET PUBLIKE	79	60	45	0	0
nga te cilat: Kredite e reja per NP-te	79	60	45	0	0
nga te cilat: kthimi nga NP-te	0	0	0	0	0
6. DEFICITI/SUFICITI I PERGJITHSHEM	-44	-220	-328	-268	-231

Burimi: Departamenti Makroekonomisë dhe Departamenti i Buxhetit- MEF

Shpenzimet në investime kapitale janë planifikuar të rriten gjatë periudhës së planifikuar. Kjo rritje shpenzimesh vjen kryesisht si rezultat i shpenzimeve shtesë për projektin e autostradës në vitin 2010, dhe financimin e investimeve të vazhdueshme në këtë projekt për vitet 2011 – 2013.

Pagat dhe Mëditjet

Kategoria e pagave dhe mëditjeve është planifikuar të rritet gjatë periudhës vijuese, duke reflektuar rritjen e rrogave për shkak të implementimit të plotë të Ligjit të Sherbimit Civil në vitin 2011. Rritjet e pagave vijnë edhe si rezultat i vendimit të qeverisë për implementimin e ligjit të Policisë, si dhe nga vendimi për rritjen e rrogave për punëtorët shëndetësor dhe për krijimin e institucioneve të reja. Njëkohësisht rritja e kësaj kategorie të shpenzimeve reflekton

edhe fillimin e implementimit të “Ligjit mbi shërbyesit civil”, si dhe disa iniciativa tjera në drejtësi dhe sektorë tjerë publik.

Mallrat dhe Shërbimet

Shpenzimet e mallrave dhe shërbimeve janë rritur pak për të reflektuar koston më të lartë të mirëmbajtjes së parashikuar të shpenzimeve të mëdha kapitale të ndërmarra në vitet paraprake. Shpenzimet në mallra dhe shërbime parashihet të rriten nga 172.8 milion euro gjatë vitit 2009 në 220 milion euro gjatë vitit 2013, apo 27% më shumë nga sa u shpenzua për këtë kategori gjatë vitit 2009. Rritja më e madhe brenda kësaj kategorie është bërë gjatë vitit 2011, duke reflektuar financimin e dy projekteve: regjistrimi i popullsisë dhe zgjedhjet e reja të cilat pritet të mbahen në vitin 2011.

Subvencionet dhe Transferet

Kjo kategori e veçantë e shpenzimeve absorbon pjesën më të madhe të buxhetit të qeverisë. Shumica e këtij shpenzimi i dedikohet transfereve sociale dhe subvencioneve për Ndërmarrjet Publike. Shuma e buxhetit të caktuar për vitin 2010 për këtë kategori është zvogëluar për €9.5 milion euro, krahasuar me buxhetin e vitit 2009. Ky zvogëlim reflekton vendimin e qeverisë për uljen e subvencioneve prej 77 në €41 milion euro. Në të njëjtën kohë, të gjitha transferet sociale janë rritur në vitin 2010, kryesisht për shkak të rritjes natyrale të numrit të përfituesve në këtë sektor.

Gjatë periudhës së planifikuar 2010 – 2013, pritet që subvencionet për kategoritë sociale të rriten për €108 milion euro deri në vitin 2013, krahasuar me buxhetin e vitit 2009. Rritja e shpenzimeve për vitin 2011 në këtë kategori reflekton vendimin e qeverisë për implementimin e ligjit të ri të pensioneve Po ashtu rritja e kësaj kategorie të shpenzimeve reflekton implementimin e pjesërishëm të Ligjit mbi Invalidët, Familjet e Dëshmorëve dhe Veteranët e Luftës.

Subvencionet për ndërmarrjet publike janë planifikuar të zvogëlohen gradualisht, duke marrë parasysh përparimet në të hyrat vetanake, dhe duke llogaritur rrjedhën e të hyrave që do të pasojë si rezultat i procesit të privatizimit.

Shpenzimet kapitale

Shpenzimet kapitale janë planifikuar të rriten dukshëm gjatë kësaj periudhe, duke reflektuar vendimin e qeverisë për të filluar më ndërtimin e autostradës nga Prishtina deri në kufi me Shqipërinë. Shikuar në tërësi, ka pasur mjaft përparime në nivelin e ekzekutimit të shpenzimeve kapitale gjatë vitit 2009, duke arritur 81% të planeve për vitin përkatës. Projektionet makrofiskale supozojnë se kjo performancë do të përmirësohet gradualisht dhe vazhdimisht, duke arritur kështu në 95% gjatë vitit 2013. Përmirësimi në efikasitetin e ekzekutimit të shpenzimeve vjen si rezultat i dy zhvillimeve: menaxhimit më të mirë të projekteve si dhe oreinetimit drejt projekteve të mëdha kapitale. Niveli i shpenzimeve kapitale përfshirë këtu shpenzimet për ndërtimin e autostradës si dhe shpenzimet për eksproprim të tokës, në mesatare do të sillen rreth 630 milion euro përgjatë periudhës së projektuar.

Neto Huadhënia

Qeveria e Kosovës ka dhënë kredi për KEK-un me qëllim për të financimit të projekteve të

mëdha kapitale në mihje. Gjatë vitit 2009, KEK ka shpenzuar 78.8 milion euro të kredisë së flokuar për këtë kompani. Me qëllim të përfundimit të projekteve të cilat janë të domosdoshme për KEK-un, ne kemi planifikuar të ndajmë 60 milion euro për këtë qëllim gjatë vitit 2010, duke vazhduar edhe me një kredi shtesë prej 45 milion në vitin 2011. Nga viti 2012, nuk janë planifikuar shpenzime të tjera për këtë qëllim sepse pritjet janë që gjatë kësaj periudhe do krijohen kapacitete të reja përmes investimeve të sektorit privat.

Boshllëku Financiar

Për periudhën e ardhshme 2010-2013, pozita e përgjithshme fiskale parashihet të dobësohet. Kjo për shkak të nevojës për rritjen e nivelit të shpenzimeve publike, të cilat nuk do të mund të mbështeten më nga bilanci i akumuluar bankar. Rritja e shpenzimeve më shpejt se ajo e të hyrave do të kontribuojë në rritjen e deficitit primar për periudhën e planifikuar (2010 – 2013). Deficiti Buxhetor i parashikuar duhet të financohet nga (a) bilanci bankar i Qeverisë, e cili është akumuluar nga vitet paraprake, nga (b) mbështetja direkte e donatorëve, dhe nga (c) huamarrjet e reja.

Tabela e mëposhtme tregon se viti më i vështirë për sa i përket pozitës fiskale është viti 2011. Kjo për shkak se shpenzimet totale janë parashikuar të shënojnë rritje prej rreth 195.5 milion euro në krahasim me shpenzimet e planifikuara për vitin 2010. Bilanci minimal bankar i vlerësuar do të mbahet përgjatë periudhës së planifikuar. Mbarëvajtja e kufirit minimal të bilancit bankar do varet shumë nga asistenca e donatorëve gjatë periudhës së projektuar. Duhet cekur që me qëllim të ruajtjes së rezervës fiskale, financimi duhet siguruar ose përmes huamarrjes komerciale ose përmes ndihmës nga Institucionet Financiare Ndërkombëtare

Tabela 6 më poshtë bart mesazhin se rruga fiskale për Kosovën gjatë periudhës afatmesme do të jetë e vështirë. Me qëllim të menaxhimit të kësaj pozite fiskale të vështirë dhe minimizimit të rrezikut fiskal që ndërlidhet me këtë kornizë të shpenzimeve afatmesme, Kosovës i nevojitet të përmirësoj më shumë arkëtimin e të hyrave buxhetore dhe të kërkoj më shumë përkrahje buxhetore, sepse përndryshe do jetë e detyruar të ndërmarrë hapa rigoroz në ri- përcaktimin e prioritetëve të shpenzimeve publike.

Tabela 6. Boshllëku financiar, 2009-2013, në miliona euro

Pershkrimi	2009	2010	2010	2011	2012	2013
	Aktuale	Buxheti fillestar	Buxheti i rishikuar	Proj	Proj	Proj
7. FINANCIMI	-87	212	218	328	271	231
Financimi I jashtem	-43	50	123	148	74	9
Pagesa e kryegjese (borxhi I jashtem)	-43	-20	-11	-11	-11	-11
Mbeshetja direkte buxhetore	0	70	81	82	77	0
Huamarrje nga jashte	0	0	3	7	7	0
Huamarrja nga IFN	0	0	44	65	2	20
IMF	0	0	43	63	0	0
banka Boterore	0	0	1	2	2	20
Fondi ne mirbesim	0	0	6	6	0	0
Financimi I brendshem	0	0	95	181	197	222
Te hyrat nga privatizimi	0	0	0	300	10	10
Huamarrja e brendshme	0	0	0	0	80	166
Ndryshimet ne bilancin bankar	0	0	98	-112	100	46
Asetet tjera financiare	0	0	-3	-7	-7	0
8. GJENDJA E BILANCIT BANKAR	342	210	243	356	256	209
9. PRAGU I NEVOJSHEM I BILANCIT PANKAR	200	200	241	354	309	343
10. BOSHLLËKU FINANCIAR ("-" mnusi nenkupton suficit)	0	0	-2	-2	53	134

Burimi: Departamenti Makroekonomik dhe Buxhetor- MEF

Vlerat e huamarrjes të paraqitura më lartë janë vetëm supozime konzervative që nuk marrin parasysh nivelin e kursimeve Brenda-buxhetore për vitet 2012-2013, si dhe nën supozimin se përkrahja direkte buxhetore do përfundoj në vitin 2012. Siç edhe mund të shihet, bashllëku financiar që është pothuajse i balancuar, supozon ngritjen e pragut të bilancit bankar që duhet ngritur për të siguruar qëndrueshmërinë fiskale dhe për të garantuar likuiditetin e përgjithshëm të ekonomisë kosovare. Natyrisht, se si një shtet pa politikë monetare, një masë e tillë është e domosdoshme në rastin kur ndërmerren politika zhvillimore të shkallës së gjerë. Kjo për faktin se me zhvillimin e ekonomisë, vie deri tek ngritja e atraktivitetit të investimeve vendore, çka edhe reflektohet në rritjen e nivelit të kreditimit. Por, rreziku që ngritja e pragut neutralizon vie nga ulja e mjeteve të huaja neto të sektorit financiar. Me një politikë të tillë të kujdesshme Qeveria e Kosovës siguron që ulja e mjeteve të huaja neto të balancohet me një ngritje shumë më të vogël, port ë mjaftueshme, të rezervave të brendshme.

Rreziqet Fiskale

Sikurse në parashikimet e paraqitura në Kornizat paraprake, ky seksion paraqet vlerësime të disa prej risqeve më të rëndësishme fiskale, të cilat mund të kenë ndikim në gjendjen fiskale gjatë periudhës së planifikuar.

- **Kohëzgjatja e Privatizimit të Ndërmarrjeve Publike** – shumë nga planet e për shpenzime siç janë vendosur në KASH për vitin 2011-2013, kanë për qëllim promovimin e rritjes ekonomike. Megjithatë, qëndrueshmëria e financimit të këtyre shpenzimeve varet shumë nga suksesi i privatizimit të ndërmarrjeve më të mëdha publike. Në veçanti, menaxhimi i duhur i procesit të privatizimit është esencial me qëllim të implementimit të plotë të kësaj strategjie afatmesme. Vonesat në privatizimin e NP-ve të caktuara mund të shpie drejt shtyrjeve të disa projekteve për investime kapitale dhe në përgjithësi do të rrezikoj pozitën e menaxhimit të parasë publike.
- **Kredia e KEK-ut** – përbrenda këtij KASH-i, Qeveria ka deklaruar pozicionin se ajo nuk ka plane të i siguroj kredi shtesë KEK-ut, prej vitit 2012 e tutje, ku është parashikuar se deri në fund të vitit 2010 pronësia e KEK-ut do të ndahet me investitorë privat, çka do rezultojë në investime të reja brenda kësaj kompanie.
- **Përkrahja Direkte Buxhetore** – Parashikim tjetër në kornizën makrofiskale është përkrahja direkte e buxhetit të projektuar, si në formën e granteve ashtu edhe në atë të kredive. Kjo kategori e financimit shton një nivel të riskut për implementimin e kësaj Kornize, ngase nuk ka marrëveshje kontraktuale me donatorët përkatës hyra. Megjithatë, meqë Qeveria tanimë ka arritur marrëveshjen me FMN, e cila marrëveshje është theksuar të jetë kriteri bazë për marrjen e këtyre mjeteve, vlerësohet që rreziku për mospranimin e këtyre mjeteve të jetë i vogël.
- **Shëndetësia** – Projeksionet e KASH për vitin 2011-13 nuk marrin parasysh koston e implementimit të Ligjit për Sigurimin Shëndetësor. Aprovimi dhe implementimi i këtij ligji gjatë periudhës së MTEF do të kërkonte financim shtesë nga buxheti.
- **Autostrada** – Projekti i autostradës është projekti më i madh i ndërmarrë nga Qeveria. Për shkak të madhësisë së tij, ky projekt duhet të menaxhohet me vëmendje dhe duhet të monitorohet me kujdes. Devijimet nga kontrata mund të rrisin riskun që ky projekt i rëndësishëm paraqet për pozitën fiskale të qeverisë dhe përgjithësisht qëndrueshmërisë fiskale në një periudhë më të gjatë kohore.

Korniza Afatmesme e Shpenzimeve 2011-2013

 Tabela Fiskale
 (Ne milion euro pervec nese tregohet ndryshe)

Pershkrimi	2009 Aktuale	2010 Buxheti filestar	2010 Buxheti i rishikuar	2011 Proj	2012 Proj	2013 Proj
Të hyrat e përgjithshme	1,146	1,029	1,106	1,150	1,263	1,356
Te hyrat tatimore	816	892	890	998	1,097	1,178
Te hyrat vendore	207	235	216	236	263	282
Te hyrat nga kufiri	635	684	702	792	866	930
Rikthimet e Tatimeve	-26	-27	-28	-30	-32	-34
Te hyrat jo tatimore dhe te hyrat vetanake	0	138	130	152	165	178
Dividentat	200	0	85	0	0	0
Shpenzimet e përgjithshme	1,110	1,157	1,254	1,423	1,523	1,571
Shpenzimet rrjedhese	694	709	731	787	847	907
Pagat dhe Meditjet	264	283	299	316	352	378
Mallrat dhe Sherbimet	173	189	184	193	206	220
Nga te cilat konunalit	19	22	22	24	25	25
Subvencionet dhe transferet	257	238	247	279	289	309
Transferet sociale	180	191	207	238	268	288
Subvencionet per NP-te	77	47	41	41	21	21
Projekti I Bankes Boterore	0	8	0	0	0	0
IDA Projekti	0	0	2	2	2	0
Shpenzimet Kapitale	400	414	495	611	650	641
Nga te cilat autostrada	0	20	130	275	297	272
Rezerva	0	7	7	3	4	4
MM te Organizatave Buxhetore niveli qendror THV	0	19	19	20	20	20
Anetaresimi ne FMN	16	0	0	0	0	0
Deficiti primar	36	-127	-148	-273	-260	-215
Pagesa e Interesit (Borxhi i jashtem)	1	15	10	10	11	16
Kreditë për ndërmarrje publike	79	70	60	45	0	0
nga te cilat: Kredite e reja per NP-te	79	70	60	45	0	0
nga te cilat: kthimi nga NP-te	0	0	0	0	0	0
Deficiti/ Suficiti i përgjithshëm	-44	-212	-218	-328	-271	-231
Financimi	-87	212	218	328	271	231
Financimi I jashtem	-43	50	123	148	74	9
Pagesa e kryegjese (borxhi I jashtem)	-43	-20	-11	-11	-11	-11
Mbeshtetja direkte buxhetore	0	70	81	82	77	0
Huamarrje nga jashte	0	0	3	7	7	0
Huamarrja nga IFN	0	0	44	65	2	20
IMF	0	0	43	63	0	0
banka Boterore	0	0	1	2	2	20
Fondi ne mirbesim	0	0	6	6	0	0
Financimi I brendshem	0	0	95	181	197	222
Te hyrat nga privatizimi	0	0	0	300	10	10
Huamarrja e brendshme	0	0	0	0	80	166
Ndryshimet ne bilancin bankar	0	0	98	-112	100	46
Asetet tjera financiare	0	0	-3	-7	-7	0
Gjendja e Bilancit Bankar	342	210	243	356	256	209
Pragu i nevojshëm i bilancit bankar	200	200	241	354	309	343
Boshllëku financiar ("-" mnusi nenkupton suficiti)	0	0	-2	-2	53	134

Korniza Afatmesme e Shpenzimeve 2011-2013

Indikatoret kryesor makroekonomik 2009 - 2013 (ne milion euro perveç nese tregohet ndryshe)					
Pershkrimi	2009 Proj.	2010 Proj.	2011 Proj.	2012 Proj.	2013 Proj.
Rritjet reale ne perqindje					
BPV	4.4	4.8	6.1	5.8	4.9
Konsumi i sektorit privat	3.1	3.4	5.2	4.0	4.2
BPV per koke banori	2.9	3.2	4.5	4.2	3.3
Konsumi privat per koke banori	1.5	1.9	3.7	2.5	2.7
Ndryshimet e çmimeve (ne perqindje)					
IÇK	-2.4	1.8	2.3	2.5	2.0
Deflatori i BPV-se	-3.4	2.8	2.3	2.4	2.1
Buxheti I Pergjithshem (ne perqindje te BPV-se)					
Te hyrat	28.9	26.1	25.0	25.3	24.9
Shpenzimet primare	30.5	29.4	30.9	30.5	29.1
<i>Nga te cilat shpenz. Kapitale dhe neto huadhenia</i>	11.9	11.6	13.3	13.0	11.4
Bilanci rrjedhes	10.3	8.3	7.4	7.9	7.2
Bilanci primar	-1.6	-3.3	-5.9	-5.2	-4.2
Bilanci I pergjithshem (perفشire edhe pagesa per interesin)	-1.6	-3.5	-6.1	-5.4	-4.5
Bilanci i Kurisimeve/Investimeve (ne perqindje te BPV-se)					
Kursimet vendore	-9.7	-6.5	-3.5	-1.9	-1.2
Remitancat	9.0	9.2	8.9	8.7	8.3
Te ardhurat nga jashte (neto)	1.3	1.3	1.3	1.3	1.3
Kursimet kombetare	0.7	4.0	6.7	8.1	8.3
Investimet	34.2	34.9	37.8	38.5	38.1
Llogaria rrjedhese	-21.8	-20.8	-23.0	-22.9	-22.5
Asistenca nga jashte	7.6	6.4	4.9	4.5	4.2
Agregatet kryesor (ne milion euro)					
BPV	3,945	4,242	4,600	4,982	5,332
BPV per koke banori (ne euro)	1,853	1,963	2,097	2,238	2,359
AKBD per koke banori (ne euro)	2,084	2,202	2,343	2,491	2,615
Remitancat	356	392	411	432	440
Asistenca nga jashte	301	273	226	226	226
Popullsia (ne mijera)	2,129	2,161	2,194	2,227	2,260

Tabla 3. Kosova: BPV sipas çmimeve aktuale, 2009-13
(Në milion euro, përveç nëse tregohet ndryshe)

Pershkrimi	2009 Proj.	2010 Proj.	2011 Proj.	2012 Proj.	2013 Proj.
Konsumi i pergjithshem	4,313	4,496	4,742	5,055	5,360
Ekonomite familjare	3,583	3,762	4,037	4,301	4,567
Publik	730	734	705	754	793
Qeveria e pergjithshme	460	492	511	559	598
Pagat	263	307	316	351	378
Mallrat dhe sherbimet	197	185	195	208	220
Donatoret	270	242	195	195	195
Investimet	1,349	1,480	1,739	1,917	2,030
Sektori i donatoreve	105	102	96	96	96
Sektori qeveritar	400	445	575	618	608
Investimet private	844	934	1,068	1,203	1,326
Neto eksportet e mallrave dhe sherbimeve	-1,717	-1,734	-1,881	-1,989	-2,058
Eksportet	552	653	698	753	813
Eksportet e mallrave	165	214	240	270	308
Eksportet e sherbimeve	387	439	458	483	505
Importet	2,269	2,387	2,579	2,742	2,871
BPV	3,945	4,242	4,600	4,982	5,332
Remitancat	441	463	481	500	510
Te hyrat nga jashte (neto)	52	56	60	64	68
AKBD	4,438	4,760	5,141	5,547	5,911

II. MARRËDHENIET FISKALE NDËRQEVERITARE

Hyrje

Materiali ofron deklarinimin e prioriteteve strategjike të Qeverisë në fushën e marrëdhënieve fiskale qeveritare dhe prezanton financimin komunal për periudhën afatmesme 2011-2013.

Sistemi i financimit komunal gjate këtyre viteve ka pësuar ndryshime të mëdha në vijën horizontale dhe vertikale të financimit. Parimet e financimit komunal dhe pjesëmarrja e buxhetit Komunal në Buxhetin e Republikës së Kosovës (dmth., transferet qeveritare për komunat) janë strukturuar në linjë me Ligjin për Financimin e Pushtetit Lokal (LFPL).

Komunat nga viti në vit kanë pasur një shkallë të rritur të decentralizimit fiskal dhe transparencës së buxhetit komunal në formulimin, regjistrimin dhe raportimin e buxhetit.

Përcaktimi i shumave agregate të granteve qeveritare dhe alokimi i tyre në komunat individuale në periudhën afatmesme, bëhet nga Komisioni i Granteve duke marrë për bazë aspektet në vijim:

1. Plotësimi i parimeve të përgjithshme të themeluara nga LFPL.
2. Analizat e standardeve sektoriale të ofruara nga ministritë përgjegjëse.
3. Përmirësimi i formulës së mëhershme të alokimit për grantet specifike në shëndetësi dhe arsim.
4. Korniza makro-fiskale si bazë e Kornizës afatmesme të shpenzimeve.

Aranzhimi institucional është zhvilluar mbi bazën e implementimit të kërkesave ligjore në konsultim me ministrit e linjës, harmonizimet në mes komunave amë me komunat e reja përfshirë marrëveshjet e mirëkuptimit, shëndetësinë sekondare si kompetencë e shtuar dhe në bashkëpunim me partnerët ndërkombëtar.

Sistemi aktual i financave komunale përbën decentralizimin fiskal të avancuar, komunat kanë kompetenca të konsiderueshme për shpenzimet, kompetenca për ofrim të shërbimeve publike, autorizime për mbledhjen e të hyrave, dhe autoritet të gjerë në menaxhimin financiar.

Përkushtimi i përgjithshëm për të përmirësuar elementet kyçe të procesit të zhvillimit të buxhetit, ka kërkuar edhe disa ndryshimeve në formatin e prezantimit të buxhetit komunal. Prandaj, jemi mbështetur në aspektet kryesore të mëposhtme të procesit buxhetor:

- Shfrytëzimi i buxhetimit në nivel të programit, në përputhje me strukturën ekzistuese të regjistrimit kontabël dhe me buxhetimin e aktiviteteve nëpër nën-programe;
- Përmirësimet në qasjen e buxhetimit të orientuar drejt rezultateve; dhe
- Zbatimi i planifikimit shumëvjeçar të buxhetit dhe prezantimi i të gjitha zërave të buxhetit për vitin paraprak, vitin e tanishëm buxhetor dhe për dy vitet pasuese;

Futja në përdorim e buxhetimit të detyrueshëm kapital shumëvjeçar, përfshirë këtu integrimin e informatave për përfundimet dhe rezultatet e planifikuara në sistemin e Planifikimit të Investimeve Publike.

Gjatë këtij viti komunat do të hartojnë për secilin program strategjinë me synimet dhe

objektivat, përfundimet dhe rezultatet që synohen të arrihen përmes procesit buxhetor.

Përmbledhje e pasqyrave të reja të buxhetit komunal për vitin 2011 - 2013

Me tabelat e reja të buxhetit komunal është rritur niveli i performancës, transparencës në dokumentacionin e buxhetit ku të gjithë akterët kryesor kanë marrë pjesë në hartimin e tyre.

Duke u nisur nga përvojat e viteve të kaluara dhe me qëllim të vazhdimit të reformave të procesit buxhetor, buxheti komunal edhe për vitin 2011 do të ndërtohet sipas *strukturës bazë të programeve*. Për të përmirësuar gjithë-përfshirjen, transparencën dhe kredibilitetin e formulimit të buxhetit komunal, synohet që hartimi i buxhetit të ndërtohet në përputhje me dispozitat e Ligjit për Financat e Pushtetit Lokal (LFPL) dhe Ligjit për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë (LMFPP).

Burimet e Financimit Komunal

Financimi komunal përfshinë: të hyrat vetanake të komunës, grantet operative, grantet për kompetencat e shtuara, transferet për kompetencat e deleguara, grantet e jashtëzakonshme, ndihma financiare nga Republika e Serbisë. Ndërsa, aspekti i Huamarrjes së komunave do të jetë si opcion i ri i mundshëm i financimit që është paraparë në LFPL, i cili do të jetë në dispozicion të komunave vetëm në kuadër të kushteve strikte të përcaktuara dhe pas aprovimit të Ministrisë të MEF-it.

Të gjitha të hyrat nga burimet në vijim janë të hyra vetanake të komunës: faturat e tatimit në pronë, taksat komunale, gjobat, tarifrat dhe pagesat në pajtim me autoritetin që u është dhënë komunave me LFPL.

Komunat pranojnë Grante Operative nga Buxheti i Republikës së Kosovës dhe ato janë: Granti i përgjithshëm, Granti specifik për Arsim dhe Granti specifik për Shëndetësi përfshirë financimin për shëndetësi sekondare. Grantet bazohen në kritere të drejta, transparente dhe objektive duke ju dhënë kështu komunave pavarësi më të madhe në alokimin dhe shpenzimin e këtyre granteve.

Komunat gjithashtu pranojnë nga niveli qendror financimin për transferet e kompetencave të shtuara dhe të deleguara.

Financimi komunal për vitin 2011 të prezantuar në Tabelën 1, rezulton nga vendimet e Komisionit të Granteve, në takimin e datës 08 Prill 2010.

Me vendim të Kuvendit të Republikës së Kosovës Nr.03-V-237 datë 28 janar 2010, është bërë zbritja nga grantet qeveritare nga kategoria ekonomike mallra dhe shërbime për financimin e RTK-së në shumë prej 798,821 € Ndërsa, shuma prej 700,000 € për çertifikatat e gjendjes civile është transferuar nga komunat në MPB.

Ndryshimet e buxhetit me proces të rishikimit të buxhetit për vitin 2010, janë përfshirë në Tabelën 1, për financimin komunal agregat 2009-2013.

Tabela 1. Financimi komunal agregat 2009 – 2013

	2009	2010	2011	2012	2013
	Aktuale	Buxheti- Rishikimi	Projeksioni	Vlerësimi	
1. Grantet për kompetencat vetanake	207,7	233,17	248,49	259,6	268,4
Granti i përgjithshëm	85,0	94,27	105,56	113,14	118,61
Granti specifik për shëndetësi	23,0	27,31	31,09	32,28	33,26
Granti specifik për arsim	98,2	109,30	110,47	112,80	115,20
Financimi bazë	98,2	109,30	109,82	112,80	115,20
Politikat e reja 2011:			0,65		
Qendrat e ekselencës			0,04		
Gjuha angleze (Klasa I)			0,46		
Pedagogët			0,15		
Granti specifik për shërbimet sociale	1,5	1,92	1,00	1,00	1,00
Granti specifik për kulturë		0,37	0,37	0,37	0,37
2. Grantet për kompetencat e shtuara	0,0	0,93	2,39	2,96	2,93
Kujdesi shëndetësor dytësor		0,93	2,39	2,96	2,93
3. Të hyrat vetanake komunale	37,2	50,40	51,88	53,33	55,58
4. Financimi kontingjent për decentralizimin	3,2	3,20	1,50	0,00	0,00
MAPL (komunat e reja)	3,2	3,20			
MEF (komunat e reja dhe komunat veriore)			1,50		
5. FINANCIMI KOMUNAL (prill 2010)	248,1	284,50	302,76	315,88	326,95
6. Procesi i Rishikimit (qershor 2010)	0,0	9,9	9,0	9,0	9,0
Transferi nga niveli qendror, komunal dhe rritja e THV :					
Financimi për rritjen e pagave për shërbyesit civil prej 30 €		2,52	3,75	3,75	3,75
Transferi nga MPB për shtesat e zjarrëfikësve prej 107 €		0,92	0,92	0,92	0,92
Transferi nga MPMS implementimi i strategjisë punësimi		1,90			
Transferi i kompetencave nga MBPZHR në komuna për Pyje		0,49	0,98	0,98	0,98
Transferi nga ZKM për Graçanicë		0,13			
Transferi nga MPMS implementimi i strategjisë punësimi		0,25			
Transferi nga MFS për Istog		0,04			
Financimi për rritjen e pagave në shëndetësi (44 € dhe 30%)		2,98	3,08	3,08	3,08
Transferi nga komunat në MPB çertifikatat e gjendjes civile		(0,70)			
Kujdesi shëndetësor dytësor		0,24	0,24	0,24	0,24
Zbritja për financimin e RTK-së		(0,80)			
Transferi me vendim të Qeverisë (Shtërpcë dhe Grçanicë)		0,33			
Rritja e të Hyrave vetanake komunale (THV)		1,59			
7. TOTAL FINANCIMI KOMUNAL	248,10	294,39	311,73	324,85	335,92

Koment:

1. Azhurimi i KASH Komunal me proces të rishikimit të buxhetit për vitin 2010 dhe vitin 2011-2013.
2. Financimi për rritjen e pagave (30 % dhe 44 €) për shëndetësinë shuma prej 3 milion euro nuk është e përfshirë për vitin 2011 në komuna (përfshirë komunën e Shtërpcës dhe Mitrovicë Veriore).
3. Financimi prej 1.5 mil. € për komunat e reja dhe komunat veriore për 2011 mbahet në kuadër të MEF (nuk është e shpërndarë)
4. Implikimet financiare tjera për ligjin e shërbyesve civil dhe pagave nuk janë të përfshira.

Implikimet financiare tjera për ligjin e shërbyesve civil dhe pagave nuk janë të përfshira

Financimi Komunal për vitin 2011 - Grantet qeveritare dhe të Hyrat vetanake komunale

Komitat	Granti i Përgjithshëm	Rritja e Pagave për shërbuesit civil (30 €)	Zërfikasat (107 €)	Totali Granti i Përgjithshëm	Financimi për APK (Agjensioni Pjor i Kosovës)	Politikat e reja të IMSHT			Totali Granti specifik i Arsimit - 2011	Granti specifik i Shëndetësisë - 2011			Totali Granti specifik i Shëndetësisë (44 Shëndetësisë)	Financimi për Shëndësi Shtetërore	Financimi specifik për Shërimin Sociale	Financimi specifik për Kulturë (Teatro dhe Bibliotekë)	Projeksionet e të hyrave vetanake komunale për vitin 2011	TOTAL FINANCIIMI KOMUNAL 2011	
						Pedagogë	Qendra e Gjitha jashtlandit anglize	Totali Granti specifik i Arsimit - 2011		5% e performancës në shëndetësi	Granti specifik i Shëndetësisë	Rritjen e pagave në shëndetësi (€ në 30%)							
Kalkulimet >>																			
1. Deçan	1,916,837	69,277	19,260	2,004,904	55,692			2,020,346	534,754	26,738	351,492	63,105	624,997		27,036		513,400	5,238,875	
2. Degash	2,119,337	72,491	23,112	2,204,900	37,056			1,729,073	463,277	23,164	486,441	53,777	540,158		26,489		366,221	4,919,467	
3. Ferizaj	4,822,922	172,836	42,372	5,038,129	47,712			7,020,939	1,469,250	73,462	1,542,712	164,282	1,706,994		39,613		2,816,181	16,741,547	
4. Fushë Kosovë	1,619,976	74,391	7,704	1,702,671	3,540			1,793,771	445,831	22,292	468,123	56,325	524,448		26,778		650,774	4,912,461	
5. Grahovë	5,187,168	195,333	59,064	5,441,565	44,616			5,746,724	1,322,255	76,110	1,398,365	187,751	1,786,056		42,310		2,644,990	15,735,984	
6. Gjanë	4,445,246	197,475	41,088	4,683,809	37,056			6,164,309	1,302,255	66,413	1,384,667	165,847	1,560,514		42,595		3,000,000	15,553,970	
7. Glogoc	2,673,826	101,416	20,544	2,795,786	19,308			3,497,160	794,180	39,709	833,888	97,004	930,893		34,278		647,668	8,075,104	
8. Hani Elezit	583,118	19,640	7,704	610,462	11,100			460,376	132,365	6,618	138,983	15,124	154,107		6,981		131,982	1,375,007	
9. Isog	2,219,215	91,000	15,408	2,315,683	54,816			2,588,976	582,405	29,120	611,526	66,713	677,238		31,416		764,183	6,425,211	
10. Junik	562,198	17,468	5,136	584,832	14,640			325,976	127,070	6,354	133,424	13,038	146,462		6,981		50,650	1,133,740	
11. Kazanik	1,567,011	67,849	23,112	1,657,972	30,408			1,949,656	436,804	21,840	458,644	56,803	514,447		23,098		566,781	4,754,340	
12. Kanerëç	2,466,763	115,343	24,336	2,606,522	34,500			2,235,463	656,278	32,814	689,092	77,706	766,800		46,488		562,500	6,265,793	
13. Klinë	2,107,070	79,990	20,544	2,207,604	26,412			2,447,254	592,405	29,120	611,526	10,463	626,989		26,776		630,000	6,035,642	
14. Leposaviq	1,507,834	71,777	17,976	1,597,587	54,816			597,099	251,493	12,575	264,068	1,043	265,111		-		7,638	2,534,007	
15. Lujan	3,200,202	124,984	23,112	3,348,288	25,988			3,825,226	914,840	45,742	960,582	127,253	1,087,835		32,163		964,846	9,304,856	
16. Maishinë	2,374,295	90,346	24,336	2,489,037	26,856			3,849,680	888,297	34,415	722,712	66,234	788,946		27,624		834,345	8,048,889	
17. Mamusha	489,969	13,570	8,988	512,526	-			251,147	78,419	3,971	83,390	8,345	91,735		6,981		67,317	934,906	
18. Mitrovicë	3,894,651	298,181	88,536	4,250,028	33,516			4,477,969	1,191,294	59,584	1,250,846	161,674	1,412,522		72,523		1,656,226	11,985,910	
19. Novo Bredë	875,645	29,639	8,988	914,272	8,208			806,958	131,028	6,551	137,579	10,952	148,532		14,369		29,063	1,928,511	
20. Obiliq	1,318,090	59,635	-	1,377,726	-			1,423,933	344,149	17,207	361,356	55,282	416,638		28,193		494,638	3,750,028	
21. Pejë	5,370,611	296,046	50,076	5,626,732	58,800			5,553,295	1,522,136	76,110	1,598,305	196,616	1,794,922		39,051		2,300,600	15,356,665	
22. Podujevë	5,153,607	151,767	23,112	5,328,485	59,244			5,676,066	1,548,689	77,433	1,626,102	133,511	1,759,613		32,861		1,075,000	13,957,869	
23. Prishtinë	16,211,754	480,300	150,228	16,822,282	41,052			11,890,777	5,143,181	257,159	5,400,340	454,252	5,854,593		103,819		73,938	20,752,922	
24. Pritren	9,866,431	219,258	37,236	10,122,925	47,712			9,933,972	2,845,354	142,288	2,987,622	250,334	3,237,956		52,520		45,691	5,121,830	
25. Raanec	2,845,211	88,989	24,336	2,959,596	22,860			3,741,334	833,898	41,695	875,593	67,278	942,871		35,562		715,500	8,636,524	
26. Shkup	978,475	32,466	19,260	1,030,231	25,392			643,245	145,601	7,290	152,891	14,091	166,962		16,355		69,035	2,483,190	
27. Shme	1,340,096	47,851	10,272	1,388,219	15,312			1,740,892	370,622	16,531	389,153	39,636	428,789		25,075		372,223	3,991,610	
28. Skenderaj	2,580,002	123,913	23,112	2,727,027	29,952			3,376,945	741,243	37,062	778,306	97,004	875,310		40,337		463,000	7,541,360	
29. Suvarëç	3,268,877	106,068	20,544	3,653,479	29,952			3,726,172	1,069,919	52,946	1,111,866	76,751	1,190,616		31,452		1,531,717	10,182,888	
30. Viti	2,141,309	90,346	28,248	2,259,903	33,516			3,107,076	614,941	30,747	645,688	72,493	718,180		27,342		882,116	6,844,635	
31. Vushtrri	3,376,014	143,196	39,804	3,559,014	26,412			4,354,325	992,736	49,637	1,042,373	109,521	1,151,894		29,894		1,315,000	10,458,438	
32. Zhan Ploçk	1,178,265	60,707	14,124	1,253,096	30,336			338,226	198,547	9,927	208,475	522	208,997		-		7,856	1,844,271	
33. Zveçan	1,110,208	37,852	-	1,148,060	-			305,769	217,784	10,569	222,373	1,565	223,938		-		4,118	1,686,924	
34. Graçaninë	1,315,291	26,088	-	1,341,359	-			1,151,281	246,735	12,338	259,092	19,186	278,278		3,032		400,000	4,304,921	
35. Kllok	435,909	714	-	436,623	-			256,979	60,120	3,006	63,126	7,823	70,949		-		8,390	777,735	
36. Mitrovicë e Re	1,301,676	-	-	1,301,676	-			838,034	264,720	13,226	277,966	-	277,966		-		-	3,412,712	
37. Pataresh	444,859	-	-	444,859	-			274,133	69,035	3,453	72,507	-	72,507		-		-	793,400	
38. Prillëz	452,964	13,927	-	466,891	-			222,972	65,597	3,279	68,866	20,339	89,205		-		40,000	834,468	
TOTAL	105,560,000	3,743,820	921,912	110,225,732	986,820			109,818,079	29,695,524	1,460,476	31,090,000	3,081,084	34,171,084		1,000,000		396,043	51,897,711	311,735,906

Koment: Me proces të rishikimit të Buxhetit për vitin 2010 është azhurnuar KASH Komunal 2011-2013, transfere nga niveli qendror dhe financime shtesë për rritjen e pagave (rritja e granteve qeveritare)

Granti i Përgjithshëm

Komunat do të pranojnë Grant të përgjithshëm i cili është grant i sistemit të mbyllur dhe do të mund ta shfrytëzohet për ushtrimin e kompetencave caktuara komunale në përputhje me ligjet e zbatueshme në Kosovë.

Granti i përgjithshëm mundëson një shkallë të arsyeshme të qëndrueshmërisë në të hyrat komunale, gjithashtu është mjet adekuat për vendosjen e barazive ndërmjet komunave, dhe mundëson alokimin adekuat të burimeve për komunitet pakicë në komunat përkatëse.

Shuma e Grantit të përgjithshëm është dhjetë përqind (10%) e të hyrave totale të buxhetuara të Qeverisë qendrore, duke përfshiruar të hyrat nga shitja e aseteve, të hyrat tjera të jashtëzakonshme, të hyrat e dedikuara dhe të hyrat nga huamarrja.

Me qëllim të nivelizimit të kapacitetit të ulët të të hyrave vetanake të komunave më të vogla, secila komunë do të pranojë për çdo vit një shumë të përgjithshme fikse (paushalle) prej 140,000 € minus 1 € për kokë banori, ose 0 € për komunat me popullsi të barabartë ose më të madhe se 140,000 banorë.

Indikatorët që janë përdorur për alokimin e grantit të përgjithshëm në komuna janë: Popullsia llogaritet me tetëdhjetë e nëntë përqind (89%); numri i popullsisë pakicë (3%); komunat, shumica e popullsisë së të cilave përbëhet nga pakicat kombëtare me dy përqind (2%); dhe përmasat gjeografike të komunës me gjashtë përqind (6%).

Para procesit të rishikimit të buxhetit për vitin 2010 sipas Marrëveshjes së Mirëkuptimit janë transferuar 8 punëtorë si kompetencë e bartur për shërbime sociale nga MPMS në komunën e Shtërpcës me shumën buxhetore, si vijon: për paga e mëditje prej 17,089 euro, mallëra dhe shërbime prej 12,000 euro dhe komunalit prej 3,000 euro.

Me vendim të Qeverisë nr. 03/108 datë 04.02.2010 janë transferuar në komunën e Shtërpcës në kategorinë ekonomike investime kapitale shuma prej 300,000 euro për financimin e borgjeve të vjetra.

Me vendim të Kuvendit të Republikës së Kosovës Nr.03-V-237 datë 28 janar 2010, është bërë zbritja e grantit të përgjithshëm nga kategoria ekonomike mallra dhe shërbime në shumë prej 381,668 euro për financimin e RTK-së (shih pikën 1 më lartë - Burimet e Financimit Komunal).

Me proces të rishikimit të buxhetit për vitin 2010 janë transferuar disa financime nga niveli qendror në komuna: është bërë rritja e pagave për shërbyesit civil për 30 € në shumë prej 2.52 mil. € (kalkulimi i kostos është bërë për 8 muaj), transferi i kompetencave nga MBPZHR në komuna për Pyje në shumë prej 0.49 mil. € transferi nga MPB për shtesat e zjarrfikësve për 107 € në shumë prej 0.92 mil. € transferi nga MPMS për implementimin e strategjisë së punësisimit në shumë prej 2.15 mil. € transferi nga ZKM për komunën e Graçanicës në shumë prej 0.13 mil. € transferi nga MFS për komunën e Istogut në shumë prej 0.04 mil. € (të cilat kanë rezultuar në rritjen e Grantit të Përgjithshëm). Ndërsa, shuma prej 700,000 € për çertifikatat e gjendjes civile është transferuar nga komunat në MPB (duke rezultuar në zbritjen e Grantit të Përgjithshëm).

Ndërsa për vitin 2011 kalkulimi për rritjen e pagave për shërbyesit civil për 30 € është bërë për 12 muaj duke rezultuar me financimin e kostos prej 3.75 milion euro, financimi për transferin e kompetencave nga MBPZHR në komuna për Pyje për 12 muaj në shumë prej 0.98 mil.€ si dhe transferi nga MPB për shtesat e zjarrefikësve për 107 € në shumë prej 0.92 mil. €

Struktura e Grantit të Përgjithshëm për periudhën 2009-2013

Kriteret e formulës	Faktorët	2009	2010	2011	2012	2013
		Buxheti	Buxheti	Buxheti	Vlerësimi	Vlerësimi
Shuma agregate	Të hyrat buxhetore (mil euro)	850	942	1.056,00	1.131,00	1.186,00
	Total Granti i Përgjithshëm	85,00	97,63	110,23	117,77	123,27
	Rritja e Pagave për shërbyesit civil (30 €) dhe zjarrefiksa		3,43	4,67	4,67	4,67
	Parametri: 10% e të hyrave buxhetore (mil euro)	85	94,2	105,56	113,1	118,6
Elementet	Shuma Fikëse		3,4	3,40	3,4	3,4
	Popullsia *	2.236.963	2.236.963	2.236.963	2.236.963	2.236.963
	Parametri: 89% e shumës agregate	72,6	80,8	90,91	97,6	102,4
	Zona komunale (km ²)	10.901	10.901	10.901	10.901	10.901
	Parametri: 6% e shumës agregate	4,9	5,4	6,13	6,5	6,9
	Komunitetet pakicë në komunë	116.599	116.599	116.599	116.599	116.599
	Parametri: 3% e shumës agregate	2,5	2,7	3,06	3,3	3,5
	Popullsia e komunave pakicë	130.255	130.255	130.255	130.255	130.255
	Parametri: 2% e shumës agregate	1,6	1,8	2,04	2,2	2,3

Struktura e Grantit të Përgjithshëm për vitin 2010 në kuadër të periudhës 2009-2013 praqet gjendjen fillestare, ndërsa ndryshimet e prezantuara me proces të rishikimit të buxhetit për vitin 2010 në Grantin e Përgjithshëm janë paraqitur edhe në Tabelën 1.

Granti i Përgjithshëm - Formulart e ndarjes

	Viti 2011	Viti 2012	Viti 2013	
Të hyrat e Buxhetuara në Buxhetin e Kosovës (m€)	1.055,6	1.131,4	1.186,1	
Granti i Përgjithshëm (10%)	105.560.000	113.140.000	118.610.000	
Shuma Fikse	140.000	3.406.561	3.406.561	
	102.153.439	109.733.439	115.203.439	
Popullata në %	89%	90.916.561	97.662.761	102.531.061
Popullata Pakicë	3%	3.064.603	3.292.003	3.456.103
Komunat me Popullatë Pakicë	2%	2.043.069	2.194.669	2.304.069
Siperfaqja Komunale	6%	6.129.206	6.584.006	6.912.206
	102.153.439	109.733.439	115.203.439	

Komuna	Kriteret								Viti 2011								
	Kriteret për kalkulimin e grantit të përgjithshëm								Formula për kalkulimin e grantit të përgjithshëm								
	Popullata	Popullata %	Siperfaqja	Siperfaqja %	Popullat Minoritare në Komuna	Popullat Minoritare në Komuna %	Komunat Minoritare në Kosovë	Komunat Minoritare në Kosovë %	Shuma Fikse	Popullata	Popullata minoritare në Komuna	Komunat minoritare në Kosovë	Siperfaqja	Totali granti i përgjithshëm	Rritja e Pagave për shërbysit civil (30 €)	Zjarfiksat (107 €)	Totali granti i përgjithshëm
1 Deçan	40.400	1,81%	297	2,73%	294	0,25%		0,00%	99.600	1.641.971	7.727	-	167.068	1.916.367	69.277	19.260	2.004.904
2 Dragash	35.000	1,56%	430	3,95%	12.935	11,09%		0,00%	105.000	1.422.500	339.974	-	241.883	2.109.357	72.491	23.112	2.204.960
3 Ferizaj	111.000	4,96%	345	3,17%	3.367	2,89%		0,00%	29.000	4.511.357	88.496	-	194.069	4.822.922	172.836	42.372	5.038.129
4 Fushë Kosovë	33.682	1,51%	83	0,76%	3.730	3,20%		0,00%	106.318	1.368.933	98.037	-	46.689	1.619.976	74.991	7.704	1.702.671
5 Gjakovë	115.000	5,14%	587	5,39%	6.013	5,16%		0,00%	25.000	4.673.928	158.041	-	330.199	5.187.168	195.333	59.064	5.441.565
6 Gillan	100.348	4,49%	392	3,60%	4.058	3,48%		0,00%	39.652	4.078.429	106.658	-	220.507	4.445.246	197.475	41.088	4.683.809
7 Glogoc	60.000	2,68%	276	2,53%		0,00%		0,00%	80.000	2.438.571	-	-	155.255	2.673.826	101.416	20.544	2.795.786
8 Hani i Elezit	10.000	0,45%	83	0,76%		0,00%		0,00%	130.000	406.429	-	-	46.689	583.118	19.640	7.704	610.462
9 Istog	44.000	1,97%	454	4,17%	2.646	2,27%		0,00%	96.000	1.788.286	69.546	-	255.384	2.209.215	91.060	15.408	2.315.683
10 Junik	9.600	0,43%	74	0,68%		0,00%		0,00%	130.400	390.171	-	-	41.626	562.198	17.498	5.136	584.832
11 Kaçanik	33.000	1,48%	211	1,94%	4	0,00%		0,00%	107.000	1.341.214	105	-	118.891	1.567.011	67.849	23.112	1.657.972
12 Kamenicë	49.581	2,22%	424	3,89%	4.670	4,01%		0,00%	90.419	2.015.113	122.743	-	238.508	2.466.783	115.343	24.396	2.606.522
13 Klinë	44.000	1,97%	309	2,84%	1.863	1,60%		0,00%	96.000	1.788.286	48.966	-	173.818	2.107.070	79.990	20.544	2.207.604
14 Leposaviq	19.000	0,85%	539	4,95%	510	0,44%	19.000	14,59%	121.000	772.214	13.404	298.018	303.198	1.507.834	71.777	17.976	1.597.587
15 Lipjan	69.115	3,09%	338	3,10%	4.952	4,25%		0,00%	70.885	2.809.031	130.155	-	190.131	3.200.202	124.984	23.112	3.348.298
16 Malishevë	52.000	2,32%	306	2,81%	28	0,02%		0,00%	88.000	2.113.428	736	-	172.131	2.374.295	90.346	24.396	2.489.037
17 Mamusha	6.000	0,27%	32	0,29%		0,00%	6.000	4,61%	134.000	243.857	-	94.111	18.001	489.969	13.570	8.988	512.526
18 Mitrovicë (Jug)	90.000	4,02%	331	3,04%		0,00%		0,00%	50.000	3.657.857	-	-	186.194	3.894.051	268.181	88.596	4.250.828
19 Novo Bërdë	9.899	0,44%	204	1,87%	2.785	2,39%	9.899	7,60%	130.101	402.324	73.199	155.267	114.754	875.645	29.639	8.988	914.272
20 Obiliq	26.000	1,16%	105	0,96%	3.360	2,88%		0,00%	114.000	1.056.714	88.312	-	59.064	1.318.090	59.635		1.377.726
21 Pejë	115.000	5,14%	603	5,53%	12.650	10,85%		0,00%	25.000	4.673.928	332.483	-	339.199	5.370.611	206.046	50.076	5.626.732
22 Podujevë	117.000	5,23%	633	5,81%	735	0,63%		0,00%	23.000	4.755.214	19.318	-	356.074	5.153.607	151.767	23.112	5.328.485
23 Prishtinë	388.561	17,37%	514	4,72%	4.961	4,25%		0,00%		15.792.228	130.391	-	289.135	16.211.754	460.300	150.228	16.822.282
24 Prizren	214.963	9,61%	603	5,53%	30.077	25,80%		0,00%		8.736.710	790.522	-	339.199	9.866.431	219.258	37.236	10.122.925
25 Rahovec	63.000	2,82%	278	2,55%	1.953	1,67%		0,00%	77.000	2.560.500	51.331	-	156.380	2.845.211	89.989	24.396	2.959.596
26 Shtërpcë	11.000	0,49%	248	2,28%	3.438	2,95%	11.000	8,44%	129.000	447.071	90.362	172.537	139.505	978.475	32.496	19.260	1.030.231
27 Shtime	28.000	1,25%	134	1,23%	560	0,48%		0,00%	112.000	1.138.000	14.719	-	75.378	1.340.096	47.851	10.272	1.398.219
28 Skenderaj	56.000	2,50%	374	3,43%	366	0,31%		0,00%	84.000	2.276.000	9.620	-	210.382	2.580.002	123.913	23.112	2.727.027
29 Suharekë	80.000	3,58%	361	3,31%	471	0,40%		0,00%	60.000	3.251.428	12.379	-	203.069	3.526.877	106.058	20.544	3.653.479
30 Viti	46.458	2,08%	270	2,48%	293	0,25%		0,00%	93.542	1.888.186	7.701	-	151.880	2.141.309	90.346	28.248	2.259.903
31 Vushitri	75.000	3,35%	345	3,17%	2.615	2,24%		0,00%	65.000	3.048.214	68.731	-	194.069	3.376.014	143.196	39.804	3.559.014
32 Zubin Potok	15.000	0,67%	333	3,06%	800	0,69%	15.000	11,52%	125.000	609.643	21.027	235.277	187.319	1.178.265	60.707	14.124	1.253.096
33 Zveçan	16.000	0,72%	123	1,13%	600	0,51%	16.000	12,28%	124.000	650.286	15.770	250.962	69.190	1.110.208	37.852		1.148.060
34 Gracanicë	18.642	0,83%	131	1,20%	2.670	2,29%	18.642	14,31%	121.358	757.664	70.176	292.403	73.690	1.315.291	26.068		1.341.359
35 Kllokot (Viti)	4.542	0,20%	23	0,21%	1.205	1,03%	4.542	3,49%	135.458	184.600	31.671	71.242	12.938	435.909	714		436.623
36 Mitrovica e Veriut	20.000	0,89%	5	0,05%	1.990	1,71%	20.000	15,35%	120.000	812.857	52.304	313.703	2.813	1.301.676	-		1.301.676
37 Partesh (Gjilan)	5.217	0,23%	29	0,27%		0,00%	5.217	4,01%	134.783	212.034	-	81.829	16.313	444.959	-		444.959
38 Ranillug (Kamenica)	4.955	0,22%	69	0,63%		0,00%	4.955	3,80%	135.045	201.385	-	77.720	38.814	452.964	13.927		466.891
TOTAL	2.236.963	100%	10.896	100%	116.599	100%	130.255	100%	3.406.561	90.916.561	3.064.603	2.043.069	6.129.206	105.560.000	3.743.820	921.912	110.225.732

Granti specifik për Arsim

Granti Specifik për Arsim bazohet në një qasje me sistem të hapur të financimit sipas LFPL duke marrë parasysh kriteret dhe politikat e arsimit para universitar nga MASHT.

Granti specifik i arsimit për vitin 2010 fillimisht ka qenë në shumë prej 108,7 milion euro dhe me vendim të qeverisë ka pasur rritje të stafit për 181 mësimdhënës në shumë prej 0.6 milionë euro, që në buxhetin e vitin 2010 ka rezultuar në shumë prej 109.3 milion euro.

Me vendim të Kuvendit të Republikës së Kosovës Nr.03-V-237 datë 28 janar 2010, është bërë zbritja e grantit specifik të arsimit nga kategoria ekonomike mallra dhe shërbime në shumë prej 260,481 euro për financimin e RTK-së (shih pikën 1 më lartë - Burimet e Financimit Komunal).

Propozim Granti specifik i Arsimit parauniversitar nga MASHT për vitin 2011 është aprovuar nga Komisioni i Granteve në shumë prej 109.8 milion euro bazuar në formulën shtetërore të arsimit parauniversitar nga MASHT, si dhe politikat e reja të MASHT-it në shumë prej 647,360 € e që rezulton me total grantin specifik të Arsimit për vitin 2011 në shumë prej 110,465,439 €

Financimi i grantit të arsimit, i përcaktuar nga Komisioni i Granteve për periudhën e KASH-it, është mbështetur në, dhe synon të mbështesë objektivat e MASHT-it për edukimin parauniversitar (shih gjithashtu Strategjitë sektoriale). Krahasuar me vitin e kaluar, formula e grantit është ndryshuar për të marrë parasysh elementet e reformës në vijim: (a) reduktimi i proporcioneve normative mësimdhënës-nxënës për arsimin në entet para shkollore (1:12) dhe në shkollat profesionale (1:17), (b) implementimi i proporcioneve normative për stafin administrativ dhe ndihmës, i rregulluar përmes formulës, (c) implementimi i financimit shtesë për mësimdhënësit e shkollave në zonat malore, (d) financimi për këshilltarët në nivel të komunës.

Tabela: Granti specifik i Arsimit parauniversitar 2010 – 2011

<u>ANALIZA: Granti specifik për Arsim 2011</u>	Viti 2010	Viti 2011
Parametrat		
Total numri i nxënësve		467,311
Nxenes ne shkollat fillore		355,275
Shumice (93%)		345,423
Pakice (7%)		9,852
Nxenes ne shkolla te mesme		112,036
Shumice (93%)		108,668
Pakice (7%)		3,368
Numri i Shkollave		1,228
Shkolla fillore		1,077
Shkolla te mesme		151
Total I Mesimdhenesve (fillor, mesem)		23,636
Numri I mesimdhenesve per nivelin fillor		17,965
Numri I mesimdhenesve per nivelin e mesem		5,671
Kalkulimet baze + inflacioni per mallera dhe kapitale prej të cilave komponentet e grantit:	109,291,317	109,818,079
Totali i Pagave (euro)		93,666,065
Drejtor (340 euro)		5,157,600
Pagat fillore (260 euro)		56,050,653
Pagat mesme (270 euro)		18,379,462
Pushimet e Leonise (3% e total pagave)		2,624,350
Personel administrativ (250 euro)		5,292,000
Personel ndihmes (130 euro)		6,162,000
Mallerat dhe Sherbimet (euro)		12,880,843
Mallerat per cdo nxenes (23€ shumice)		10,444,093
Mallerat per cdo nxenes (25€ pakice)		330,500
Shkolla fillore (1500 €)		1,615,500
Shkolla mesme (3250 €)		490,750
Kapitalet (7€)		3,271,177
Politikat e reja		647,360
Gjuha angleze (nga klasa e pare)		457,800
Pedagog (40 pesona shtese)		144,000
Qendra e ekselencës (36 pozita për katër qendrat e ekselences)		45,560
Total Granti specifik për Arsim për vitin 2011		110,465,439

Granti specifik për Shëndetësi

Granti specifik për Shëndetësi dhe përcaktimi i shumës së këtij granti bazohet në një qasje me sistem të hapur të financimit në përputhje me LFPL.

Granti specifik i shëndetësisë për vitin 2010 ka qenë në shumë 27.43 milion euro.

Me vendim të Kuvendit të Republikës së Kosovës Nr.03-V-237 datë 28 janar 2010, është bërë zbritja e grantit specifik të shëndetësisë nga kategoria ekonomike mallra dhe shërbime në shumë prej 147,175 euro për financimin e RTK-së (shih pikën 1 më lartë - Burimet e Financimit Komunal).

Propozim Granti specifik i shëndetësisë nga MSH për vitin 2011 është aprovuar nga Komisioni i Granteve në shumë prej 31.09 milion euro, bazuar në formulën për kokë banori, numrit të vizitave shëndetësore dhe koston mesatare për vizitë. Përshtatjet në parametrat e formulës janë bërë për të marrë parasysh rritjen nominale të popullsisë, inflacionin dhe koston e ofrimit të kujdesit shëndetësor primar.

328	Këshilli Gjygsor i Kosoves	1,929	14,251,258	2,280,485	16,531,743	14,292,615	1,988,900	16,281,515	14,292,615	1,148,900	15,441,515
	Paga dhe Meditje		9,211,071		9,211,071	9,211,071		9,211,071	9,211,071		9,211,071
	Mallra dhe sherbime		4,456,712		4,456,712	4,498,069		4,498,069	4,498,069		4,498,069
	Shpenzime Komunale		583,475		583,475	583,475		583,475	583,475		583,475
	Subvencione dhe Transfere				-			-			-
	Shpenzime Kapitale			2,280,485	2,280,485		1,988,900	1,988,900		1,148,900	1,148,900
	Rezerva				-			-			-

Korniza Afatmesme e Shpenzimeve 2011-2013

313	Zyra Rregullative e Ujit dhe Mbeturinave	19	346,006	-	346,006	347,040	-	347,040	347,040	-	347,040
	Paga dhe Meditje		161,450		161,450	161,450		161,450	161,450		161,450
	Mallra dhe sherbime		177,906		177,906	178,940		178,940	178,940		178,940
	Shpenzime Komunale		6,650		6,650	6,650		6,650	6,650		6,650
	Subvencione dhe Transfere				-						
	Shpenzime Kapitale										
	Rezerva										
317	Zyra Rregullative e Aviacionit Civil	21	838,021	-	838,021	840,543	-	840,543	840,543	-	840,543
	Paga dhe Meditje		425,000		425,000	425,000		425,000	425,000		425,000
	Mallra dhe sherbime		403,721		403,721	406,243		406,243	406,243		406,243
	Shpenzime Komunale		9,300		9,300	9,300		9,300	9,300		9,300
	Subvencione dhe Transfere				-						-
	Shpenzime Kapitale										
	Rezerva										
314	Zyra Rregullative e Hekurudhave	9	173,570	-	173,570	174,092	-	174,092	174,092	-	174,092
	Paga dhe Meditje		58,092		58,092	58,092		58,092	58,092		58,092
	Mallra dhe sherbime		101,478		101,478	102,000		102,000	102,000		102,000
	Shpenzime Komunale		14,000		14,000	14,000		14,000	14,000		14,000
	Subvencione dhe Transfere				-			-	-		-
	Shpenzime Kapitale										
	Rezerva										
318	Komisioni i Pavarur i Minierave dhe Mineraleve	79	1,170,986	325,000	1,495,986	1,174,435	550,000	1,724,435	1,174,435	700,000	1,874,435
	Paga dhe Meditje		516,287		516,287	516,287		516,287	516,287		516,287
	Mallra dhe sherbime		598,699		598,699	602,148		602,148	602,148		602,148
	Shpenzime Komunale		36,000		36,000	36,000		36,000	36,000		36,000
	Subvencione dhe Transfere		20,000		20,000	20,000		20,000	20,000		20,000
	Shpenzime Kapitale			325,000	325,000		550,000	550,000		700,000	700,000
	Rezerva				-			-			
319	Komisioni i Pavarur i Mediave	31	476,879	450,000	926,879	478,285	240,000	718,285	478,285	-	478,285
	Paga dhe Meditje		194,409		194,409	194,409		194,409	194,409		194,409
	Mallra dhe sherbime		270,470		270,470	271,876		271,876	271,876		271,876
	Shpenzime Komunale		12,000		12,000	12,000		12,000	12,000		12,000
	Subvencione dhe Transfere				-			-	-		-
	Shpenzime Kapitale			450,000	450,000	-	240,000	240,000	-		-
	Rezerva				-			-			-
320	Komisioni Qendror i Zgjedhjeve	85	6,361,466	24,700	6,386,166	459,072	-	459,072	6,159,072	-	6,159,072
	Paga dhe Meditje		412,332		412,332	412,332		412,332	412,332		412,332
	Mallra dhe sherbime		5,902,394		5,902,394	46,740		46,740	5,746,740		5,746,740
	Shpenzime Komunale		46,740		46,740			-	-		-
	Subvencione dhe Transfere				-			-	-		-
	Shpenzime Kapitale			24,700	24,700			-	-		-
	Rezerva				-			-	-		-
321	Ombudspersoni	47	536,204	-	536,204	537,775	-	537,775	537,775	-	537,775
	Paga dhe Meditje		290,453		290,453	290,453		290,453	290,453		290,453
	Mallra dhe sherbime		191,751		191,751	193,322		193,322	193,322		193,322
	Shpenzime Komunale		54,000		54,000	54,000		54,000	54,000		54,000
	Subvencione dhe Transfere				-			-	-		-
	Shpenzime Kapitale				-			-	-		-
	Rezerva				-			-	-		-
322	Instituti Gjyqësor i Kosovës	21	592,176	-	592,176	593,936	-	593,936	593,936	-	593,936
	Paga dhe Meditje		121,023		121,023	121,023		121,023	121,023		121,023
	Mallra dhe sherbime		454,753		454,753	456,513		456,513	456,513		456,513
	Shpenzime Komunale		16,400		16,400	16,400		16,400	16,400		16,400
	Subvencione dhe Transfere				-			-	-		-
	Shpenzime Kapitale				-			-	-		-
	Rezerva				-			-	-		-

Korniza Afatmesme e Shpenzimeve 2011-2013

329	Agjencioni Kosovar i Prones	242	1,535,670	45,000	1,580,670	1,535,670	-	1,535,670	-	-	-
	Paga dhe Meditje		700,160		700,160	700,160		700,160			-
	Mallra dhe sherbime		730,510		730,510	730,510		730,510			-
	Shpenzime Komunale		105,000		105,000	105,000		105,000			-
	Subvencione dhe Transfere				-			-			-
	Shpenzime Kapitale			45,000	45,000			-			-
	Rezerva			-	-			-			-
245	Agjensioni Kosovar i Intelegjencës	90	1,629,098	400,000	2,029,098	1,634,000	-	1,634,000	1,634,000	-	1,634,000
	Paga dhe Meditje		1,037,850		1,037,850	1,037,850		1,037,850			1,037,850
	Mallra dhe sherbime		491,248		491,248	491,248		491,248			491,248
	Shpenzime Komunale		50,000		50,000	50,000		50,000			50,000
	Subvencione dhe Transfere		50,000		50,000	54,902		54,902			54,902
	Shpenzime Kapitale			400,000	400,000			-			-
	Rezerva				-			-			-
246	Keshilli i Kosoves per Trashegemi Kulturore	16	142,377	-	142,377	142,800	-	142,800	142,800	-	142,800
	Paga dhe Meditje		71,800		71,800	71,800		71,800			71,800
	Mallra dhe sherbime		69,577		69,577	70,000		70,000			70,000
	Shpenzime Komunale		1,000		1,000	1,000		1,000			1,000
	Subvencione dhe Transfere				-			-			-
	Shpenzime Kapitale				-			-			-
	Rezerva				-			-			-
247	Komisioni Zgjedhor për Parashtresa dhe Ankesa	15	203,883	40,000	243,883	204,491	-	204,491	204,491	-	204,491
	Paga dhe Meditje		95,081		95,081	95,081		95,081			95,081
	Mallra dhe sherbime		99,602		99,602	100,210		100,210			100,210
	Shpenzime Komunale		9,200		9,200	9,200		9,200			9,200
	Subvencione dhe Transfere				-			-			-
	Shpenzime Kapitale			40,000	40,000			-			-
	Rezerva				-			-			-
248	Radio Televizioni i Kosovës	-	9,000,000	-	9,000,000	9,000,000	-	9,000,000	9,000,000	-	9,000,000
	Paga dhe Meditje				-			-			-
	Mallra dhe sherbime				-			-			-
	Shpenzime Komunale				-			-			-
	Subvencione dhe Transfere		9,000,000		9,000,000	9,000,000		9,000,000			9,000,000
	Shpenzime Kapitale				-			-			-
	Rezerva				-			-			-
232	Shpenzimet e paparashikuara	-	2,500,000	2,500,000	5,000,000	1,500,000	3,500,000	5,000,000	1,500,000	3,500,000	5,000,000
	Paga dhe Meditje				-			-			-
	Mallra dhe sherbime				-			-			-
	Shpenzime Komunale				-			-			-
	Subvencione dhe Transfere				-			-			-
	Shpenzime Kapitale			2,500,000	2,500,000			-			-
	Rezerva		2,500,000	-	2,500,000	1,500,000	3,500,000	5,000,000	1,500,000	3,500,000	5,000,000
Totali i Pergjithshëm		34,906	600,646,128	486,208,916	1,086,855,044	575,055,685	506,512,594	1,081,568,279	579,217,461	485,193,502	1,064,410,963
	Te punesuarit	34,906									
	Paga dhe Meditje		166,778,349	-	166,778,349	166,782,024	-	166,782,024	166,081,864	-	166,081,864
	Mallra dhe sherbime		143,855,168	-	143,855,168	138,957,254	-	138,957,254	143,934,190	-	143,934,190
	Shpenzime Komunale		14,700,504	-	14,700,504	14,635,905	-	14,635,905	14,520,905	-	14,520,905
	Subvencione dhe Transfere		271,812,107	-	271,812,107	252,180,502	-	252,180,502	252,180,502	-	252,180,502
	Shpenzime Kapitale		-	486,208,916	486,208,916	-	503,012,594	503,012,594	-	481,693,502	481,693,502
	Rezerva		3,500,000	-	3,500,000	2,500,000	3,500,000	6,000,000	2,500,000	3,500,000	6,000,000

SEKTORI I ZHVILLIMIT EKONOMIK


Sektori i zhvillimit ekonomik është një sektor tejet i rëndësishëm në Kosovë pasi që zhvillimi i ekonomisë është ndikuar nga një mori faktorësh. Ndër këta faktorë bën pjesë infrastruktura fizike e shtetit, disponueshmëria e kapitalit, kushtet rregullative e po ashtu edhe vet statusi mjedisor i Kosovës dhe cilësia e përgjithshme e jetës. Të gjithë këta faktorë kontribuojnë në mënyra të ndryshme në kushtet e biznesit. Një mjedis i mirë për biznese është i rëndësishëm në sigurimin e zhvillimit të bizneseve ekzistuese dhe që bizneset e reja të zgjedhin Kosovën si vend të përshtatshëm për vendosje të biznesit.

I. Gjendja aktuale

Prej Buxhetit të Kosovës për 2010, €332,1 milion, ose rreth 35.33% janë ndarë për këtë sektor.

Të arriturat në Sektorin e Infrastrukturës dhe Zhvillimit ekonomik janë evidente si në;

- Infrastrukturën rrugore- janë shtruar mbi 400 km rrugë,
- Përmirësimi i furnizimit të konsumatorëve me energji elektrike,
- Përmirësimi i rrjetit dhe infrastrukturës së KOSTT-it, KEK-ut, Ngrohjes Qendrore dhe Ujit dhe Hedhurinave,
- Subvencionimi i bujqësisë,
- Përmirësimi i kushteve të operimit në Minierat e Kosovës etj.



Ministritë dhe Agjencionet që përbëjnë sektorin e zhvillimit ekonomik janë: Ministria e Transportit dhe Post-Telekomunikacionit; Ministria e Energjisë dhe Minierave; Njësia për Politika dhe Monitorimin e Ndërmarrjet Publike në Ministrinë e Financave; Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural; Ministria e Tregtisë dhe Industrisë; Agjencia Kosovare e Privatizimit; Komisioni i Pavarur për Miniera dhe Minerale; Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor; Autoriteti Rregullativ i Telekomunikacionit; Zyra Rregullative e Energjisë; Zyra Rregullative e Ujit dhe Hedhurinave; Autoriteti i Aviacionit Civil.

Zhvillimi ekonomik kërkon angazhimin dhe përkushtimin e të gjithëve në Qeveri në mënyrë që të reduktojë papunësinë ekzistuese dhe sigurimin e vendeve të punës për gjeneratat që vijnë

Kosova ka rritjen më të shpejtë të popullsisë në Evropë dhe se rreth 30,000 të rinj hyjnë në tregun e punës çdo vit.

II. Planet e ardhshme

Korniza Afatmesme e Shpenzimeve për 2011 – 2013 thekson rëndësinë e këtij sektori në mënyra të ndryshme. Ky KASH planifikon dedikimin e fondeve të mëdha për autostradën e re që do të lidhë Kosovën me portin detar në Shqipëri. Kjo autostradë jo vetëm që do të përmirësojë lëvizjen e njerëzve dhe produkteve brenda Kosovës mirëpo gjithashtu do të ofrojë një rrugë të hapur për produktet e bizneseve Kosovare. Ministria e Energjisë dhe Minerave do të vazhdojë me përpjekjet e saj për të përmirësuar performancën e KEK-ut dhe KOSTT-it për të përmirësuar mbështetjen e individëve dhe bizneseve në furnizimin me energji elektrike.

Përpjekjet për privatizim e Ndërmarrjeve Publike do të vazhdojnë gjatë periudhës 2011/2013.

*Përmbledhje e vlerësimeve të hershme

	2010 Rishikuar	2011	2012	2013
Total	332,174,543	389,688,758	417,174,050	400,877,554
Paga dhe Mëditje	6,764,050	6,805,774	6,805,774	6,805,774
Mallra dhe Shërbime	22,211,871	22,458,697	22,392,535	22,392,535
Subvencione /Transfere	62,811,805	59,957,684	40,003,816	40,003,816
Shpenzimet kapitale	240,386,817	300,466,603	347,971,925	331,675,429
Numri i stafit	1,416	1,416	1,416	1,416

* Agjensionet e pavaruara në tabelën përmbledhëse sektoriale janë të përfshira sipas rekomandimeve për financim

Përmbledhje e shpenzimeve kapitale

Vitet	Projektet 2010 Rishikuar	2011	2012	2013
MTPT	202,495,665	265,320,000	312,450,000	295,250,000
MTI	6,369,574	5,779,375	5,900,000	5,900,000
MMPH	9,410,816	5,901,406	6,080,000	6,000,000
MBPZHR	2,658,706	2,869,205	2,980,296	2,965,000
MEM	948,740	964,155	1,063,000	905,800
AKP	2,236,387	2,297,433	2,500,000	3,500,000
ART	875,000	875,000	500,000	500,000
ZRE	230,400	230,400	44,000	50,000
KPMM	325,000	325,000	550,000	700,000
AAC	0	0	0	0
ZRUH	0	0	0	0
NPMNP	14,836,529	15,904,629	15,904,629	15,904,629
Totali	240,386,817	300,466,603	347,971,925	331,675,429

Projektet kontingjente në burimet shtesë ne nivel sektori

	2011	2012	2013
Shpenzimet Operative	20,983,800	41,089,739	61,940,370
Shpenzimet Kapitale	169,449,916	343,831,788	195,046,400
Totali	190,433,716	384,921,527	256,986,770

Kërkesat shtesë kanë të bëjnë me projektet kapitale të:

- Infrastrukturës rrugore,
- Elektrifikimin e Parkut Industrial,
- Rehabilitimin e Sistemit të ujitjes,
- Projekteve me rëndësi të veçantë (Komplekseve Memoriale dhe Varrezave të Dëshmorëve), argjinaturat dhe rehabilitimin të lumenjve në Kosovë,
- Rehabilitimin e minierave në kompleksin Trepça,
- Projekteve të KOSTT-it, Ngrohjes Qendrore dhe Ujit dhe Hedhurinave

MINISTRIA E TRANSPORTIT DHE POSTË- TELEKOMUNIKACIONIT

I. Misioni

Misioni i MTPT është krijimi i një sistemi cilësor, funksional, të qëndrueshëm e të sigurt të transportit që ruan mjedisin jetësor që i shërben zhvillimit shoqëror e ekonomik dhe integritimit ndërkombëtar. Ky mision mbështet vizionin e qartë të Qeverisë në aspiratat për integrimet evropiane përmes zhvillimit dhe modernizimit të infrastrukturës së transportit. Prandaj, sektori i transportit është i radhitur ndër prioritet strategjike në programin e Qeverisë së Republikës së Kosovës.

II. Gjendja aktuale

Gjatë vitit të kaluar janë realizuar mbi 200 projekte kapitale të infrastrukturës rrugore, si dhe janë shtruar mbi 400 km rrugë. Me këto investime të bëra në ndërtimin, rehabilitimin dhe mirëmbajtjen e rrugëve është zhvilluar dhe përmirësuar dukshëm rrjeti rrugor. Nën sektorët që hyjnë në kuadër të këtij sektori janë: infrastruktura dhe transporti rrugor, transporti hekurudhor, transporti ajror dhe telekomunikacioni. Megjithatë, mbesin një varg sfidash me të cilat ballafaqohet ky sektor, ato janë:

- a) Gjendja aktuale e sistemit të rrugëve;
- b) Lidhja me rrjetin kryesor rrugor të rajonit;
- c) Mënyrat dhe format alternative të financimit përmes partneritetet publiko-private

Infrastruktura dhe transporti rrugor

MTPT-ja ka në përgjegjësinë e saj rreth 1950 km rrugë (650 km të rrugëve nacionale dhe rreth 1300 km të rrugëve regjionale). Komunitet kanë në përgjegjësinë e tyre rreth 6571 km të rrugëve lokale. Gjendja e rrugëve lokale ka qenë e keqe, si rezultat i një numri të madh të rrugëve të paasfaltuara. Detyrimisht, për shkak të mungesës së fondeve të komunave, MTPT-ja ka destinuar fonde të konsiderueshme për rregullimin e kësaj gjendjeje. Si rezultat i këtyre investimeve janë shtruar rreth 200 km rrugë lokale.

Pasi që shtimi i sigurisë në komunikacionin rrugor është njëra nga objektivat prioritarë strategjike, MTPT-ja ka ndërmarrë një varg veprimesh dhe masash për të realizuar këtë objektivë. Si rezultat i zbatimit të Ligjit mbi Sigurinë në Komunikacionin Rrugor, ndërtimit të shumë nënkalimeve dhe trotuareve, përmirësimit të sinjalizimit horizontal dhe vertikal, zbatimit të akteve ligjore dhe nën ligjore, numri i aksidenteve është zvogëluar krahasuar me vitet e kaluara.

Si pjesë e Evropës Juglindore dhe me aspirata për t'iu bashkuar Komunitetit Evropian, sistemi i rrugëve të Kosovës duhet të lidhet me rrjetin regional të rrugëve, si hap i parë drejt integritimit të gjithmbarshëm.

Transporti hekurudhor

Rrjeti i hekurudhave përbëhet nga rreth 334 km infrastrukturë hekurudhore. Aktualisht në shfrytëzim janë linjat Veri-Jug, Fushë Kosovë – Pejë, Klinë – Xërxë dhe Fushë Kosovë – Bardhosh. Të gjitha këto linja përbëjnë 280 km apo rreth 85% të rrjetit të përgjithshëm hekurudhor. Pjesa më e madhe e rrjetit hekurudhor është në gjendje të mirë. Megjithatë, ky sektor ka nevojë për investime të reja, posaçërisht në mirëmbajtjen dhe në modernizimin e rrjetit ekzistues.

Transporti i mallrave është rritur gjatë viteve të fundit. Vëllimi i tij pritet të rritet edhe më shumë. Ndërkaq, për sa i takon transportit të udhëtarëve nëpërmjet hekurudhave gjendja është më ndryshe, sepse nevojiten subvencione.

Transporti ajror

Kosova ka Aeroportin Ndërkombëtar të Prishtinës që operon me shërbime të kombinuara civile dhe ushtarake. Cilësia dhe sasia e shërbimeve në këtë aeroport është rritur ndjeshëm. Si pjesë e rrjetit themelor regjional dhe ndërkombëtar, mbetet si synim zgjerimi dhe ngritja e vazhdueshme e kapaciteteve të këtij aeroporti.

Telekomunikacioni

Përderisa telekomunikimi mund të mos jetë pjesë e transportit në kuptimin konvencional, ai mund të integrohet në kuptimin më të gjerë, si pjesë e infrastrukturës përcjellëse, që i shërben kohezionit ekonomik dhe social të shtetit tonë, si dhe përparimit të shoqërisë informative. Kështu, në mënyrë specifike:

- a) Telekomunikacioni përbën pjesën përbërëse të infrastrukturës nacionale, telekomunikacioni merret me bartjen e informacionit në distanca të shkurtra dhe të gjata, ngjashëm si transporti;
- b) Infrastruktura e telekomunikacionit përbën pjesën me interes në dobi të lidhjes me rajonin, me Evropën dhe me pjesën tjetër të botës;
- c) Mund të përfitohen sinergji nëpërmjet ndërtimit të njëkohësishëm të infrastrukturës së transportit dhe të telekomunikacionit

I. Objektivat strategjike

Objektivat strategjike të sektorit të transportit janë:

- i. Integrimi i infrastrukturës transportuese të Kosovës në rrjetin kryesor rajonal
- ii. Mirëmbajtja dhe përmirësimi i rrjetit aktual rrugor
- iii. Shtimi i sigurisë në rrugë
- iv. Zhvillimi i infrastrukturës hekurudhore dhe zhvillimi i transportit ajror

Këto objektiva strategjike realizohen nëpërmjet përmbushjes së objektivave specifike, ku secila objektivë ka planin e veprimeve dhe masave të cilat duhet ekzekutuar. Më poshtë, secila prej këtyre katër objektivave është e zërthyer në objektivat e veta specifike.

1. Integrimi i infrastrukturës transportuese të Kosovës në rrjetin

kryesor rajonal

- Fillimi i ndërtimit të autostradës Morinë – Merdar (R7) për t'u lidhur me Korridorin e X-të të Evropës Juglindore.
- Fillimi i ndërtimit të autostradës Prishtinë – Han i Elezit (R6) për t'u lidhur me Korridorin e VIII-të të Evropës Juglindore me mundësi të financimit nga burimet tjera alternative.
- Kompletimi i të gjitha punëve në projektet e sipërpërmendura në përputhje me standardet evropiane.

2. Mirëmbajtja dhe përmirësimi i rrjetit aktual rrugor

- Mirëmbajtja verore dhe dimërore e të gjitha rrugëve nacionale dhe regionale.
- Zgjerimi i rrugëve nacionale Prishtinë – Pejë (M9) dhe Prishtinë – Mitrovicë (M2).
- Rehabilitimi i rrugëve të tjera.
- Ndërtimi i rrugëve të reja..
- Kompletimi i të gjitha punëve rreth mirëmbajtjes, rehabilitimit dhe ndërtimit në përputhje me standardet evropiane.

3. Shtimi i sigurisë në rrugë

- Përmirësimi i sinjalizimit dhe ndriçimit në rrugët e Kosovës.
- Implementimi i Ligjit mbi Sigurinë në Komunikacionin Rrugor.
- Përmirësimi i sistemit për testim dhe aftësim të kandidatëve për patentë shofer.
- Përmirësimi i sistemit të kontrollit teknik të automjeteve.

4. Zhvillimi i infrastrukturës hekurudhore dhe zhvillimi i transportit ajror

- Funkcionalizimi i Autoritetit Rregullativ të Hekurudhave dhe i organeve të tjera rregullative.
- Ndarja e infrastrukturës nga operimet.
- Zhvillimi i operimeve dhe i shërbimeve.
- Shqyrtimi i mundësive të pjesëmarrjes së sektorit privat në transportimin hekurudhor.
- Zgjerimi i kapaciteteve të Aeroportit Ndërkombëtar të Prishtinës.

Tabela 1: Trendët historike të financimit

	2008	2009	2010 Rishikuar
Totali	126,849,977	136,839,592	214,888,775
Paga dhe Mëditje	769,596	868,624	953,589
Mallra dhe Shërbime	9,747,753	10,659,779	9,315,586
Subvencione dhe Transfere	2,048,820	1,832,714	2,123,935
Shpenzime Kapitale	114,283,808	123,478,475	202,495,665
Numri i Stafit	272	276	276

Tabela 2: Kufijtë e vlerësuar të shpenzimeve 2011-2013

	2010 Rishikuar	2011	2012	2013
Totali	214,888,775	278,785,161	325,955,403	308,755,403
Paga dhe Mëditje	953,589	1,001,621	1,001,621	1,001,621
Mallra dhe Shërbime	9,315,586	10,359,726	10,379,847	10,379,847
Subvencione dhe Transfere	2,123,935	2,103,814	2,123,935	2,123,935
Shpenzime Kapitale	202,495,665	265,320,000	312,450,000	295,250,000
Numri i Stafit	276	276	276	276

Ashtu edhe siç shihet në tabelën 2, trendi i shpenzimeve operative (2011-2013) ka një rritje, kjo ka të bëjë kryesisht me programin e Mirëmbajtjes së Rrugëve. Rritja për këtë program vjen si rezultat i investimeve të viteve të kaluara në sektorin e infrastrukturës rrugore.

Sa i përket shpenzimeve kapitale ndër aktivitet më madhore për tri vitet e ardhshme është projekti- Ndërtimi i Autostradës Morinë-Merdare .

Gjithashtu në këtë dokument (KASH 2011-2013) janë përfshirë edhe aktivitet tjera të cilat ndikojnë drejtpërsëdrejti në përmirësimin e infrastrukturës rrugore e ato janë:

-Ndërtimi dhe mirëmbajtja e urave,
-Rehabilitimi dhe Zgjerimi i Rrugëve Regjionale, këtu përfshihen projektet madhore siç janë:

- Rehabilitimi dhe Zgjerimi i Rrugës Prishtinë-Pejë,
- Rehabilitimi dhe Zgjerimi i Rrugës Prishtinë-Mitrovicë,
- Sinjalizimi i rrugëve magjistrale dhe regjionale,
- Ndërtimi i rrugëve të reja etj.

Tabela 3: Kufijtë e vlerësuar të shpenzimeve kapitale 2011-2013

Emri i programit	Projektet 2010 Rishikuar	Vlerësimet 2011	Vlerësimet 2012	Vlerësimet 2013
Totali	202,495,665	265,320,000	312,450,000	295,250,000
Infrastruktura Rrugore		650,000	650,000	650,000
Mirëmbajtja dhe Ndërtimi i Urave	2,661,998	2,583,000	2,000,000	2,000,000
Sinjalizimi Horizontal dhe Vertikal	1,591,796	1,500,000	2,000,000	2,000,000
Rehabilitimi i Rrugëve	47,530,122	24,211,093	27,000,000	24,500,000
Autostrada Morinë-Merdare	123,701,126	225,000,000	276,800,000	258,100,000
Ndërtimet e reja te Rrugëve	12,892,501	11,375,907	4,000,000	8,000,000
Programi i Bashkëfinancimit me Kuvende Komunale	13,872,994	-	-	-
Administrata Qendrore	245,128			

Tabela 4: Nevojat shtesë për financim mbi kufirin buxhetor 2011-2013

	2011	2012	2013
Totali	94,381,018	251,751,367	127,621,187
Shpenzimet Operative	3,882,720	4,855,367	5,270,187
Shpenzimet Kapitale	90,498,298	246,896,000	122,351,000

Kërkesat për financim shtesë për shpenzime operative kanë të bëjnë me:

- Mirëmbajtjen e rrugëve ekzistuese regjionale dhe magjistrale,
- Subvencionimi i transportit humanitar hekurudhor dhe rrugor te udhëtareve.

Ndërsa sa i përket financimit shtesë për shpenzime kapitale kanë të bëjnë me:

- Projektet e Infrastrukturës Rrugore
- Ndërtimin e linjës hekurudhore Prishtinë-Aeroport
- Elektrifikimi i vijës hekurudhore Leshak-Hani i Elezit
- Formimi i Njësitit të Helikopterëve
- Pajisje softuerike etj.

MINISTRIA E TREGTISË DHE INDUSTRIË

I. Misioni

Misioni i Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë është krijimi i kushteve sistemore për tregti, industri, krijimi i politikave të punës dhe zbatimi i legjislacionit për përkrahjen e konkurrencës korrekte, hartimi i programeve dhe legjislacionit për përkrahjen ndërmarrjeve industriale, tregtare, turistike dhe politikave zhvillimore të sektorit privat, mbështetjen e investimeve në Kosovë duke siguruar informacione dhe ndihmë në sigurimin e dokumenteve (leje, autorizime) të nevojshme për investitorët vendas dhe të huaj si dhe publikimin e të dhënave të investimeve të huaja në Kosovë, shenjë e rekomandimeve për çështje të privatizimit, administrimin e regjistrimit të regjistrimit të bizneseve.

II. Gjendja Aktuale

Përkundër ekzistimit të një legjislacioni relativisht stimulues dhe angazhimeve të institucioneve të Kosovës për të bërë më shumë në ndryshimin e kësaj gjendje të rëndë, Kosova ende mbetet larg rritjes ekonomike të dëshirueshme dhe përparësive që sjellin investimet e huaja.

Në ekonominë e tregut, sektori privat është një sektor dinamik në saje të energjisë ndërmarrëse dhe interesit të investitorëve, të cilat ndihmojnë rritjen e punësimit dhe përmirësojnë produktivitetin.

Sot sektori privat në Kosovë, sikurse edhe në shumë vende në tranzicion madje edhe të atyre të zhvilluara është burimi kryesor i gjenerimit të vendeve të reja të punës dhe rritjes së të ardhurave kombëtare. Sektori privat është afirmuar si forcë e rritjes dhe transformimit në ekonominë e tregut, sikurse edhe vendet e regjionit.

Ekonomia e Kosovës po kalon nëpër fazën e tranzicionit shumëdimensional shoqëror, ekonomik, pronësor etj, ku zhvillimi i sektorit privat luan një rol vendimtarë në përballimin e këtyre proceseve të ndërlikuara tranzicionale si dhe në rimëkëmbjen dhe zhvillimin ekonomikë Kosova tani është në fazën e fundit të tranzicionit, ku zhvillimi i sektorit privat luan dhe do të luajnë një rol vendimtar në rimëkëmbjen dhe zhvillimin e ekonomisë.

III. Objektivat Strategjike

Objektivat strategjike të MTI-së orientohen në zvogëlimi e varfërisë përmes zhvillimit të përgjithshëm dhe të qëndrueshëm ekonomik të vendit dhe atë përmes:

- i. Promovimi i kulturës së ndërmarrësisë,
- ii. Ndërtimi i kapaciteteve institucionale,
- iii. Krijimin dhe përmirësimin e infrastrukturës ligjore dhe fizike për mbështetjen e sektorit privat,
- iv. Ndërtimi i infrastrukturës së cilësisë
- v. Promovimin e ofertës turistike të Kosovës,

a) Promovimi i kulturës së ndërmarrësisë – përbën një nga sfidat më të mëdha të institucioneve vendore. Përshtatja e plotë e sjelljeve dhe mentalitetit të ndërmarrësve tanë me ligjet bazë që përcaktojnë ekonominë e lirë të orientuar kah tregu ku oferta dhe kërkesa

është bazament mbi të cilën do të vihen themelet e shëndosha për zhvillimin më të përshpejtuar ekonomikë, hapja e vendeve të reja të punës dhe reduktimin e varfërisë. Ministria e Tregtisë dhe Industrisë në kuadër të aktiviteteve të saja është e përkushtuar të ju ndihmoj Bizneseve përmes këtyre aktiviteteve si: Skema Vaucher e Trajnimeve dhe Këshillimeve, Programi “Intership Biznes “- komponentë për nxënës dhe studentë, Ndërkombëtarizimi i NVM-ve Kosovare përmes Aktit Evropian të Bizneseve të Vogla dhe Qendrës së Evropës Juglindore për Ndërmarrësi , Java e NVM-ve , Gratë në Biznes etj.

b) Ngritja e kapaciteteve të vlerësimit të konformitetit të produkteve ndërtimore dhe industriale, zhvillimi i kualitetit të ndërtimtarisë dhe cilësisë së produkteve ndërtimore përmes Institucionalizimit të një strukture për kryerjen e veprimtarive kërkimore, shkencore, aplikative, zhvillimore, studimore dhe projektuese në fushën e ndërtimit. Studimin dhe realizimin e objektivave në fushën e rregullave teknike të produkteve ndërtimore si dhe kryerjen e veprimtarisë shkencore e teknologjike për ekspertiza, kurse kualifikimi, vlerësime konformiteti dhe kontrole për produktet e ndërtimit që lidhen me sigurinë e jetës.

c) Ndërtimin e Infrastrukturës Fizike për përkrahje të Ndërmarrjeve të Vogla dhe të Mesme në Kosovë, respektivisht zhvillimin e sektorit privat përmes zhvillimit të hapësirave të punës si Zonat Industriale, Parqet e Biznesit dhe Inkubatorët e Biznesit. Përmes këtij aktiviteti synohet rritja e konkureshmërisë së prodhuesve vendorë, tërheqja e investitorëve të huaj nxitja e ndërmarrësisë dhe krijimi direkt i vendeve të reja të punës.

e) Ngritja e infrastrukturës së cilësisë përmes ngritjes së laboratorëve dhe sistemit të akreditimit dhe të certifikimit. Gjithashtu jo më pak i rëndësishëm është edhe mbrojtja e jetës dhe shëndetit të njerëzve dhe kafshëve, mbrojtja e mjedisit, pasurisë dhe mbrojtjes së konsumatorit në përgjithësi.

f) Promovimin e ofertës turistike të Kosovës; përmes këtij aktiviteti do të promovohet oferta turistike e Kosovës. Me këtë synohet të ngritën kapacitetet vendore që klientela turistike vendore dhe ndërkombëtare të kenë mundësi zgjedhje të resurseve turistike që ofron Kosova.

Aktiviteti synon një informim më të gjerë rreth produkteve turistike dhe shërbimeve turistike ekzistuese Kosovare, rritjen e vizitorëve vendor dhe të huaj, rritjen e të hyrave nga qarkullimi turistik dhe hapjen e vendeve të reja të punës.

Tabela 1: Trendët historike të financimit

	2008	2009	2010 Rishikuar
Totali	5,745,138	9,220,857	9,771,460
Paga dhe Mëditje	553490	652261	771,129
Mallra dhe Shërbime	1657368	1268180	2,230,757
Subvencione dhe Transfere			400,000
Shpenzime Kapitale	3,534,280	7,300,416	6,369,574
Numri i Stafit	158	173	192

Tabela 2: Kufijtë e vlerësuar të shpenzimeve 2011-2013

	2010 Rishikuar	2011	2012	2013
Totali	9,771,460	7,798,995	7,925,514	7,925,514
Paga dhe Mëditje	771,129	783,297	783,297	783,297
Mallra dhe Shërbime	2,230,757	1,236,323	1,242,217	1,242,217
Subvencione dhe Transfere	400,000	0	0	0
Shpenzime Kapitale	6,369,574	5,779,375	5,900,000	5,900,000
Numri i Stafit	192	192	192	192

Kufijtë e vlerësuar për MTI-në në kuadër të shpenzimeve operative janë të përfshirë përveç mbulimit të aktivitete të zakonshme edhe disa projekte të cilat kanë ndikim të drejtpërdrejtë në zhvillimin e sektorit privat , promovim të investimeve të jashtme .

Projektet e tilla janë

- Skema Vaucher e Trajnimeve dhe Këshillimeve,
- Ndërkombëtarizimi i Ndërmarrjeve të Vogla dhe të Mesme Kosovare përmes Aktit Evropian të Bizneseve të Vogla dhe -Qendrës së Evropës Juglindore për Ndërmarrësi
- Java e Ndërmarrjeve të Vogla dhe të Mesme ,
- Gratë në Biznes ,
- Programi i mbrojtjes së konsumatorit
- Organizimi i Panairëve të ndryshme që kanë të bëjnë me promovimin e Turizmit, Industrisë, Tregtisë, etj.

Sa i përket kufijve të vlerësuar për shpenzime kapitale në të janë përfshirë kryesisht projektet që kanë të bëjnë me krijimin e hapësirave të punës, dhe si të tilla kanë ndikim të madh në zhvillimin e sektorit privat, rritjes së konkureshmërisë së prodhuesve vendor, krijimin e vendeve të reja të punës mirëpo gjithashtu janë atraktive edhe për promovimin e investimeve të jashtme .Projektet e tilla janë:

Zonat Industriale, Parqet e Biznesit ,Qendra e Panairëve, Inkubatorët e Biznesit etj.

Tabela 3: Kufijtë e vlerësuar të shpenzimeve kapitale 2011-2013

Emri i programit	Projektet 2010 Rishikuar	Vlerësimet 2011	Vlerësimet 2012	Vlerësimet 2013
Totali	6,369,574	5,779,375	5,900,000	5,900,000
Departamenti i Industrisë	1,129,585	1,000,000	330,000	120,000
Departamenti i Ndërtimtarisë	913,017	1,000,000	50,000	30,000
Departamenti i Tregtisë	1,403,489	2,000,000	700,000	200,000
Departamenti i Metrologjisë	456,509	400,000	300,000	300,000
Agjencioni për Mbështetjen e NVM-ve	2,276,532	1,079,375	4,330,000	5,050,000
Agjencioni për Rexhistrimin e Bizneseve	91,302	300,000	100,000	100,000
Departamenti i Turizmit	-	0	90,000	100,000
Agjencioni për Promovimin e Investimeve	99140			

Tabela 4: Nevojat shtesë për financim mbi kufirin buxhetor 2011-2013

	2011	2012	2013
Totali	5,489,369	9,532,906	6,002,906
Shpenzimet Operative	1,749,369	1,672,906	1,572,906
Shpenzimet Kapitale	3,740,000	7,860,000	4,430,000

Kërkesa shtesë për financim për KASH-in 2010-2012, kanë të bëjnë:

- Shpenzimet operative, për ofrimin e trajnimeve dhe këshillimeve për bizneset, si dhe Transfere të njohurive tekniko-teknologjike dhe forcimin e konkurrencës,
- Shpenzimet kapitale, për përfundimi i punimeve të projekteve kapitale siç janë Zonat Ekonomike, Elektrifikimi i Parkut Industrial, etj.

MINISTRIA E BUJQËSISË, PYLLTARISË DHE ZHVILLIMIT RURAL

I. Misioni

Misioni i Ministrisë së Bujqësisë, Pylltarisë dhe zhvillimit Rural është krijimi dhe implementimi i politikave bujqësore të Republikës së Kosovës. Në këtë drejtim MBPZHR angazhohet në zhvillimin e ekuilibruar të ekonomisë, ambientit, shoqërisë dhe mirëqenies kulturore të zonave rurale dhe Kosovës si tërësi. Zhvillimi i qëndrueshëm rural do të jetë në fokus të veçantë për përmirësimin e kualitetit të jetesës përmes promovimit të bujqësisë dhe aktiviteteve tjera ekonomike rurale, posaçërisht në shumëllojshmërinë e aktiviteteve rurale.

II. Gjendja aktuale

Nga sipërfaqja totale e Kosovës prej 1.1 milion ha, 53% janë tokë bujqësore, ndërsa 41% janë tokë pyjore. Bujqësia është sektor i rëndësishëm ekonomik i cili siguron pjesën më të madhe të punësimit në Kosovën e pasluftës. Bujqësia e Kosovës karakterizohet me ferma të vogla, prodhimi të ulët dhe mungesën e shërbimeve këshillimore, por edhe përkundër kësaj ajo kontribuon me përafërsisht 25 % në BPV (bruto prodhimi vendor) të Kosovës, punëson në mes të 25% deri 30% të punësimit të përgjithshëm, kryesisht në sektorin joformal dhe përbën rreth 16% të vlerës së eksportit total.

Rreth 60% e popullsisë së Kosovës jeton në zonat rurale. Sektori i bujqësisë si i tillë do të luaj një rol të rëndësishëm për ofrimin e mundësive për punësim dhe për krijimin e të ardhura për njerëzit që jetojnë në zonat rurale.

Bujqësia dhe zonat rurale të Kosovës për një kohë të gjatë po ballafaqohen me sfida të mëdha të cilat kanë krijuar pasiguri për sa i përket zhvillimit të qëndrueshëm ekonomik, gjenerimit të vendeve të reja të punës, dhe krijimit të mirëqenies për banorët e tyre përkundër asaj se këto zona, posedojnë kushte të favorshme agro mjedisore dhe resurse të rëndësishme të cilat janë kusht për zhvillimin rural dhe të bujqësisë.

MBPZHR gjatë këtyre dy viteve, ka dhënë kontribut të rëndësishëm për krijimin e një mjedisi të përshtatshëm për zhvillimin rural dhe bujqësor duke mbështetur drejtpërdrejtë zhvillimin ekonomik të lokaliteteve.

Ndër prioritetet në të cilat është përqendruar puna e Ministrisë kanë qenë:

Ristrukturimi i sektorit të bujqësisë duke përfshirë konsolidimin e tokës dhe kadastrën e vreshtave; shpërndarja e granteve dhe subvencioneve për fermat bujqësore; rehabilitim i sistemeve ekzistuese të ujitjes dhe ndërtimi i kapaciteteve të reja; mbështetja për zbatimin e strategjive lokale të zhvillimit, etj.

Për zbatimin e këtyre prioritetëve Qeveria e Republikës së Kosovës për vitin 2009 e ka dyfishuar buxhetin e MBPZHR. Në këtë drejtim, vetëm për subvencione dhe grante janë ndarë 5.2 mil. € përdërisa në vitin paraprak ato ishin vetëm simbolike (550 mijë €).

Rritja e këtij fondi i ka mundësuar MBPZHR-së që ti hartoj 10 (dhjetë) skema mbështetëse për fermerët tanë dhe për projektet me të cilat synohet rritja e të ardhurave të fermerëve, përmirësimi i aftësive konkurruese të ndërmarrjeve bujqësore dhe agro-përpunuese, zëvendësimi i importit me produkte vendore etj.

Ministria e Bujqësisë Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural për rritjen e prodhimtarisë bujqësore dhe përmirësimin e aftësisë konkurruese, në vitin 2009 ka përfshirë rreth 15 mijë fermer në strukturën e mbështetjes përmes grave dhe subvencioneve për mbështetjen e projekteve të ndryshme në ngritjen e vreshtave të reja, ngritjen e serrave për prodhimin e perimeve, mbështetjen e prodhuesve të qumështit, skemat e subvencionimit për kafshët e imta, për prodhuesit e grurit, skemat e grave për ndërmarrjet agro-përpunuese, për mbështetjen e Grupeve Lokale të Veprimtimit etj.

Kjo mbështetje ka pasur ndikim shumë pozitiv në orientimin e fermerëve në drejtim të rritjes së kualitetit të prodhimit, zbatimin e praktikave të prodhimit sipas standardeve të BE dhe rritjen e shkathësisë për menaxhim të qëndrueshëm të fermës.

Këto investime kanë për qëllim që të krijojnë një mjedis të favorshëm për zhvillimin e sektorit agro-rural të Kosovës dhe për përgatitjen e saj për kandidim në BE.

Duke parë rezultatet e deritashme në këtë sektor dhe nevojën për zhvillim edhe të mëtutjeshëm të bujqësisë, kërkohet që edhe në vitet e ardhshme të ndihmohet sektori i bujqësisë si nga Buxheti i Kosovës ashtu edhe nga donatorët e mundshëm.

III. Objektivat Strategjike

Objektivat kryesore në planin afatmesëm janë:

- i. Shfrytëzimi i qëndrueshëm dhe mbrojtja e tokës bujqësore, që do të arrihet përmes mbrojtjes së tokës bujqësore nga ndërtimet e pa planifikuara dhe ristrukturimit të fermës;
- ii. Rritja e produktivitetit në fermë dhe aftësisë konkurruese që do të arrihet përmes: ngritjes së të ardhurave në ferma dhe përmirësimin e jetës dhe i punës në zonat rurale, përmirësimin e aftësive konkurruese, zvogëlimi i importit dhe rritja e eksportit të produkteve bujqësore si dhe krijimin e mundësive të punësimit në zonat rurale, veçanërisht nëpërmes të diversifikimit të aktiviteteve rurale; dhe rreshtimi i bujqësisë së Kosovës me atë të BE-së ;
- iii. Përmirësimi i strukturës pyjore që do të arrihet përmes: pyllëzimit, ripyllëzimit të sipërfaqeve pyjore, shtimit të sipërfaqeve pyjore, rregullimi i sipërfaqeve të degraduara në pyje prodhuese dhe hartimin e planeve menaxhuese.

Tabela 1: Trendët historike të financimit

	2008	2009	2010 Rishikuar
Totali	8,684,931	12,161,791	10,787,255
Paga dhe Mëditje	1,611,770	2,002,996	1,497,015
Mallra dhe Shërbime	2,545,920	1,991,202	1,931,534
Subvencione dhe Transfere	300,000	1,167,593	4,700,000
Shpenzimet Kapitale	4,227,241	7,000,000	2,658,706
Numri i stafit	598	734	315

Tabela 2: Vlerësimet për KASH-in 2011-2013

	2010 Rishikuar	2011	2012	2013
Totali	10,787,255	10,723,742	10,860,844	10,845,548
Paga dhe Mëditje	1,497,015	1,307,371	1,307,371	1,307,371
Mallra dhe Shërbime	1,931,534	1,847,166	1,847,166	1,847,166
Subvencione dhe Transfere	4,700,000	4,700,000	4,726,011	4,726,011
Shpenzimet Kapitale	2,658,706	2,869,205	2,980,296	2,965,000
Numri i stafit	315	315	315	315

Këta kufij janë përcaktuar duke marrë për bazë koston e politikave ekzistuese dhe vlerësimin fillestar të kapacitetit për financim të iniciativave të reja në sferën e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural (p.sh. themelimi i Njesisë së Pagesave).

Ligji i Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural obligon Ministrinë e Bujqësisë në krijimin e Njesisë së Pagesave, e cila do të ndikon në rritje të numrit të punëtorëve dhe në rritjen e shpenzimeve operative. Kostoja e saktë e Njesisë, kapaciteti për financimin dhe burimet e tjera të mundshme do të përcaktohen në procesin buxhetor të ardhshëm.

Tabela 3: Kufijtë e vlerësuar të shpenzimeve kapitale 2011-2013

Emri i programit	Projektet 2010 Rishikuar	Vlerësimet 2011	Vlerësimet 2012	Vlerësimet 2013
Totali	2,658,706	2,869,205	2,980,296	2,965,000
Departamenti i Prodhimtarisë dhe Mbrojtjes Bimore	2,077,707	2,200,000	2,200,000	2,200,000
Autoriteti Pyjor i Kosovës	444,628	532,834	565,296	550,000
Instituti Bujqësor i Kosovës	136,371	136,371	215,000	215,000

Tabela 4: Nevojat shtesë për financim mbi kufirin buxhetor 2011-2013

	2011	2012	2013
Totali	11,891,079	11,980,019	10,856,096
Shpenzimet Operative	5,737,075	5,158,015	5,018,796
Shpenzimet Kapitale	6,154,004	6,822,004	5,837,300

Kërkesa shtesë për financim për KASH-in 2010-2012, kanë të bëjnë :

- Rritja e subvencionimit të fermerëve, kurse tek
- Investimet kapitale janë kërkesat për mjete shtesë për projektin e sistemit të ujitjes dhe disa projekt të reja të cilat janë të identifikuar edhe në sistemin e PIP-it.

MINISTRIA E ENERGJISË DHE E MINIERAVE

I. Misioni

Misioni i Ministrisë së Energjisë dhe Minierave (MEM-it), është t'i kontribuojë zhvillimit të standardeve të jetës dhe mirëqenies kombëtare duke promovuar zhvillimin e qëndrueshëm të industrive energjetike, të mihjeve dhe të mineraleve në Kosovë, duke siguruar eksploatim efikas dhe efektiv të resurseve energjetike dhe minerare.

II. Gjendja aktuale

MEM ka adoptuar një vizion strategjik afatgjatë për sektorët e energjisë dhe minierave në Kosovë. MEM është duke zbatuar reforma të orientuara drejt tregut dhe koordinon ristrukturimin e sektorëve të energjisë dhe minierave, në mënyrë që t'i përgatisë ato për tërheqjen e investimeve shumë të nevojshme private përmes një procesi të hapur, transparent dhe konkurrues për arritjen e partneriteteve publike-private. Zhvillimi i tregut konkurrues i energjisë, në pajtim me acquis të BE-së dhe Traktatin për Komunitetin e Energjisë për Evropën Juglindore, përmes të cilit do të mund të ofrohen shërbime energjetike të cilësisë së lartë, me teknologji që nuk dëmtojnë mjedisin dhe me kosto të ulët, paraqet të vetmen rrugë përpara drejt zhvillimit të qëndrueshëm për vendin tonë.

III. Objektivat Strategjike

Sektori i energjisë

- i. Të zhvillohet dhe implementohet politikë, strategji dhe kornizë ligjore për reformimin dhe ristrukturimin e sektorit të energjisë në pajtueshmëri me acquis të BE-së;
- ii. Të promovohet dhe përkrahet zhvillimi i një tregu konkurrues energjetik, i cili do të integrohet në tregun e energjisë të BE-së në të ardhmen;
- iii. Të promovohet restaurimi i qëndrueshmërisë financiare të ndërmarrjeve energjetike;
- iv. Të arrihet siguria në furnizim me energji për konsumatorët me kosto sa më të ulët dhe në mënyrë sa më të padëmshme për mjedisin;

Sektori minerar

- i. Të inkurajohet hulumtimi dhe zhvillimi i rezervave të reja të linjtit dhe mineraleve të tjera;
- ii. Të zhvillohen dhe implementohen politika, strategjia dhe korniza ligjore për sektorin minerar;
- iii. Të promovohen investimet private në sektorin e minierave në formë të partneriteteve publike-private.

Tabela 1: Trendët historike të financimit

	2008	2009	2010 Rishikuar
Totali	2,495,428	2,268,852	2,515,791
Paga dhe Mëditje	430,228	471,152	518,576
Mallra dhe Shërbime	989,200	846,700	997,475
Subvencione dhe Transfere	51,000	51,000	51,000
Shpenzime Kapitale	1,025,000	900,000	948,740
Numri i Stafit	123	123	126

Tabela 2: Vlerësimet për KASH-in 2011-2013

	2010 Rishikuar	2011	2012	2013
Totali	2,515,791	2,628,810	2,477,698	2,320,498
Paga dhe Mëditje	518,576	537,116	537,116	537,116
Mallra dhe Shërbime	997,475	1,076,539	826,582	826,582
Subvencione dhe Transfere	51,000	51,000	51,000	51,000
Shpenzime Kapitale	948,740	964,155	1,063,000	905,800
Numri i Stafit	126	126	126	126

Në tabelën 2 shihet një rritje e vogël e në kategorinë e investimeve kapitale, të cilat kryesisht janë projekte në vazhdimsi nga vitet paraprake. Kurse shpenzimet operative përafërsisht janë të pa ndryshuara.

Tabela 3: Kufijtë e vlerësuar të shpenzimeve kapitale 2011-2013

Emri i programit	Projektet 2010 Rishikuar	Vlerësimet 2011	Vlerësimet 2012	Vlerësimet 2013
Totali	948,740	964,155	1,063,000	905,800
Departamenti i Energjisë	508,140	508,140	632,850	485,400
Departamenti i Minierave	380,600	456,015	430,150	420,400
Administrata Qendrore	60,000			

Tabela 4: Nevojat shtesë për financim mbi kufirin buxhetor 2011-2013

	2011	2012	2013
Totali	8,410	112,022	111,338
Shpenzimet Operative	8,410	112,022	111,338
Shpenzimet Kapitale	-	-	-

Në kërkesat shtesë, janë të përfshira shpenzimet të cilat do të krijohen me formimin e Agjencionit për eficientë e energjisë, i cili nuk do të ndikoj në rritje të numrit të punëtorëve por vetëm në shpenzime operative.

MINISTRIA E MJEDISIT DHE PLANIFIKIMIT HAPËSINOR

I. Misioni

MMPH, ka për mision mbrojtjen e mjedisit, ujërave, rregullimin dhe zhvillimin e planifikimit hapësinor, banimin e ndërtimin. Realizimi i misionit do të arrihet përmes hartimit dhe zbatimit të politikave, strategjive, programeve dhe projekteve, si dhe realizimit të aktiviteteve tjera në funksion të zhvillimit të qëndrueshëm.

Mbështetja e misionit në zhvillimin e qëndrueshëm ka për qëllim përmirësimin e cilësisë së jetës së qytetarëve të Kosovës, dhe brezave që do të vijnë. Realizimi i kësaj politike zhvillimore do të bëhet përmes integritit të strategjisë mjedisore me strategjitë sektoriale dhe përmes monitorimit, informimit dhe raportimit mjedisor. E gjithë kjo do të mundësoi Administrimin e integruar dhe të qëndrueshëm të mjedisit; planifikimin hapësinor, si mekanizëm për koordinimin dhe harmonizimin e aktiviteteve të sektorëve të ndryshëm në rrafshin hapësinor. Krijimin e kushteve dhe mekanizmave që mundësojnë banim të përshtatshëm dhe të qëndrueshëm për të gjithë qytetarët.

II. Gjendja aktuale

Kualiteti i mjedisit në Kosovë është larg standardeve mjedisore të Bashkimit Evropian, përkundër që janë bërë disa investime fillestare në pajisjet për monitorimin e cilësisë së ajrit, impianteve për sterilizim të mbeturinave infektive, rehabilitimin e deponimeve dhe rregullimin e disa shtretërve të lumenjve.

Ekzistojnë probleme serioze në lidhje me cilësinë e ujërave, menaxhimin të mbeturinave, ndotjes së ajrit, ndotjes së tokës dhe humbjes së llojlojshmërisë biologjike. Përveç këtyre, trajtimi dhe deponimi i mbeturinave është çështje shumë e rëndësishme. Ndotja e ajrit është një çështje tjetër e rëndësishme e cila është e pranishme sidomos në qytetet e mëdha dhe në zonat industriale. Probleme tjera të mjedisit shkaktohen nga zhvillimet e paplanifikuara, mungesa e planit hapësinor duke përfshirë edhe planin urban, menaxhimin i dobët i mbeturinave industriale dhe shfrytëzimi jo i qëndrueshëm i resurseve natyrore.

Sfidë e madhe për Kosovën do të jetë përmirësimi i mjedisit, i cili jo vetëm që është i domosdoshëm për përmirësimin e shëndetit të qytetarëve, por edhe për integrimin dhe harmonizimin e standardeve kombëtare mjedisore me standardet e Bashkimit Evropian.

III. Objektivat Strategjike

Parandalimi, zvogëlimi i ndotjes së mjedisit dhe qasja integruese në kontrollin e ndotjes,

i) Shfrytëzimi i qëndrueshëm i pasurive natyrore dhe mbrojtja e llojlojshmërisë biologjike dhe trashëgimisë natyrore, Fuqizimi i planifikimit hapësinor në Kosovë,

ii) Parandalimi, zvogëlimi i ndotjes së mjedisit dhe qasja integruese në kontrollin e ndotjes do të arrihet përmes ndërtimit të sistemit të integruar të monitorimit të cilësisë së ajrit,

ndërtimi i impianteve për sterilizimin e mbeturinave infektive, ndërtimi i objekteve për ruajtjen e mbeturinave të rrezikshme, ndërtimi i impianteve për imobilizimin edhe trajtimin e materieve të rrezikshme, përmirësimi dhe zgjerimi i infrastrukturës për mbledhje dhe grumbullimin e mbeturinave,

ii) Shfrytëzimi i qëndrueshëm i pasurive natyrore dhe mbrojtja e llojlojshmërisë biologjike dhe trashëgimisë natyrore, do të arrihet përmes pastrimit të shtratit të lumenjve, rehabilitimin dhe ndërtimet e mureve mbrojtëse të lumenjve , inventarizimi i florës dhe faunës etj,

iii) Fuqizimi i planifikimit hapësinor në Kosovë, do të arrihet përmes rregullimit të vendbanimeve joformale (një pilot projekt), hartimi i rregullave teknike ndërtimore sipas standardeve të BE në fushën e ndërtimit dhe planifikimit, organizimi i provimeve profesionale, licencimi, dhënia e autorizimeve për revidim dhe nostrifikim në fushën e banimit dhe të planifikimit;

Tabela 1: Trendët historike të financimit

	2008	2009	2010 Rishikuar
Total	10,052,902	12,253,699	11,775,652
Paga dhe Mëditje	688,058	761,744	1,033,562
Mallra dhe Shërbime	1,707,684	1,291,955	1,311,274
Subvencione dhe Transfere	0	0	20,000
Shpenzimet Kapitale	7,657,160	10,200,000	9,410,816
Numri i Stafit	239	239	288

Tabela 2: Kufijtë e vlerësuar të shpenzimeve 2011-2013

	2010 Rishikuar	2011	2012	2013
Total	11,775,652	8,401,862	8,586,861	8,506,861
Paga dhe Mëditje	1,033,562	1,136,508	1,136,508	1,136,508
Mallra dhe Shërbime	1,311,274	1,363,948	1,370,353	1,370,353
Subvencione dhe Transfere	20,000			
Shpenzimet Kapitale	9,410,816	5,901,406	6,080,000	6,000,000
Numri i Stafit	288	288	288	288

Shpenzimet kapitale; Ndërtimi i objektit për ruajtjen e përkohshme të mbeturinave të rrezikshme, Krijimi i rrjetit për monitorimin e cilësisë ajrit në Kosovë, Ndërtimi i impianteve për sterilizimin e mbeturinave infektive, Memoriali "Adem Jashari " Prekaz, Kompleksi i Varrezave-Reçak etj.

Tabela 3: Kufijtë e vlerësuar të shpenzimeve kapitale 2011-2013

Emri i programit	Projektet 2010 Rishikuar	Vlerësimet 2011	Vlerësimet 2012	Vlerësimet 2013
Totali	6,845,634	5,901,406	6,080,000	6,000,000
Mjedisi	2,367,700	2,294,406	2,478,000	2,478,000
Planifikimi Hapësinor	2,030,023	2,050,000	2,050,000	2,050,000
Burimet Ujore	2,277,587	1,300,000	1,300,000	1,300,000
Fshati Hade	170,324	172,000	172,000	172,000
Agjencioni Kadastral		85,000	80,000	-

Tabela 4: Nevojat shtesë për financim mbi kufirin buxhetor 2011-2013

	2011	2012	2013
Totali	10,904,644	9,760,000	10,630,000
Shpenzimet Operative	0	0	0
Shpenzimet Kapitale	10,904,644	9,760,000	10,630,000

Kërkesa shtesë për financim për KASH-in 2011-2013, kanë të bëjnë me:

- Me rritje të numrit të punëtorëve për 8 për shkak të ligjit për mbrojtje nga rrezatimi jonizues dhe jo-jonizues dhe sigurisë nukleare,
- Përmirësimi dhe zgjerimi i infrastrukturës për mbledhjen dhe grumbullimin e mbeturinave,
- Ndërtimi i deponive regjionale për mbeturinat komunale në Mitrovicë dhe Pejë, si dhe projekteve me rëndësi të veçantë.

AUTORITETI I AVIACIONIT CIVIL

I. Misioni

Të rregullojë sigurinë e aviacionit civil në Republikën e Kosovës në përputhjet me Ligjin për Aviacionin Civil, Standardet e Organizatës Ndërkombëtare të Aviacionit Civil dhe Marrëveshjen mbi Themelimin e Hapësirës së Përbashkët Evropiane të Aviacionit (“Marrëveshja HPEA”).

II. Gjendja aktuale

AAC-ja është funksionalizuar më 1 janar 2009. AAC-ja ka 21 punëtorë dhe planifikon punësimin e 4 punëtorëve të rinj, në përputhje me numrin e miratuar të punëtorëve.

III. Objektivat Strategjike

- i. Zbatimi i legjislacionit mbi aviacionit civil dhe zbatimi i politikave të miratuara nga Ministria ose Qeveria në fushën e aviacionit civil;
- ii. Nxjerrja e rregulloreve implementuese dhe urdhrave të navigacionit ajror, në përputhje me Ligjin për Aviacionin Civil dhe Marrëveshjen HPEA, me qëllim të zbatimit të politikave të aviacionit civil të Ministrisë dhe legjislacionit përkatës nga fusha e aviacionit civil;
- iii. Certifikimi i Operatorëve Ajrorë Kosovarë, krijimi i regjistrit shtetëror të avionëve të regjistruar në Kosovë, certifikimi i avionëve, aeroporteve, ofruesve të shërbimeve të navigacionit ajror dhe personelit të aviacionit.
- iv. Ngritja e nivelit të sigurisë së transportit ajror në Republikën e Kosovës;
- v. Rregullimi ekonomik i aeroporteve dhe shërbimeve të navigacionit ajror në përputhje me ligjin në fuqi dhe praktikat më të mira ndërkombëtare;
- vi. Mbikëqyrja dhe sigurimi i zbatimit në mënyrë efektive të legjislacionit, standardeve, rregullave, procedurave dhe urdhrave të aviacionit civil;

Tabela 1: Trendët historike të financimit

	2008	2009	2010 Rishikuar
Totali	840,543	840,543	808,020
Paga dhe Mëditje	10,655	425,000	425,000
Mallra dhe Shërbime	829,888	390,543	383,020
Shpenzimet Kapitale		25,000	
Numri i stafit		21	21

Tabela 2: Vlerësimet për KASH-in 2011-2013

	2010 Rishikuar	2011	2012	2013
Totali	808,020	838,021	840,543	840,543
Paga dhe Mëditje	425,000	425,000	425,000	425,000
Mallra dhe Shërbime	383,020	413021	415543	415543
Shpenzime Kapitale				
Numri i stafit	21	21	21	21

Në tabelën 2, janë të përfshira shpenzimet operative të cilat nuk parashihet të ndryshojnë nga viti 2010.

Tabela 3: Nevojat shtesë për financim mbi kufirin buxhetor 2011-2013

	2011	2012	2013
Totali	265,457	231,835	196,869
Shpenzimet Operative	265,457	231,835	196,869
Numri i punëtoreve	4	4	4

Në tabelën 3, nevojat shtesë për financim, është paraqitur kërkesa për rritje të numrit të punëtoreve, e cila rritje do të ndikoj edhe në rritje të shpenzimeve operative, e kryesisht në kategori të mallra dhe shërbime .

ZYRA RREGULLATORE PËR UJË DHE MBETURINA

I. Misioni

Misioni i Zyrës Rregullatore për Ujë dhe Mbeturina, është rregullimi i shërbimeve të ujësllësit kanalizimit ujërave të zeza dhe mbeturinave të ngurta në mënyrë efektive dhe transparente në pajtim me praktikatat e mira Evropiane, të cilat sigurojnë që ofruesit e shërbimeve të ujit dhe mbeturinave japin shërbime kualitative, të qëndrueshme, të besueshme dhe me çmime të përballueshme në tërë Kosovën, duke pasur parasysh ruajtjen e mjedisit dhe shëndetit publik.

II. Gjendja aktuale

Niveli dobët i faturimit dhe inkasimit
Niveli i lartë i shpenzimeve fikse dhe operative
Humbjet e ujit në shkallë të lartë

III. Objektivat Strategjike

- i. Ngritja e standardeve të shërbimit, si dhe ngritja e shkallës së inkasimit
- ii. Mbrojtja e interesave të konsumatorëve
- iii. Monitorimi dhe raportimi i performancës së ofruesve të shërbimeve,
- iv. Miratimi i kushteve për falje dhe shlyerje të borxheve nga e kaluara.
- v. Zvogëlimi i humbjeve të ujit.

Tabela 1: Trendët historike të financimit

	2008	2009	2010 Rishikuar
Totali	213,480	344,520	342,112
Paga dhe Mëditje	94,161	155,570	158,930
Mallra dhe Shërbime	119,319	188,950	183,182
Numri i stafit	19	19	19

Tabela 2: Vlerësimet për KASH-in 2011-2013

	2010 Rishikuar	2011	2012	2013
Total	342,112	346,006	347,040	347,040
Paga dhe Mëditje	158,930	161,450	161,450	161,450
Mallra dhe Shërbime	183,182	184,556	185,590	185,590
Numri i Stafit	19	19	19	19

Në tabelën 2, janë të përfshira shpenzimet operative të cilat nuk parashihet të ndryshojnë nga viti 2010

Bashkërendimi i strategjisë dhe resurseve të ZRRUM-it me prioritetet e qeverisë për buxhetin 2011-13

- Përcaktimi i tarifave që balancojnë nevojat e konsumatorëve për çmime të përballueshme dhe ruajtjen e integritetit financiar të ofruesve të shërbimeve,
- Lëshimi i licencave për ofruesit e shërbimeve të ujit dhe mbeturinave,
- Nxitja e konkurrencës në sektorët e ujit dhe mbeturinave përmes krahasimit të performancës (“benchmarking”),
- Mbrojtja e interesave të konsumatorëve duke siguruar që ofruesit e shërbimeve nuk keqpërdorin pozitën e tyre monopoliste dhe duke siguruar që shërbimet ofrohen në pajtim me standardet adekuate dhe të përcaktuara të shërbimit,
- Monitorimi dhe raportimi i performancës së ofruesve të shërbimeve,
- Themelimi dhe përkrahja e këshillave konsultative për konsumatorë,
- Miratimi i kushteve për falje dhe shlyerje të borxheve nga e kaluara.

ZYRA RREGULLATIVE E ENERGISË

I. Misioni

Zyra e rregullatorit për Energji, e themeluar në vitin 2004, në pajtim me Ligjin mbi Rregullatorin e Energjisë, luan një rol të rëndësishëm në transformimin e sektorit të energjisë, në operimin e tregut të rregulluar dhe konkurrues, në rregullimin e ndërmarrjeve energjetike që kanë pozitë monopoli, në dhënien e licencave operuese për pjesëmarrësit në treg dhe në mbikëqyrjen e tregut dhe të licencuarve.

II. Gjendja aktuale

ZRRE i ka kushtuar rëndësi të veçantë bashkëpunimit me ministritë relevante të Qeverisë së Kosovës, me komisionet parlamentare të Kuvendit të Kosovës, për t'i bashkërenditur aktivitetet që kanë të bëjnë me zbatimin e strategjisë dhe të politikave në sektorin e energjisë.

Është punuar në hartimin e projekt-rregulloreve për dhënien e autorizimeve për ndërtimin e kapaciteteve të reja të gjenerimit të energjisë dhe në ato për vendosjen e një kornize ligjore adekuate për përdorimin e burimeve të ripërtëritshme të energjisë dhe për bashkëgjenerim. Ndihmesë teknike për realizimin e këtij qëllimi ka dhënë AER, USAID dhe Banka Botërore.

Rëndësi e veçantë i është kushtuar fushës së mbrojtjes së konsumatorëve, përmes monitorimit të ndërmarrjeve energjetike.

Zyra e Rregullatorit për Energji ka vazhduar bashkëpunimin me institucione e organizata ndërkombëtare siç janë: Këshilli i Rregullatorëve të Energjisë i Evropës (CEER) dhe Asociacioni Regjional i Rregullatorëve të Energjisë (ERRE).

III. Objektivat Strategjike

- i. Bashkëpunimi me palët e interesuara në sektorin e energjisë lidhur me implementimin dhe përmirësimin e kornizës ligjore;
- ii. Monitorimi i bizneseve e të gjitha kompanive energjetike;
- iii. Monitorimi i tregut të energjisë si dhe zhvillimi i tij;
- iv. Pjesëmarrja në shqyrtimin e çmimeve të kompanive energjetike dhe sigurimin që ato të përputhen me metodologjinë e tarifave të miratuara nga Zyra e Rregullatorit për Energji;
- v. Mbrojtja e konsumatorëve dhe kompanive energjetike në mbështetje me procedurat për zgjidhje të kontesteve;
- vi. Krijimi i kushteve të favorshme për investime të reja dhe hapjen e tregut për kompanitë e reja të ngrohjes.

Tabela 1: Trendët historike të financimit

	2008	2009	2010

			Rishikuar
Total	1,062,545	985,988	929,513
Paga dhe shtesa	401,045	364,988	397,134
Mallra dhe Shërbime	604,000	450,000	301,979
Subvencione /Transfere	17,500	12,000	0
Shpenzime kapitale	40,000	159,000	230,400
Numri i stafit	33	33	33

Tabela 2: Kërkesa për financim në 2011-2013

	2010 Rishikuar	2011	2012	2013
Total	929,513	936,862	752,588	758,588
Paga dhe shtesa	397,134	397,134	397,134	397,134
Mallra dhe shërbime	301,979	309,328	311,454	311,454
Subvencione dhe Transfere	0			
Shpenzimet kapitale	230,400	230,400	44,000	50,000
Numri i Punëtorëve	33	33	33	33

Kërkesa është në përputhje me kufijtë e vlerësuar.

Projektet kapitale kanë të bëjnë me furnizime me pajisje të teknologjisë së informacionit.

AGJENCIA KOSOVARE E PRIVATIZIMIT

I. Misioni

Administrimi, Mbajtja, Shitja, Llikuidimi i Ndërmarrjeve Shoqërore dhe asetëve në përputhje me ligjin për themelimin e Agjencisë Kosovare të Privatizimit.

AKP-ja do të vazhdojë me privatizimin përmes dy metodave:

“Spin-Off” – Asetet dhe një numër i kufizuar i detyrimeve të NSH-ve transferohen në shoqëri aksionare të themeluara rishtazi (Ndërmarrje të reja) me aksione të kompanive të reja të tenderuar më parë për shitje investitorëve privat. Detyrimet e mbetura dhe punëtorët mbeten në NSH.

“Likuidimi Vullnetar” – Ato NSH që nuk janë të suksesshme, asetet e tyre do të likuidohen për mes ankandit publik.

II. Gjendja aktuale

Mbi 599 ndërmarrje afariste në Kosovë janë identifikuar si potencialisht Ndërmarrje Shoqërore (NSH), të cilat paraqesin portofolin aktual të Agjencisë.

Gjatë vitit 2010, AKP-ja do të fillojë me privatizimin e NSH-ve duke krijuar një numër të konsiderueshëm të Ndërmarrjeve të reja të cilat pretendojnë të transformohen në Shoqëri Aksionare. AKP-ja do të jetë e fokusuar në privatizimin e NSH-ve të mëdha në vijim gjë që mund të paraqet një ndikim të madh në zhvillimin ekonomik të Kosovës.

AKP-ja do të privatizoj dhe ose likuidoj rreth 599 NSH me synim të shpërndarjes së fondeve prej privatizimit / likuidimit në ekonominë e Kosovës.

III. Objektivat Strategjike

Strategjitë kryesore për Agjencinë Kosovare të Privatizimit janë:

- i. Procesi i privatizimit të NSH-ve do të vazhdojë të realizohet me transparencë nga ana e AKP-së.
- ii. Procesi i likuidimit të Ndërmarrjeve të shoqërore dhe asetëve do të vazhdojë të realizohet me transparencë nga komisionet e pavarura të likuidimit të përcaktuara nga ana e AKP-së;
- iii. AKP-ja do të merr vendime për privatizimin vetëm pasi të konsultohet me zyrtarë të komunave në të cilat gjenden NSH-të relevante;
- iv. Komisionet Shqyrtuese do të kenë kompetenca të shqyrtojnë ankesa që kundërshtojnë çfarëdo veprimi të AKP-së ose të komisionit të likuidimit. Komisioni Shqyrtues do të lëshojë një rekomandim që do të jetë vendimi final i AKP-së. Një vendim i tillë mund të kundërshtohet në Odën e Veçantë të Gjykatës Supreme.

- v. Në Bordin e Drejtorëve, Komisione të Likuidimit dhe Komisione Shqyrtuese ka pjesëmarrje të komuniteteve Kosovare jo-Shqiptare dhe Ndërkombëtare (të emëruara nga ICO-ja).

Tabela 1: Trendët historike të financimit

	2008	2009	2010 Rishikuar
Total	4,878,600	10,509,141	9,229,573
Paga dhe Mëditje	2,888	184,500	197,774
Mallra dhe Shërbime	2,039,465	4,035,210	3,612,542
Subvencione dhe Transfere	784,058	3,089,431	3,182,870
Shpenzime Kapitale	2,052,189	3,200,000	2,236,387
Numri i Stafit	0	17	21

Vërejtje: AKP është themeluar në Korrik të vitit 2008 çka nënkupton se Buxheti i vitit 2008 është vetëm për periudhën Korrik – Dhjetor 2008.

Tabela 2: Kufijtë e vlerësuar të shpenzimeve 2011-2013

	2010 Rishikuar	2011	2012	2013
Totali	9,229,573	9,495,760	9,719,987	10,719,987
Paga dhe Mëditje	197,774	199,772	199,772	199,772
Mallra dhe Shërbime	3,612,542	3,815,685	3,837,345	3,837,345
Subvencione dhe Transfere	3,182,870	3,182,870	3,182,870	3,182,870
Shpenzimet Kapitale	2,236,387	2,297,433	2,500,000	3,500,000
Numri i Stafit	21	21	21	21

Në Tabelën 2. në Shpenzimet Operative janë të përfshira:

Subvencionet për Trepçën, dhe Shpenzimet operacionale për funksionimin normal të AKP-s me të gjitha programet e veta.

Në shpenzimet kapitale janë përfshi projektet e;

Trepçës; Thellimi i minierës-hapja e horizonteve XII-XII, Hapja e vendpunishtës në Melenic Miniera TREPÇA Stantërg etj si dhe projektet kapitale të Administratës Qendrore të AKP-s; Databaza e 20%-it, Riparimi i ndërtesës së AKP-se dhe zyrave rajonale.

Tabela 3: Kufijtë e vlerësuar të shpenzimeve kapitale 2011-2013

Emri i Programit	Projektet 2010 Rishikuar	Vlerësimet 2011	Vlerësimet 2012	Vlerësimet 2013
Totali	2,308,978	2,297,433	2,500,000	3,500,000
Administrata e AKP	229,442	197,433		
Trepça	2,079,536	2,100,000	2,500,000	3,500,000

Shënim:

Kufijtë e vlerësuar të shpenzimeve për AKP mund të ndryshojnë për shkak se Kontratat e 258 punëtorëve të cilët paguhen nga Komisioni Evropian skadon në Qershor 2011. Donacioni për Pagat dhe mëditjet për 258 punëtorët e AKP-s është 3,000,000 € në vit. I mbetet Kuvendit të Republikës së Kosovës që pas skadimit të kontratës t vendos mbi numrin e të punësuarve, pagat dhe mënyrën e funksionimit të AKP(sepse është e paraparë që procesi i privatizimit të përfundojë në vitin 2011).

Tabela 4: Nevojat shtesë për financim mbi kufirin buxhetor 2011-2013

	2011	2012	2013
Totali	10,341,405	18,918,827	4,524,084
Shpenzimet Operative	1,886,405	1,475,984	1,295,984
Shpenzimet Kapitale	8,455,000	17,442,843	3,228,100

Kërkesa shtesë për financim për KASH-in 2011-2013, kanë të bëjnë me projektet kapitale të Trepçës dhe atë:

- Revitalizimi i reparteve të Flotacionit në Tunelin e Parë,
- Rehabilitimi i deponisë së mbeturinave industriale ne PIM,
- Projekti për prodhimin e pajisjeve bujqësore,
- Projekti i fonderisë për përpunimin e çelikut te derdhur,
- Projekti i hapjes se Minierës Kaltrina – Kizhnice,
- Rikonstruimi dhe modernizimi i repartit për prodhimin e sulfatit të aluminit etj.

KOMISIONI I PAVARUR PËR MINIERA DHE MINERALE

I. Misioni

Komisioni i Pavarur për Miniera dhe Minerale – KPMM-ja është e përkushtuar që të krijoj një ekip të shëndoshë dhe të fuqishëm më staf profesional, bazuar në ndërtimin e kapaciteteve dhe pajisjeve profesionale. Bashkëpunim të mirë më institucionet e Republikës së Kosovës, ambient të sigurt në aktivitetet minerare, politikë transparente të informatave, bazuar në qasjen publike përmes internetit, lidhje të forta me komunitetin e investuesve ndërkombëtarë dhe ti jepet Kosovës një epërsi në botën e xehetarisë globale.

II. Gjendja aktuale

Komisioni i Pavarur për Miniera dhe Minerale – është themeluar në pajtim me Rregulloren e UNMIK-ut nr. 2005/2 të datës 21 janar 2005 mbi themelimin e Komisionit të Pavarur për Miniera dhe Minerare, funksionon në bazë të Ligjit Nr. 03/L-081. KPMM, aktualisht ka të punësuar 77 punonjës në fazën e rekrutimit janë edhe dy pozita. KPMM, pos zyrës qendrore ka edhe katër zyre regjionale.

III. Objektivat Strategjike

- i. Implementimi i Legjislacionit minerare, politikave dhe strategjisë minerare.
- ii. Licencimi i kompanive minerare në harmoni me planin për menaxhimin e resurseve minerale;
- iii. Shfrytëzimi i Qëndrueshëm i resurseve minerale;
- iv. Joshja e Investitorëve përmes promovimeve të potencialit mineral që ofron Kosova.
- v. Aktivitetet hulumtuese.

Tabela 1: Trendët historike të financimit

	2008	2009	2010 Rishikuar
Totali	837,803	1,520,095	1,472,102
Paga dhe Mëditje	308,948	491,447	508,007
Mallra dhe Shërbime	408,855	622,148	619,095
Subvencione dhe Transfere	0	36,000	20,000
Shpenzime Kapitale	120,000	370,500	325,000
Numri i Stafit	64	79	79

Tabela 2: Kërkesa për financim në KASH 2011-2013

	2010	2011	2012	2013
Total	1,472,102	1,495,986	1,724,435	1,874,435
Paga dhe shtesa	508,007	516,287	516,287	516,287
Mallra dhe shërbime	619,095	634,699	638,148	638,148
Subvencione dhe transfere	20,000	20,000	20,000	20,000
Shpenzimet kapitale	325,000	325,000	550,000	700,000
Numri i Stafit	79	79	79	79

Tabela 3: Kufijtë e vlerësuar të shpenzimeve 2011-2013

	2010 Rishikuar	2011	2012	2013
Total	1,472,102	1,471,146	1,699,595	1,849,595
Paga dhe Mëditje	508,007	491,447	491,447	491,447
Mallra dhe Shërbime	619,095	634,699	638,148	638,148
Subvencione dhe Transfere	20,000	20,000	20,000	20,000
Shpenzimet Kapitale	325,000	325,000	550,000	700,000
Numri i Stafit	79	79	79	79

Në kufijtë e vlerësuar të shpenzimeve është paraparë rritja për shpenzime operative dhe rritje për shpenzimet kapitale krahas vazhdimit të financimit për projektet shumëvjeçare si: Ndërtimi i 4 plansheteve të Hartës Gjeologjike, Avancimi i bazës së të dhënave si dhe avancimi i teknologjisë informative.

Tabela 4: Kufijtë e vlerësuar të shpenzimeve kapitale 2011-2013

Emri i programit	Projektet 2010 Rishikuar	Vlerësimet 2011	Vlerësimet 2012	Vlerësimet 2013
Totali	325,000	325,000	550,000	700,000
KPMM	325,000	325,000	550,000	700,000

NJËSIA PËR MONITORIMIN E NDËRMARRJEVE PUBLIKE

I. Misioni

Synim i përgjithshëm i Njesisë për Politika dhe Monitorim të Ndërmarrjeve Publike është të realizohet vlera maksimale e aksionarit në ndërmarrjet publike qendrore duke kërkuar të ofrojmë kthime pozitive të qëndrueshme brenda parametrave të rregulloreve të përcaktuara nga qeveria dhe me përfshirjen e duhur të sektorit privat.

II. Gjendja aktuale

Ligji mbi ndërmarrjet publike, që është nxjerrë në vitin 2008, themelon pronësi të qartë të ndërmarrjeve publike nga Qeveria e Kosovës. Qeveria qendrore ka pronësi në ndërmarrjet publike në sektorin e transportit, telekomunikacionit, energjisë, të ujerave dhe atë të mbeturinave. Komunat, ndaras apo së bashku, kanë gjithashtu pronësinë e tyre në ndërmarrjet publike të ngrohjes së qytetit, të një pjesë të mbeturinave dhe të sektorit banesor-shtëpiak.

Pas themelimit të Njesisë për Politika dhe Monitorim të Ndërmarrjeve Publike në vitin 2008, angazhimi, është fokusuar në implementimin e aranzhimeve të qeverisjes së korporatave për ndërmarrjet publike dhe të administrimit të grandeve për ndërmarrjet publike.

Gjatë vitit 2008 qeveria ka aprovuar një politikë të pronësisë e cila ka privatizimin si tipar të veçantë. Përparim i dukshëm është bërë drejt privatizimit në sektorin e energjisë dhe atë të telekomunikacionit.

Privatizimi ishte një prej supozimeve kryesore në zhvillimin e KASH-it dhe të Buxhetit për periudhën 2010-2012. Në veçanti, përfshirja e sektorit privat në sektorin e energjisë ishte parashikuar të mundësojë ndalimin e subvencioneve qeveritare për sektorin e energjisë gjatë vitit 2010.

III. Objektivat Strategjike

Politika qeveritare e pronësisë ka katër objektiva kryesore:

- a) Ti ofrojë Qeverisë së Kosovës një kuptim më të gjerë të, si dhe besim në performancën e ndërmarrjeve publike, përmes qeverisjes korporatave të përmirësuar, menaxhimit të performancës dhe transparencës në ndërmarrjet publike në Kosovë.
- b) Të zhvillojë struktura të duhura të kapitalit të cilat imponojnë disiplina të nevojshme financiare në ndërmarrjet publike, duke siguruar që ato të kenë kapital të mjaftueshëm për të marrë vendime për investime operative me kërkesa minimale nga buxheti i Kosovës.
- c) Të sigurojë që kërkesat për shpenzime kapitale të jenë në linjë me nevojat e biznesit duke njohur faktin që investimet e mëdha duhet të shqyrtohen në raport me kërkesat tjera

për shpenzimet kapitale në qeveri, duke përfshirë kërkesat e ndërmarrjeve publike për ekuitet për investime të rëndësishme në procesin normal të buxhetit.

d) Të përfshijnë sektorin privat në operimin e ndërmarrjeve publike, përfshirë këtu edhe privatizimin si dhe Partneritetet Publike Private, për të arritur në pozitën ku pronësia e qeverisë mbahet vetëm aty ku është e domosdoshme për të mbrojtur interesat publike.

Në implementimin e politikës së saj të pronësisë, dhe në përpjekje për arritjen e synimeve të mësipërme, Qeveria vepron në pajtim me Ligjin nr. 03/L-087 për Ndërmarrjet Publike dhe në respektim të plotë të Kushtetutës së Republikës së Kosovës.

Qeveria e Kosovës synon të arrijë qeverisje efektive dhe të përgjegjshme të korporatës në ndërmarrjet publike. Nga kjo do të përfitojnë të gjitha grupet e interesit, ekonomia si dhe mirëqenia e Kosovës në përgjithësi. Qeverisja e mirë korporatave kontribuon në rritjen ekonomike dhe në stabilitetin financiar, duke ruajtur besueshmërinë e tregut dhe integritetin e tregut financiar.

Në ushtrimin e funksionit të pronësisë, qeveria e Kosovës synon të ndjekë rekomandimet e Organizatës për Bashkëpunim Ekonomik dhe Zhvillim, ashtu si është shprehur në Parimet e Qeverisjes së Korporatave të vitit 2004 (“Parimet”), dhe në Udhëzimet për Qeverisje të Korporatave të Ndërmarrjeve në Pronësi Shtetërore të vitit 2005 (“Udhëzimet”).

Ndikimet fiskale

Ndjekja e caqeve të politikave të lartë përmendura nënkupton ndikimet në vijim mbi BKK-në për periudhën kohore të këtij KASH-i:

1. Eliminimi i subvencioneve për KEK-un për periudhën e këtij KASH-i, duke njohur që është paraparë që sektori privat të bartë ngarkesën e çdo investimi kapital të ri në KEK që nga viti 2010. Shih pjesën e veçantë lidhur me sektorin e energjisë elektrike. BKK-ja do të vazhdojë me subvencionimin e pagesës së rrymës për “rastet sociale”.
2. Subvencione të vazhdueshme për ujësjellësin dhe mbeturinat dhe për nxehjen e qytetit, duke përfshirë ato nën pronësinë e komunave, gjatë periudhës në të cilën do të themelohen pronësia dhe qeverisja e korporatave, duke lejuar kohë të mjaftueshme për ekzaminim real dhe të mjaftueshëm të përfshirjes së sektorit privat në këta sektorë.
3. Pjesëmarrja e sektorit privat në Postën dhe Telekomunikacionin e Kosovës dhe në sektorin e energjisë: në kapacitetet e gjenerimit dhe atë të distribucionit, dhe në transportin publik në operimin e Hekurudhave të Kosovës, duke marrë parasysh këshillat e ekspertëve të transaksionit për kohën dhe strukturën e privatizimit.

KEK – DISTRIBUIMI DHE FURNIZIMI ME ENERGJI ELEKTRIKE

Njësia për implementim të projektit

Misioni i njësisë për implementim të projektit në bashkëpunim me Qeverinë e Kosovës është privatizimi i rrjetit të KEK-ut për distribuim dhe furnizim me rrymë elektrike. Gjithashtu, ne jemi të angazhuar për të tërhequr pjesëmarrjen e sektorit privat përmes procesit transparent të tenderit sipas praktikave më të mira ndërkombëtare që do të jenë të hapura dhe të drejta për të gjithë konkurrentët.

I tërë procesi, duke përfshirë qasjen në informata, kontrollin e ofertave, kontaktet me investitorë, dhomën e të dhënave, kontrollet e nevojshme dhe aspektet tjera të procesit të tenderit do të kontrollohen dhe monitorohen nga afër.

Të gjithë investitorët/ ofertuesit do të trajtohen në mënyrë të barabartë dhe jo-diskriminuese, të gjithë do të kenë qasje të barabartë në informata; të gjithë do të kenë të njëjtën periudhë kohore, të gjithë do të kenë kontakt të njëjtë me Qeverinë dhe me këshilltarë, si dhe do të kenë kushte të barabarta/identike dhe në bazë të kësaj do të mund të përgatitin ofertat e tyre.

Të gjithë ofertuesit do të mund të konkurrojnë sipas të njëjtave kriteresh dhe me marrëveshje identike të përcaktuar për shitje. Ne gjithashtu jemi të angazhuar të zhvillojmë këtë proces me transparencë të plotë.

Formula finale për të përcaktuar fituesin do të jetë saktësisht e matshme dhe objektive, duke u bazuar në çmime dhe investime dhe nuk do të ketë hapësirë për subjektivitet, interpretim ose pasiguri.

Njësia për implementim të projektit është faza fillestare dhe gjatë 2010 planifikon të privatizojë sektorin e KEK-ut për distribuim dhe furnizim.

Objektivat kryesorë të planit afatmesëm janë:

- i) Procesi i privatizimit do të vazhdojë të realizohet me transparencë NjIP në bashkëpunim me këshilltarin e IFC-së për transaksione dhe këshilltarin për energjetikë të USAID-it (Deloitte);
- ii) Identifikimi i modelit të tregut, që është në proces e sipër të diskutimeve me Zyrën e Rregullatorit të Energjisë, KOSTT-in, MEM, USAID, NjIP dhe LPTAP.
- iii) Përgatitja profesionale e transaksionit për privatizim si dhe për vet privatizimin, që do të ishte në përputhje me strategjinë e energjisë, sipas ligjeve në vijim: Ligji nr. 03/L-087 për ndërmarrje publike, procedurat e tenderit sipas Ligjit nr. 03/ L – 090 Ligji mbi partneritetin publik-privat dhe dhënie me koncesion.

Tabela 1: Trendët historike të financimit

	2008	2009	2010 Rishikuar
Total		71,659,897	57,450,847
Paga dhe Mëditje		21,565	34,490
Mallra dhe Shërbime		158,871	729,828
Subvencione dhe Transfere		49,398,461	41,850,000
Shpenzime Kapitale		22,081,000	14,836,529
Numri i stafit		6	7

Tabela 2: Kufijtë e vlerësuar të shpenzimeve 2011-2013

	2010 Rishikuar	2011	2012	2013
Totali	57,450,847	57,519,509	37,637,557	37,637,557
Paga dhe Mëditje	34,490	35,438	33,638	33,638
Mallra dhe Shërbime	729,828	679,442	799,290	799,290
Subvencione dhe Transfere	41,850,000	40,900,000	20,900,000	20,900,000
Shpenzime Kapitale	14,836,529	15,904,629	15,904,629	15,904,629
Numri i Stafit	7	7	7	7

Në tabelën 2 janë të paraqitura në shpenzimet operative;

- Subvencionet për Importin e Energjisë KEK-un, Subvencionet për Rastet Sociale, Subvencionet për furnizimin me Mazut-Ngrohja Qendrore, Subvencionet për Ujë dhe hedhurina etj.

Ndërsa në Shpenzimet Kapitale projektet;

- KOSTT; Transmision -Renovim i Kosovës A, Transmisoini SCADA EMS, Paket Projekti 400/110 kv - Ferizaj 2 etj.
- Hekurudhat; Riparimi i Lokomotivave-Rifabrikim, Furnizimi me pjesë rezervë për infrastrukturën e hekurudhave

Ngrohja Qendrore; Furnizimi dhe instalimi me gypa të paraizoluar, Zgjerimi dhe riparimet në rrjetin primar të termofikimit etj

- Uji dhe hedhurinat, Ndërrimi i Gypacionit ADDN të ujësjellësit-Ternavc, Gypat e Ujit, Ujëmatësja, etj.

Tabela 3: Nevojat shtesë për financim mbi kufirin buxhetor 2011-2013

	2011	2012	2013
Totali	54,659,098	80,057,069	95,326,128
Shpenzimet Operative	6,781,128	26,781,128	47,681,128
Shpenzimet Kapitale	47,877,970	53,275,941	47,645,000

Kërkesa shtesë për financim për KASH-in 2011-2013, kanë të bëjnë me;

- Projektet kapitale të KOSTT-it (Rehabilitimi i Stabilimenteve 110 kv në TS 110/35 kw-Vallaq, Paket projekti i Instalimit të TR1,150 MVA ne SSH 220kv Drenasi 1,
- Rindërtimi i Stabilimenteve 110 kv ne NS 110/kv Gjakova-1, Rindërtimi i Stabilimenteve 110 kv ne NS 110/kv Peja-1) etj
- Hekurudhat e Kosovës (Ndërtimi për modernizimin e linjës Fushë Kosovë – Prishtinë, Ndërtimi për modernizimin e linjës Fushe - Kosovë – Ferizaj, Blerja e vagonëve dhe trenave motorik) etj.
- Si dhe projekteve kapitale të Ngrohjes Qendrore dhe Ujit dhe Hedhurinave.

RADIO TELEVISIONI I KOSOVËS

Transmetuesi Publik

Radiotelevizioni i Kosovës (RTK) është shërbim publik transmetues, që ofron shërbimet e veta në fushën e transmetimit radioteleviziv dhe veprimtari të tjera, sipas Ligjit për RTK-në, i miratuar nga Kuvendi i Kosovës, më 20 janar 2006.

I. Misioni

Misioni i RTK-së është që t'i ofrojë auditorit informim objektiv dhe të balancuar, program cilësor edukativ, kulturor dhe argëtues dhe të inkurajojë zhvillim harmonik të demokracisë dhe tolerancës.

Në zbatimin e misionit të vet RTK-ja ndjek këto parime dhe vlera: Lirinë e fjalës, kreativitetin dhe ndërgjegjes, Pavarësinë, Objektivitetin, Korrektësinë, Saktësinë, Transparencën, Respektimin e interesave dhe vlerave të shoqërisë, Respektimin e dinjitetit njerëzor, të drejtave individuale, të jetës private, Informim të plotë, Përgjegjësinë personale, Tolerancën dhe Opinionet e ndryshme.

II. Gjendja aktuale

RTK-ja transmeton në rrjetin tokësor dhe atë satelitor televiziv, me skema të ndryshueshme programore dhe në kuadër të vet ka dhe dy radio stacione, Radio Kosova dhe Radio Blue Sky, si dhe ueb-faqen, www.rtklive.com.

RTK-ja prodhon dhe transmeton program në pesë gjuhë: shqip, serbisht, turqisht, boshnjakisht dhe në gjuhën rome.

Radiotelevizioni i Kosovës (RTK) është pjesë e demokratizimit dhe një nga institucionet e rëndësishme të Kosovës. Si i tillë, RTK ndihmon në shprehjen e pluralizmit politik dhe diversitetit etnik, gjuhësor, kulturor dhe religjioz, si dhe në promovimin e mëtejme të prodhimit vendor dhe integrimin shoqëror përgjithësisht.

RTK-ja sot paraqet mozaikun shoqëror dhe etnik të Kosovës dhe i kontribuon rritjes ekonomike, inkurajon pluralizmin politik, avancoon diversitetin kulturor, tolerancën ndëretnike, demokratizimin dhe integrimin shoqëror në përgjithësi.

Tabela 2: Kufijtë e vlerësuar të shpenzimeve 2011-2013

	2010 Rishikuar	2011	2012	2013
Totali	10,464,000	9,000,000	9,000,000	9,000,000
Paga dhe Mëditje				
Mallra dhe Shërbime				
Subvencione dhe Transfere	10,464,000	9,000,000	9,000,000	9,000,000
Shpenzime Kapitale				
Numri i Stafit				

AUTORITETI RREGULLATIV I TELEKOMUNIKACIONIT

I. Misioni

Misioni i ART është që të zhvillojë sektorin e telekomunikacionit në Kosovë, dhe ekonominë informative përmes implementimit të politikave që janë në përputhshmëri me reformat në këtë sektor të cilat implementohen nga Unioni Evropian dhe pjesa tjetër e botës së industrializuar.

II. Objektivat Strategjike

Objektivat kryesore të ART-së do të arrihen përmes hyrjes në treg, promovimit të konkurrencës së shëndoshë midis operatorëve të licencuar, teknologjive dhe shërbimeve të reja në mënyrë që të përmbushen kërkesat e konsumatorëve.

ART-ja do të sigurojë mbrojtjen e konsumatorit, qeverisje të dobishme dhe transparente dhe përdorim optimal të resurseve të kufizuara. Për këtë kërkohet krijimi i një kornize ligjore të përshtatshme për monitorimin dhe mbikëqyrjen e këtij sektori, e cila kornizë lehtëson dhe mundëson qeverisje transparente dhe të dobishme. Si institucion, ART e vlerësojmë themelimin e një sistemi të pavarur rregullator për mbikëqyrjen e tranzicionit nga sistemi monopol në atë të tregut konkurrues në një mjedis rregullator dhe ligjor i cili do të promovojë investimet dhe konkurrencën e lirë në mënyrë që të përmbushen kërkesat e konsumatorëve të shërbimeve telekomunikuese.

Tabela 1: Trendët historike të financimit

	2008	2009	2010
Total	2,242,579	1,471,488	1,568,578
Paga dhe shtesa	222,279	248,488	248,488
Mallra dhe Shërbime	420,300	423,000	445,090
Subvencione /Transfere	0	0	
Shpenzime kapitale	1,600,000	800,000	875,000
Numri i stafit	30	30	30

Tabela 2: Kërkesa për financim 2011-2013

	2011	2012	2013
Totali	3,439,183	3,164,155	2,532,187
Paga dhe Mëditje	443,183	539,655	614,687
Mallra dhe Shërbime	696,000	724,500	617,500
Subvencione dhe Tansfere			
Shpenzime Kapitale	2,300,000	1,900,000	1,300,000
Numri i stafit	45	30	30

Tabela 3: Rekomandimet për financim në KASH 2011-2013

	2010 Rishikuar	2011	2012	2013
Totali	1,568,578	1,544,474	1,171,488	1,171,488
Paga dhe Mëditje	248,488	248,488	248,488	248,488
Mallra dhe Shërbime	445,090	420,986	423,000	423,000
Shpenzime Kapitale	875,000	875,000	500,000	500,000
Numri i Stafit	30	30	30	30

SEKTORI I ARSIMIT DHE KULTURËS

Kosova – shoqëri e bazuar në dije dhe shkathtësi konkurruese, e integruar në rrjedha evropiane, me mundësi të barabarta për avancimin e secilit individ që të përgatiten e të kontribuojnë në zhvillimin e qëndrueshëm shoqëror, ekonomik, kulturor dhe politik në vend.

Kosova shoqëri demokratike që ofron mundësi të barabarta për zhvillim personal të të gjithë qytetarëve, ku qasja në përfitim të dijes, hulumtimeve shkencore dhe të përfitimit të shkathtësive, janë në funksion zhvillimit të përshpejtuar të shoqërisë sonë dhe aftësive konkurruese brenda dhe jashtë Kosovës.


I. Gjendja Aktuale

Prej Buxhetit të Kosovës për vitin 2010 janë ndarë €65,89 milion, ose rreth 7.01%, për këtë sektor. Ministritë që përbëjnë sektorin e arsimit janë: Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë; Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit; Universiteti i Prishtinës; Akademia e Shkencave dhe e Arteve të Kosovës; Këshilli i Kosovës për Trashëgimi Kulturor dhe Universiteti i Prizrenit.

Gjatë vitit kalendarik 2009 dhe 2010 është vazhduar me reformimin e të gjitha niveleve arsimore. Janë implementuar masa konkrete të parapara në Strategjinë Para universitare dhe të Arsimit të Lartë. Ka filluar procesi i licencimit të mësimdhënësve dhe avancimi i gjendjes materiale të sistemit të pagave në të gjitha nivelet.

Është investuar në ndërtimin, zgjerimin dhe renovimin e hapësirës shkollore, shpërndarë libra falas nga klasa e 1-9, janë përpiluar dhe publikuar tekste të reja mësimore, është filluar konkretisht me instalimin e kabineteve kompjuterike nëpër shkolla, kërkimet shkencore të vazhdueshme të ASHAK dhe kompletimi i infrastrukturës ligjore të nevojshme për këtë sektor.

Zhvillimin e dialogut ndërkulturor në reciprocitet dhe integritet në plane rajonale, evropiane dhe më gjerë e veçanërisht promovimi i identitetit kulturor Kosovar në arenën ndërkombëtare, ndërkombëtarizimin e sportit duke ju përshtatur rrethanave dhe kriterëve që i kërkon federata ndërkombëtare dhe janë licencuara në Institucionet Ndërkombëtare 9 federata të ndryshme sportive. Krijimi i këshillit për trashëgimi kulturor.



II. Planet e ardhshme

Korniza Afatmesme e Shpenzimeve për vitin 2011 – 2013, thekson rëndësinë e këtij sektori, lidhjen e qëndrueshme të arsimit dhe kulturës me zhvillimet ekonomike dhe shoqërore ku do të aktualizojë rëndësinë e kualifikimeve në fushën e arsimit profesional dhe të arsimit të lartë për nevojat e ekonomisë të tregut të punës.

Sektori i Arsimit dhe Kulturës është i përkushtuar për të punuar në rishikimin dhe modernizimin e legjislacionit ekzistues për këtë sektor dhe për të siguruar harmonizim me politikat e BE-së dhe me ligjet relevante, për të rishikuar dhe zhvilluar kornizën e plan-programeve në Kosovë, për zhvillim të kapaciteteve në nivelin qendror dhe lokal, për përmirësime në koordinimin me donatorë dhe për lidhshmëri. Vazhdimi i procesi të licencimit të mësimdhënësve.

Përkujdesjen dhe vlerësimin e vlerave të trashëgimisë kulturore, ngritjen e cilësisë të kësaj natyre, përkrahjen për lobim dhe ndërkombëtarizim të sportit dhe kulturës. Implementimi i Strategjisë dhe Planit të Veprimit për Rini 2010-2012.

*Përmbledhje e vlerësimeve të hershme në nivel sektori

	2010	2011	2012	2013
	Rishikuar			
Totali	65,896,204	62,517,018	63,389,602	64,129,912
Paga dhe Mëditje	14,782,299	15,188,614	15,188,614	15,188,614
Mallra dhe Shërbime	13,594,462	12,855,777	12,934,412	12,934,412
Subvencione dhe Transfere	7,007,300	4,189,525	4,206,886	4,206,886
Shpenzime Kapitale	30,512,143	30,283,102	31,059,690	31,800,000
Numri i stafit	3,525	3,523	3,523	3,523

* Agjencionet e pavaruara në tabelën përmbledhëse sektoriale janë të përfshira sipas rekomandimeve për financim

Përmbledhje e projekteve kapitale në nivel të OB-së

	2010 Rishikuar	2011	2012	2013
Totali	30,512,143	30,283,102	31,059,690	31,800,000
MASHT	23,488,781	22,875,196	23,000,000	23,100,000
MKRS	5,786,371	6,166,424	6,559,690	7,100,000
UP	1,236,991	1,241,482	1,500,000	1,600,000
ASHAK	-	-	-	-
KKTK	-	-	-	-

Projektet e paraqitura në tabelën 2, janë projektet të cilat kanë filluar në vitin 2009 dhe vazhdojnë edhe në vitet në vijim, Funkcionalizimin e Universitetit të Prizrenit; Bashkëfinancimi në projektet e IPA-së, ndërtimi dhe renovimi hapësirave shkollore; Veprimtaria botuese e Akademisë (botimi i rezultateve të studimeve shkencore).

Projektet kontingjente në burimet shtesë në nivel sektori

	2011	2012	2013
Totali	57,717,025	55,188,477	61,418,063
Paga dhe Mëditje	10,038,794	10,902,042	11,817,939
Mallra dhe Shërbime	7,164,593	7,424,885	7,846,641
Subvencione dhe Transfere	239,225	487,842	812,947
Shpenzime Kapitale	40,274,413	36,373,708	40,940,536
Numri i stafit	600	647	696

Nevojat për kërkesa shtese të këtij sektorit janë përcaktuar duke marrë për bazë koston e politikave ekzistuese dhe politikave të reja të Organizatave buxhetore, ndër politikat e reja:

Funksionalizimin e Universitetit të Prizrenit; Rritja e pjesëmarrjes në trajnim të mësimdhënësve në funksion të Funkcionalizimit të Universitetit të Prizrenit, Universitetit të Prishtinës; Kualifikimi dhe rikualifikimi i mësimdhënësve; Rritja e përfshirjes së fëmijëve me nevoja të veçanta në të gjitha nivelet e arsimit; Bursat për studentë si rrjedhojë e marrëveshjeve për përfshirje në Institucionet ndërkombëtare të arsimit të lart: Vlerësimet shtetërore (Vlerësimi në klasën e 5-të, klasën e 9-të dhe Matura): Bashkëfinancimi në projektin e IPA-së; Zhvillimi i kapaciteteve hulumtuese në Kosovë; Vazhdimin e ndërtimit të palestrave sportive në Kosove; Projekti për Teatër; Opera dhe Balet Dr. I. Rugova etj.

MINISTRIA E ARSIMIT SHKENCËS DHE TEKNOLOGJISË

I. Misioni

Ministria e Arsimit Shkencës dhe Teknologjisë ka mision zhvillimin e një sistemi arsimor efektiv, që do të kontribuon ngritjes së mirëqenies së shoqërisë duke i ofruar edukim dhe arsimim të barabartë për të gjithë qytetarët si dhe cilësi të lartë në fushën e kërkimeve shkencore dhe inovacioneve në pajtim me standardet bashkëkohore.

II. Gjendja Aktuale

Gjatë vitit kalendarik 2009 dhe 2010 është vazhduar me reformimin e të gjitha niveleve arsimore dhe aftësuese. Janë implementuar masa konkrete të parapara në Strategjinë Para universitare dhe të Arsimit të Lartë si dhe prioritetet e dala nga pikat programatike të MASHT-it. Është bërë hartimi i politikave si dhe janë krijuar mekanizma për ngritjen e mbikëqyrjes dhe të cilësisë në arsimin para universitar dhe universitar.

Deri më tani në projektet e infrastrukturës janë investuar 169,630 metra katror apo 65 objekte shkollore dhe kjo ka ndikuar që hapësira shkollore për një nxënës të rritet nga ajo që ishte më pare.

Ka filluar procesi i licencimit të mësimdhënësve dhe është avancuar gjendja materiale e tyre përmes zëvendësimit të sistemit aktual linear të pagave, Janë krijuar mekanizma për sigurimin dhe menaxhimin e efektshëm të burimeve dhe të mjeteve financiare për zhvillimin e një infrastrukture të plotë dhe funksionale për arsimin e lartë, ngritjen e kapacitetit për punë kërkimore-shkencore, promovimin e nevojës për arsim profesional dhe mësim gjatë tërë jetës; Janë themeluar dhe funksionalizuar: Qendra për Bashkëpunim Ndërkombëtar në Arsimin e Lartë, Shkencë dhe Teknologji (QBNASHT) dhe Qendra për Inovacion dhe Transfer Teknologji (QITT), Është investuar masovikisht në ndërtimin, zgjerimin dhe renovimin e hapësirës shkollore si një nga problemet kyçe për ngritjen e cilësisë në arsim, Janë shpërndarë libra falas për filloristët e krasëve 1-9, Janë përpiluar dhe publikuar tekste të reja mësimore, Është filluar konkretisht me instalimin e kabineteve kompjuterike nëpër shkolla, Ka përfunduar me sukses procesi i licencimit dhe akreditimit të ofertuesve privat të arsimit të lartë, Është rritur dukshëm cilësia dhe rëndësia e provimit të maturës, Janë rishikuar kurrikulat dhe plan-programet mësimore si dhe korniza kurrikulare, Është avancuar oferta përmbajtjesore dhe infrastrukture për minoritetet dhe lëmin e të drejtave të njeriut.

Përkushtimi i arsimit si një nga prioritetet shtetërore ka për qëllim ngritjen e cilësisë në sistemin arsimor i cili ofron mundësinë për gjithë, nga arsimi fillor dhe i mesëm, duke krijuar kështu një ambient të përshtatshëm dhe të shëndetshëm për mësimdhënie dhe mësimnxënie. Lidhja e qëndrueshme e arsimit me zhvillimet ekonomike dhe shoqërore do të aktualizojë rëndësinë e kualifikimeve në fushën e arsimit profesional dhe të arsimit të lartë për nevojat e ekonomisë dhe të tregut të punës.

III. Objektivat strategjike

Objektivat kryesore në planifikim afatmesëm janë:

- i. Arritja e gjithë përfshirjes, barazisë, cilësisë dhe diversitetit në arsimin
- ii. Jetësimi i autonomisë, sigurimi i cilësisë si dhe krijimi i diversitetit në arsimin universitar dhe jouniversitar
- iii. Shndërrimi i institucioneve të arsimit të lartë në institucion kërkimore dhe shkencore si dhe ndërlidhja e tyre me ekonominë dhe shoqërinë”
- iv. Arsimi tërë jetësor dhe zhvillimi i resurseve njerëzore.

Objektivi i parë Arritja e gjithë përfshirjes, barazisë, cilësisë dhe diversitetit në arsimin do të arrihet përmes këtyre programeve dhe aktiviteteve:

- a) Ndërtimi dhe renovimi hapësirave shkollore (përfshirë dhe shtatë shkollave profesionale) si dhe sigurimi i teksteve falas për nivelin e arsimit parauniversitar,
- b) Zhvillimi profesional - trajnimet e mësimdhënësve në funksion të rritjes së cilësisë në mësimdhënie, kualifikimi dhe rikualifikimi i mësimdhënësve,
- c) Themelimi dhe funksionalizimi i këshillave shtetërore dhe institucioneve-kompletimi i sistemit arsimor , vlerësimet shtetërore (Vlerësimi në klasën e 5-të, klasën e 9-të dhe Matura),
- d) Themelimi dhe fuqizimi i aktiveve profesionale në nivel shkolle, dhe rishikimi i planprogrameve në të gjitha nivelet e arsimit parauniversitar, dhe mbështetje për nxënësit me nevoja të veçanta,
- e) Mësimi plotësues në gjuhën amtare në diasporë, ofrimi i programeve të reja integruese për fëmijët e kthyer nga diaspora,
- f) Zhvillimi i bazës së të dhënave për infrastrukturën shkollore, hartat e shkollave, formimi i qendrave kompjuterike dhe menaxhimi i informatave,
- g) Hartimi i politikave për sigurim të cilësisë, certifikim, vlerësim, standarde dhe kualifikime në kuadër të komiteteve të këshillit për AAP, dhe harmonizimi i nivelit të kualifikimeve KKK me nivelet e arsimit ISCED,

Objektivi i dytë Jetësimi i autonomisë, sigurimi i cilësisë si dhe krijimi i diversitetit në arsimin universitar dhe jouniversitar arrihet përmes këtyre programeve dhe aktiviteteve:

- a) Sigurimi i përfshirjes më të madhe të gjeneratës së re në arsimin e lartë në harmoni me kërkesat e tregut të punës.
- b) Rritja e numrit të institucioneve të Arsimit të lartë, rritja e fondeve për bursa për studentë, për mësimdhënës si dhe ulja e kostos së shpenzimeve për studentë.
- c) Vlerësim i brendshëm dhe i jashtëm (akreditimi i IAL)
- d) Ndërkombëtarizimi i arsimit të lartë
- e) Ofrimi dhe rishikimi i kornizës ligjore në arsimin e lartë.

Objektivi i tretë Shndërrimi i institucioneve të arsimit të lartë në institucion kërkimore dhe shkencore si dhe ndërlidhja e tyre me ekonominë dhe shoqërinë arrihet përmes këtyre programve dhe aktiviteteve:

- a) Përkrahja e projekteve shkencore dhe zhvillimore me pjesëmarrje ndërkombëtare,
- b) Ngritja e infrastrukturës institucionale për punë shkencore, inovacion dhe transfer të teknologjisë, si dhe themelimi i njësive kërkimore, shkencore institucioneve dhe qendrave
- c) Themelimi i njësive të kërkimeve shkencore, instituteve dhe qendrave për kërkim shkencor në fushat prioritare,
- d) Mbështetja e aktiviteteve të Këshillit Kombëtar të Shkencës,
- e) Themelimi i Fondit për kërkime shkencore, jetësimi programit kombëtar të shkencës.

Objektivi i katërt Arsimi tërë jetësor dhe zhvillimi i resurseve njerëzore do të arrihet përmes këtyre programeve dhe aktiviteteve:

- a) Aftësimi i moshës së re për treg të punës dhe rritja e mundësive dhe kushteve për ngritje në karrierë;
- b) Arsimi tërë jetësor

Tabela 1-Trendët historike të financimit

	2008	2009	2010 Rishikuar
Totali	45,108,476	43,197,951	37,709,899
Paga dhe Mëditje	2,694,956	2,669,376	3,569,217
Mallra dhe Shërbime	3,751,123	2,718,576	8,456,171
Subvencione dhe Transfere	27,000	27,000	2,195,730
Shpenzimet Kapitale	38,635,397	37,782,999	23,488,781
Numri i stafit	991	991	1,090

Tabela 2 - Vlerësimet për KASH-i 2011-2013

	2010 Rishikuar	2011	2012	2013
Totali	37,709,899	34,535,729	34,694,871	34,794,871
Paga dhe Mëditje	3,569,217	3,844,102	3,844,102	3,844,102
Mallra dhe Shërbime	8,456,171	7,610,953	7,645,291	7,645,291
Subvencione dhe Transfere	2,195,730	205,478	205,478	205,478
Shpenzimet Kapitale	23,488,781	22,875,196	23,000,000	23,100,000
Numri i stafit	1,090	1,090	1,090	1,090

Projektet e paraqitura në tabelën 2, janë projektet të cilat kanë filluar në vitin 2009 dhe vazhdojnë edhe në vitet në vijim, Funksonalizimin e Universitetit të Prizrenit; Bashkëfinancimi në projektet e IPA-së, ndërtimi dhe renovimi hapësirave shkollore, dhe pajisjen me teknologji (kompjuter dhe internet) .

Tabela; 3 – Kufijtë e vlerësuar për projekte kapitale

Emri i programit	Projektet 2010 Rishikuar	Vlerësimet 2011	Vlerësimet 2012	Vlerësimet 2013
Totali	23,488,781	22,875,196	23,000,000	23,100,000
Administrata Qendrore	23,488,781	22,875,196	23,000,000	23,100,000

Projektet e paraqitura në tabelën 3, janë projektet në vazhdim dhe janë të kontraktuara.

Tabela; 4 – Nevojat për financim mbi kufirin buxhetor 2011-2013

	2011	2012	2013
Totali	39,529,861	35,110,345	35,804,154
Paga dhe Mëditje	3,084,021	3,084,021	3,084,021
Mallra dhe Shërbime	5,814,716	5,608,078	5,550,328
Subvencione dhe Transfere	69,502	138,246	189,805
Shpenzime Kapitale	30,561,622	26,280,000	26,980,000
Numri i stafit	233	233	233

Kërkesat shtesë janë përcaktuar duke marrë për bazë koston e politikave ekzistuese dhe politikave të reja të Ministrisë, ndër politikat e reja:

- Funkcionalizimin e Universitetit të Prizrenit;
- Rritja e pjesëmarrjes në trajnim të mësimdhënësve në funksion të Funkcionalizimin e Universitetit të Prizrenit;
- Rritja e përfshirjes së fëmijëve me nevoja të veçanta në të gjitha nivelet e arsimit;
- Bursat për studentë si rrjedhojë e marrëveshjeve për përfshirje në Institucionet ndërkombëtare të arsimit të lartë;
- Bashkëfinancimi në projektin e IPA-së, Zhvillimi i kapaciteteve hulumtuese në Kosovë;
- Pajisjen e të gjitha shkollave me kompjuterë dhe internet, etj.

MINISTRIA E KULTURËS, RINISË DHE SPORTIT

I. Misioni

Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit krijon mjedis të favorshëm për nxitjen dhe fuqizimin e vlerave të Kulturës, Rinisë dhe Sportit në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar, duke promovuar kreativitetin individual dhe diverzitetin kulturor, në kuadër të proceseve integruese evropiane të një shoqërie të lirë dhe demokratike.

II. Gjendja aktuale

Mungesa e kujdesit jo të duhur për institucionet e Kulturës, Rinisë dhe Sportit ka ndikuar dukshëm në gjendjen në të cilën është sot Kultura, Rinia dhe Sporti dhe si e tillë shtron nevojën e përkrahjes së aktiviteteve në fushat e lartë përmendura.

Siç dihet Kultura dhe Sporti janë ambasador për prezantimin e popullit tone në arenën ndërkombëtare.

Megjithatë brenda mundësive buxhetore dhe ekonomike që ka Kosova, në vitet e fundit kemi një rritje të financimit për këtë sektor për të filluar ndërtimet dhe renovimet e disa palestrave sportive, mbrojtjen dhe konservimin e disa monumenteve historike për arritjen e synimeve dhe objektivave të përgjithshme të MKRS-së.

Është bërë shumë pak për institucionet e rëndësishme si janë filarmonia, opera, baleti, ansambli shota, teatri dhe muzetë e që janë brumi i zhvillimit të kulturës Kosovare.

III. Objektivat strategjike

- i. Përkujdesjen dhe vlerësimin e vlerave të trashëgimisë kulturore, gërmime dhe hulumtime arkeologjike, legjislacioni për ruajtjen e trashëgimisë sipas standardeve bashkëkohore në harmoni të plotë me Bashkimin Evropian;
- ii. Përkrahja për lobim dhe ndërkombëtarizim të sportit, ndërtimi i infrastrukturës sportive;
- iii. Infrastruktura për zhvillimin e kulturës Kosovare;
- iv. Plani Kosovar i Veprimit për Rini;
- v. Infrastruktura ligjore.

Objektivi i parë: Përkujdesjen dhe vlerësimin e vlerave të trashëgimisë kulturore, gërmime dhe hulumtime arkeologjike, legjislacioni për ruajtjen e trashëgimisë sipas standardeve bashkëkohore në harmoni të plotë me Bashkimin Evropian do të arrihet përmes:

a) Mbrojtja, renovimi dhe konservimimi i objekteve historike,

b) Trashëgimia Kulturore në Kosovë të ketë organizim më të mirë, reformim

Institucional ku duhet të afirmohet më fuqishëm rëndësia dhe roli i trashëgimisë kulturore në institucionet qendrore, lokale kundrejt drejtorive komunale, sektorëve dhe shoqatave që merren me ruajtjen e trashëgimisë kulturore,

c) Të hartohen dhe zbatohen politikat dhe legjislacioni për ruajtjen e trashëgimisë kulturore sipas standardeve bashkëkohore në harmoni të plotë me direktivat e Bashkimit Evropian.

Objektivi i dytë: Përkrahja për lobim dhe ndërkombëtarizim të sportit, ndërtimi i infrastrukturës sportive do të arrihet përmes këtyre aktiviteteve:

- a) Zhvillimit të resurseve humane;
- b) Përkrahjes federatave të licencuara në lobimin për njohje të reja ndërkombëtarë;
- c) Krijimi i ligës sportive shkollore, të femrave në bashkëpunim me MASHT-i;
- d) Përkrahje e aktiviteteve sportive për minoritete dhe persona me aftësi të kufizuara.
- e) Funkcionalizimi, trajnimi i këtij sektorit anti-doping në qendrën e mjekësisë sportive dhe marrëveshjen me ministrin e shëndetësisë.
- f) Vazhdimi dhe përfundimi i punimeve në palestra sportive, për ndeshje ndërkombëtare.

Objektivi i tretë: Infrastruktura për zhvillimin e kulturës Kosovare do të arrihet përmes:

- a) Ndërtimi i Shtëpisë Teatër dhe Operë “Ibrahim RUGOVA”. Ky projekt mbetet prioritet i vetëm i MKRS në këtë institucion në tri vitet e ardhshme dhe kërkon financim nga Buxheti i Kosovës dhe donatorët.

Objektivi i katërt: Plani Kosovar i Veprimit për Rini do të arrihet përmes:

- a) Pjesëmarrja e të rinjve në mekanizmat institucional;
- b) Edukimi jo formal;
- c) Shëndeti i të rinjve,
- d) Përkrahja e rrjetëzimit dhe bashkëpunimi i të rinjve në aktivitete Rinore në nivel rajonal dhe Evropian;
- e) Implementimi i Ligjit për Fuqizim dhe Pjesëmarrje të Rinisë;
- f) Zhvillimi i programit arsimimi dhe punësimi – KOSVET VI.

Objektivi i pestë: Infrastruktura ligjore do të arrihet përmes:

- a) Implementimi i legjislacionit të aplikueshëm, respektivisht i ligjeve të aprovuara në këtë fushë, përgatitja e legjislacionit të ri, plotësimin e legjislacionin aktual dhe harmonizimin me legjislacionin e BE-s.

Tabela; 1 - Trendët historike të financimit

	2008	2009	2010 Rishikuar
Totali	9,443,508	11,170,933	12,382,736
Paga dhe Mëditje	1,012,716	993,283	888,583
Mallra dhe Shërbime	1,162,985	1,038,187	896,212
Subvencione dhe Transfere	3,195,000	3,826,933	4,811,570
Shpenzime Kapitale	4,072,807	5,312,530	5,786,371
Numri i stafit	322	322	232

Tabela; 2 - Kufijtë e vlerësuar të shpenzimeve për KASH-in 2011-13:

	2010 Rishikuar	2011	2012	2013
Total	12,382,736	12,011,975	12,422,602	12,962,912
Paga dhe Mëditje	888,583	913,565	913,565	913,565
Mallra dhe Shërbime	896,212	947,939	947,939	947,939
Subvencione dhe Transfere	4,811,570	3,984,047	4,001,408	4,001,670
Shpenzime Kapitale	5,786,371	6,166,424	6,559,690	7,100,000
Numri i stafit	232	230	230	230

Prioritet i MKRS është ndërkombëtarizimi i sportit, ndërtimi i objektit për Operë, Balet dhe Filarmoni, ndërtimi i palestrave sportive, renovimi dhe konservimi i objekteve të trashëgimisë kulturore.

Tabela; 3 – Projektet kapitale në nivel të departamentit

Emri i programit	Projektet 2010 Rishikuar	Vlerësimet 2011	Vlerësimet 2012	Vlerësimet 2013
Totali	5,786,371	6,166,424	6,559,690	7,100,000
Arrijtjet Sportive	3,393,086	2,935,466	2,678,732	3,064,107
Përkrahja Institucionale për Kulture	641,681	1,562,279	1,962,279	2,000,000
Trashëgimia Kulturore	1,751,604	1,668,679	1,918,679	2,035,893

Tabela; 4 – Nevojat për financim mbi kufirin buxhetor 2011-2013

	2011	2012	2013
Total	8,202,542	8,797,985	9,279,249
Paga dhe Mëditje	863,000	863,000	863,000
Mallra dhe Shërbime	25,546	41,681	62,571
Subvencione dhe Transfere	(580,277)	(400,404)	(126,858)
Shpenzime Kapitale	7,894,273	8,293,708	8,480,536
Numri i stafit	316	316	316

Informatë shtesë:

Shuma prej 3.5 milion mbi kufirin buxhetor të kërkuara nga buxheti për çdo vit është për projektin "ndërtimi, renovimi multifunksional për Pallatin e Rinise në bashkëfinancim me IPA", ndërsa IPA do të ndanë nga 4.6 mil në vit (nëse buxheti e ndanë pjesën e vetë), vazhdimi i ndërtimit të palestrave sportive nëpër Kosovë dhe projekti për teatër, operë Dr. I. Rugova.

Kërkesë kryesore e MKRS është punëtorët kontrate mbi vepër të hyjnë në liste të rregullt të pagave dhe pagesa e tyre që është bërë nga subvencionet dhe transfere të kthehen në kategori të pagave dhe mëditje, gjithsej janë 322 në këto institucione, filarmoni, balet, operë, kinometografi, teatër, muze.

UNIVERSITETI I PRISHTINËS

I. Misioni

Universiteti i Prishtinës (UP) është institucion autonom publik për arsimin e lartë, që zhvillon arsimin akademik, kërkimet shkencore, krijimtarinë artistike, këshillimet profesionale dhe fushat e tjera të veprimtarive akademike.

UP-ja ka për mision zhvillimin e një sistemi arsimor efektiv, që do t'i kontribuojë ngritjes së mirëqenies së shoqërisë, duke i ofruar edukim dhe arsimim të barabartë për të gjithë qytetarët, si dhe cilësi të lartë në fushën e kërkimeve shkencore, inovacioneve dhe transferim të teknologjisë, në pajtim me vlerat dhe standardet bashkëkohore, duke respektuar diversitetin e një shoqërie demokratike dhe të prosperuar.

II. Gjendja aktuale

Universiteti i Prishtinës ka 17 njësi akademike, të shpërndara në shtatë qendra administrative, me afro 44,000 studentë në aftësimin dhe përgatitjen e kuadrit adekuat, në zhvillimin e ekonomisë së vendit dhe jashtë.

Universiteti i Prishtinës, si i vetmi Universitet publik, është bartës kryesor i arsimit të lartë. Në këtë vit ka një përfshirje më të lartë të studentëve në krahasim me vitet tjera. Sistemi i reformave në arsim si pjesë përbërëse ka për qëllim edhe promovimin e demokracisë qytetare, zhvillimin e sistemit të menaxhimit të cilësisë së arsimit të lartë.

Universiteti i Prishtinës në këtë vit ka arritur që të hyrat vetanake të zbrazura në BQPK t'i barazojë dhe t'i destinojë për qëllimet e parapara në përputhje me MiM-in.

Një objektiv madhor për Universitetin mbetet thellimi dhe vazhdimi i bashkëpunimit me Institucionet e Arsimit të lartë rajonal dhe ndërkombëtar si dhe harmonizimi i plan-programeve me standardet evropiane.

Nga viti i kaluar ka filluar të realizohet objektivi i UP-së e që është futja në zonën evropiane të arsimit.

III. Objektivat strategjike

Objektivat kryesore në planifikim afatmesëm janë:

- i. Zgjerimi dhe mirëmbajtja e objekteve të Arsimit të lartë;
- ii. Ngritja e cilësisë në studime dhe mësimdhënie;
- iii. Shndërrimin e Universitetit në institucion të lartë për hulumtime shkencore
- iv. Ngritja dhe zhvillimi i sistemit informativ.

Objektiva e pare - Zgjerimi dhe mirëmbajtja do të arrihet përmes:

- a) Ndërtimin e objekteve të disa fakulteteve në Universitetin e Prishtinës;
- b) Rritja e hapësirës për përdorimin e teknologjisë bashkëkohore dhe pajisjeve laboratorike për studim;

- c) Ngritja e infrastrukturës institucionale për punë shkencore dhe inovacioneve.

Objektiva e dyte - Ngritja e cilësisë në studim do të arrihet për mes:

- Mësimdhënie, studim, diskurs akademik;
- Hartimi i politikave për sigurim të cilësisë, certifikim, vlerësim, standarde dhe kualifikime;
- Sigurimi i përfshirjes më të madhe të gjeneratës së re në arsimin e lartë, në harmoni me kërkesat e tregut të punës;
- Krijimi i strukturave për vlerësimin e brendshëm.

Objektivi i tretë - Shndërrimin e Universitetit në institucion të lartë për hulumtime shkencore do të arrihet për mes:

- Integrimi dhe internacionalizimi i UP-së në proceset zhvillimore evropiane dhe botërore të arsimit të lartë për zgjedhjen e problemeve të shoqërisë dhe në shërbim të ekonomisë;
- Rritja e mobilitetit të mësimdhënësve dhe të studentëve vendorë dhe të huaj;
- Rritja e numrit të bibliotekave me literature bashkëkohore.

Objektivi i katërt - Ngritja dhe zhvillimi i sistemit informativ do të arrihet:

- Transferimi i teknologjisë nga gjendja ekzistuese sipas universiteteve rajonale dhe botërore;
- Bashkëpunimi i rrjetëzimit të universiteteve të ndryshme me Universitetin e Prishtinës.

Tabela 1-Trendët historike të financimit

	2008	2009	2010 Rishikuar
Totali	12,246,258	12,100,763	15,160,776
Paga dhe Mëditje	7,373,262	8,092,083	9,990,024
Mallra dhe Shërbime	3,823,426	4,008,680	3,933,761
Shpenzimet Kapitale	1,049,570		1,236,991
Numri i stafit	1,932	1,992	2142

Tabela; 2 – Kufijtë e vlerësuar të shpenzimeve për KASH 2011-2013

	2010 Rishikuar	2011	2012	2013
Total	15,160,776	15,331,876	15,632,792	15,732,792
Paga dhe Mëditje	9,990,024	10,090,933	10,090,933	10,090,933
Mallra dhe Shërbime	3,933,761	3,999,461	4,041,859	4,041,859
Shpenzime Kapitale	1,236,991	1,241,482	1,500,000	1,600,000
Numri i stafit	2,142	2,142	2,142	2,142

Në tabela 2. shihet se shpenzimeve operative janë rritë për arsye të implementimit të vendimit të Qeveris për rritjen e pagave në UP dhe rritjes së numrit të studentëve dhe të rritjes së stafit mësimdhënës, ndërsa rritja e shpenzimeve kapitale për arsye se janë projekte që kanë filluar në vitin 2010 dhe vazhdojnë edhe në vitet në vijim (plotësimin e standarde për Licencimin e fakulteteve e cila është kushte pajisja me laborator dhe mjete konkretizimi, ngritja e infrastrukturës institucionale për punë shkencore.

Tabela; 3 – Projektet Kapitale në nivel të departamentit

Emri i programit	Projektet 2010 Rishikuar	Vlerësimet 2011	Vlerësimet 2012	Vlerësimet 2013
Totali	1,236,991	1,241,482	1,500,000	1,600,000
Administrata Qendrore e UP-së	1,236,991	1,241,482	1,500,000	1,600,000

Tabela; 4 – Nevojat për financim mbi kufirin buxhetor 2011-2013

	2011	2012	2013
Total	8,888,340	10,079,516	14,986,132
Paga dhe Mëditje	5,909,067	6,709,067	7,549,067
Mallra dhe Shërbime	1,220,755	1,610,449	1,997,065
Subvencione dhe Transfere	-	-	-
Shpenzime Kapitale	1,758,518	1,760,000	5,440,000
Numri i stafit	43	87	131

Kërkesa mbi kufirin e vlerësuar për shpenzimet shtesë është për:

- Plotësimin e kriterëve për akreditim të fakulteteve, (si janë laboratorët, mjetet e konkretizimit, stafi akademik etj).
- Ofrimi i fondeve për bursa për studentë,
- Ulja e kostos së shpenzimeve për studentë me asistencë sociale
- Krijimi i strukturave për vlerësimin e brendshëm, si dhe vlerësimin e jashtëm
- Rritja e hapësirës për përdorimin e teknologjisë bashkëkohore dhe pajisjeve laboratorike në studim.

AKADEMIA E SHKENCAVE DHE ARTEVE TË KOSOVËS

I. Misioni

Misioni dhe synimet kryesore të punës së Akademisë së Shkencave dhe Arteve të Kosovës për periudhën 2011-2013 janë: organizimi, zhvillimi, nxitja dhe bashkërenditja e veprimtarisë shkencore dhe e krijimtarisë artistike në seksione, në bërthama të studimit, në njësi shkencore dhe artistike dhe në qendra studimore dhe hulumtuese.

II. Gjendja aktuale

Akademia e Shkencave dhe e Arteve e Kosovës vazhdon të përballet me vështirësi të shumta, edhe për arsye të së kaluarës, kur ka qenë e kufizuar t'i ndërtojë kapacitetet e saja hulumtuese dhe artistike me interes të veçantë shoqëror. Ka pasur edhe probleme të infrastrukturës, sidomos duke filluar nga mungesa e theksuar e mjediseve të punës edhe nga mungesa e pajisjeve të domosdoshme për t'i realizuar detyrat e saj themelore. E gjithë kjo është reflektuar edhe në suksesin e punës së saj. Mirëpo, viteve të fundit Akademia ka hasur në mirëkuptim gjithnjë në rritje të Institucionet e Kosovës, të cilat kanë treguar mirëkuptim për përmirësimin e kushteve të punës, të cilat do t'i mundësonin asaj ta realizojë veprimtarinë e saj. Pritet së shpejti që Akademia ta vazhdojë veprimtarinë në godinën e re të pajisur me inventar dhe pajisje elektronike të nevojshme. Aktualisht Akademia ka të punësuar 41 punonjës dhe, në kushtet e reja, pritet t'i punësojë edhe katër të tjerë.

III. Objektivat strategjike

- i. Realizimin e projektit afatgjatë Enciklopedia Shqiptare (në bashkëpunim me Akademinë e Shkencave të Shqipërisë);
- ii. Veprimtaria afatgjate e Këshillit për Gjuhën Shqipe (në bashkëpunim me Akademinë e Shkencave të Shqipërisë);
- iii. Veprimtaria botuese e Akademisë (botimi i rezultateve të studimeve shkencore);
- iv. Realizimi i projektit për botimin e Monografisë Kosova, (projekt trevjeçar (2010-2013).

Tabela 1-Trendët historike të financimit

	2008	2009	2010 Rishikuar
Totali	418,001	462,536	485,560
Paga dhe Mëditje	226,151	259,513	263,987
Mallra dhe Shërbime	191,850	203,023	221,573
Numri i stafit	41	47	45

Tabela 2 - Vlerësimet për KASH-i 2011-2013

	2010 Rishikuar	2011	2012	2013
Total	485,560	495,061	496,537	496,537
Paga dhe Mëditje	263,987	268,214	268,214	268,214
Mallra dhe Shërbime	221,573	226,847	228,323	228,323
Numri i stafit	45	45	45	45

Tabela 3 – Nevojat për financim mbi kufirin buxhetor 2011-2013

	2011	2012	2013
Total	106,859	231,631	369,528
Paga dhe Mëditje	52,706	115,954	191,851
Mallra dhe Shërbime	54,153	115,677	177,677
Numri i stafit	2	5	10

Kërkesa mbi kufirin e vlerësuar për shpenzimet shtesë është për:

- Monografia “Kosova” do të jetë një tekst shkencor sa i përket të dhënave dhe fakteve,
- Përkthimi i Monografisë në gjuhët e huaja (anglisht, frëngjisht, gjermanisht)

KËSHILLI I KOSOVËS PËR TRASHËGIMI KULTURORE

I. Misioni

Misioni i përgjithshëm i Këshillit të Kosovës për Trashëgimi Kulturorë (KKTK) është ruajtja, vlerësimi dhe trajtimi i të gjitha llojeve të trashëgimisë kulturore në territorin e Republikës së Kosovës, përmes identifikimit, dokumentimit, studimit, vlerësimit, përzgjedhjes dhe cilësimit në mbrojtje të përhershme, konservimit, restaurimit, prezantimit, interpretimit dhe integritetit të saj në jetën bashkëkohore.

II. Gjendja aktuale

Aktivitetet aktuale të KKTK kanë të bëjnë me identifikimin e situatës së përgjithshme, konceptimin e programit për hartimin e politikave integruese nacionale si dhe Listën e trashëgimisë kulturore në mbrojtje të përhershme. Njëkohësisht angazhohet në konsolidimin dhe promovimin e institucionit në nivele vendore dhe ndërkombëtare.

Këshilli e zhvillon veprimtarinë në pajtim me infrastrukturën ligjore, standardet ndërkombëtare, administrimit dhe politikave integruese në bashkëpunim të ndërsjellë me të gjitha autoritetet dhe institucionet e qeverisjes, shoqërinë civile, donatorët, institucionet e planifikimit, ndërtimit, kadastrit, edukimit, trashëgimisë kulturore dhe ato ndërqeveritare e ndërkombëtare.

III. Objektivat strategjike

Me qëllim përmirësimi të situatës së rrezikshmërisë të trashëgimisë kulturore, synimet në realizimin e programit në planin afatmesëm janë:

- i. Krijimi i kushteve të favorshëm për studimin, prezantimin, koordinimin dhe zhvillimin e sektorit të trashëgimisë kulturore nëpërmjet funksionalizimit të sistemit ligjor dhe organizimit efikas të strukturës menaxhuese.
- ii. Ruajtja, vlerësimi dhe konservimi i trashëgimisë kulturore pa dallim përkatësie etnike, periudhe historike, gjendje fizike të saj apo besimi;
- iii. Sigurimi i mekanizmave dhe instrumenteve shtetërore në linjë integruese për: identifikim, dokumentim, vlerësim, cilësim, studim, ruajtje, mbrojtje,
- iv. Përcaktimi i detyrave, përgjegjësi dhe obligimeve të administratës shtetërore, pronareve/shfrytëzuesve, planerëve dhe financuesve.

Tabela 1; Trendët historike të financimit

	2008	2009	2010 Rishikuar
Totali		81,000	156,963
Paga dhe Mëditje		70,000	70,488
Mallra dhe Shërbime		7000	86,745
Shpenzimet Kapitale		4000	
Numri i stafit		16	16

Në pajtim me Ligjin për Trashëgiminë Kulturore, Nr. 02/L-88 (2006) Neni 4.8. Këshilli i Kosovës për Trashëgimi Kulturore është krijuar me vendim të Kuvendit të Republikës së Kosovës nr. 02-3865-1/07 në viti 2009.

Tabela 2 - Vlerësimet për KASH-i 2011-2013

	2010 Rishikuar	2011	2012	2013
Total	156,963	142,377	142,800	142,800
Paga dhe Mëditje	70,488	71,800	71,800	71,800
Mallra dhe Shërbime	86,745	70,577	71,000	71,000
Numri i stafit	16	16	16	16

Tabela 3 – Nevojat për financim mbi kufirin buxhetor 2011-2013

	2011	2012	2013
Total	989,423	969,000	979,000
Paga dhe Mëditje	130,000	130,000	130,000
Mallra dhe Shërbime	49,423	49,000	59,000
Subvencione dhe Transfere	750,000	750,000	750,000
Shpenzime Kapitale	60,000	40,000	40,000
Numri i stafit	6	6	6

Kërkesa për buxhet shtese shihet që kemi për rritje të shpenzimeve në vitet në vijim ku shpenzimet operative kanë të bëjnë kryesisht me mbulimin e shpenzimeve për rritjen e numrit të punëtoreve, ndërsa sa i përket shpenzimeve kapitale janë disa projekte të vogla kapitale.

SEKTORI I RENDIT DHE SIGURISË PUBLIKE

Të sigurojë një sistem gjyqësor dhe prokurorial të pavarur dhe të paanshëm, interpretim të Kushtetutës dhe përputhshmërisë së ligjeve me Kushtetutën, rend dhe sundim të ligjit ku të gjithë qytetarët do të ndihen të sigurt dhe do të trajtohen në mënyrë të barabartë. Siguria e të drejtave pronësore si dhe siguria nga krimet, korrupsioni, janë shumë të rëndësishme dhe esenciale për tërheqjen e investimeve, dhe si rezultat, edhe zhvillimin ekonomik.

I. Gjendja aktuale


Sektori i Rendit dhe Sigurisë Publike merr pjese ne Buxhetin e Kosovës me 152.06€milion euro apo 16.17% te fondeve nga buxheti i përgjithshëm i nivelit qendror.

Ministritë, gjegjësisht organizatat buxhetore që përbëjnë sektorin e Rendit dhe Sigurisë Publike janë: Ministria e Drejtësisë, Gjykata Kushtetuese e Kosovës, Ministria e Forcës së Sigurisë së Kosovës, Ministria e Punëve të Brendshme, Këshilli Gjyqësor i Kosovës, Instituti Gjyqësor i Kosovës, dhe Komisioni për Ndhimë Juridike.

Është me rëndësi të ceket që gjatë vitit të kaluar në këtë sektor kanë përfunduar një numër i konsiderueshëm i projekteve, sikurse që janë: Ndërtimi i burgut për dëshmitar të dënuar të mbrojtur në Dubravë, ndërtesa e Prokurorisë së Qarkut dhe Komunale dhe Zyra Regjionale për Mbrojtje të Viktimave në Prizren dhe përfundimi i objektit të Ministrisë së Punëve të Brendshme në Prishtinë. Janë disa ligje shumë të rëndësishme në fushë të drejtësisë që janë në procedurë të aprovimit dhe të cilat do të kontribuojnë në zhvillimin e reformave në këtë sektor. Instituti Gjyqësor i Kosovës vazhdon me sukses trajnimin dhe aftësimin profesional për të gjithë gjyqtarët dhe prokurorët gjyqësor të Kosovës, ndërsa Komisioni për Ndhimë Juridike përkujdeset për sigurimin e ndihmës juridike falas në veçanti për grupe të cënueshme të qytetarëve duke synuar që të ngrit nivelin e cilësisë së shërbimeve të ndihmës juridike.

Ministria e Punëve të Brendshme është në proces të ristrukturimit dhe konsolidimit të menaxhimit të emergjencave, ku të gjitha njësitë rajonale dhe komunale të emergjencave janë sistemuar në MPB. Në këtë drejtim ministria është fokusuar në qartësimin e funksioneve të planifikimit qendror, monitorimit, koordinimit dhe funksioneve operative të agjencive ekzekutive.

Në fushën e sigurisë, Ministria e FSK-së është duke u ndërtuar sipas modeleve të disa shteteve të NATO-së, kurse personeli brenda MFSK është duke zhvilluar politika, plane, programe dhe vlerësime të nivelit të lartë që do ta caktojnë drejtimin e FSK-së, dhe do të caktojnë resurset për zhvillimin e forcës. Konsolidimi sa më i shpejtë i njërive me qëllim të zotërimit të kapaciteteve operationale reaguese për gjithë spektrin e misioneve të ngarkuara, kërkon një orientim më të avancuar drejt një force profesioniste.



II. Planet e ardhshme

Për periudhën e ardhshme, ky sektor planifikon krijimin e kornizës ligjore dhe administrative për organizimin dhe funksionimin e gjykatave, prokurorive, zgjidhjen e një numri mjaft të madh të lëndëve të pazgjidhura. Sigurimi i hapësirave të mjaftueshme për të burgosurit gjithashtu paraqet një sfidë të veçantë, për këtë arsye parashihet vazhdimi i projekteve të rëndësishme siç është Ndërtimit të Burgut të Sigurisë së lartë dhe fillimi i ndërtimit të Pallatit të Drejtësisë (këto projekte janë bashkëfinancim me Zyrën Ndërlidhëse të Komisionit Evropian), kurse për sektorin e rendit çështje me rëndësi mbetet furnizimi me Pasaporta Biometrik, menaxhimi i koordinuar i kufijve, luftimi i trafikimit të narkotikëve.

*Përmbledhje e vlerësimeve në nivel sektori

	2010 Rishikuar	2011	2012	2013
Paga dhe Mëditje	72,699,017	78,769,324	78,769,324	78,769,324
Mallrat dhe Shërbimet	41,281,022	42,927,416	43,106,506	43,103,952
Subvencionet dhe Transferet	197,000	2,147,000	2,147,000	2,147,000
Shpenzimet Kapitale	37,884,173	39,139,269	39,768,806	39,061,900
Numri i stafit	17,587	17,643	17,643	17,643
Totali	152,061,212	162,983,009	163,791,636	163,082,176

* Agjensionet e pavaruara në tabelën përmbledhëse sektoriale janë të përfshira sipas rekomandimeve për financim

Përmbledhje e projekteve kapitale ne nivel të OB-së

	2010 Rishikuar	2011	2012	2013
Ministria e Drejtësisë	4,545,154	4,491,572	4,916,832	4,902,500
Gjykata Kushtetuese e Kosovës	372,696	200,000	330,000	130,000
Këshilli Gjyqësor i Kosovës	2,272,234	2,280,485	1,988,900	1,148,900
Komisioni për Ndihmë Juridike	30,000	0	0	0
Ministria e Punëve të Brendshme	18,431,454	18,966,079	19,300,000	19,500,000
Ministria e FSK-së	12,232,635	13,201,133	13,233,074	13,380,500
Totali	37,884,173	39,139,269	39,768,806	39,061,900

Projektet kontingjente në burimet shtesë ne nivel sektori

	2011	2012	2013
Shpenzimet operative	22,284,329	25,367,595	27,378,583
Shpenzimet kapitale	42,147,444	30,790,168	22,030,000
Totali	64,431,773	56,157,763	49,408,583

Për periudhën 2011-2013 kërkesat shtesë për financim ka të bëjë si në kategorinë e shpenzimeve operative ashtu edhe ato kapitale.

Te shpenzimet operative kjo rritje e kërkesës ka të bëjë me implementimin e plotë të Ligjit të Policisë si dhe sigurimit shëndetësor (Policia e Kosovës), pastaj shpenzime të trajnimit dhe të përgatitjes të strukturave të FSK për pjesëmarrje në strukturat e NATO dhe ato Evropiane, kurse tek investimet kapitale kjo kërkesë ka të bëjë me një mori të projekteve të cilat për mungesë të fondeve nuk kanë mundur të financohen nga organizatat buxhetore sikurse që janë: ndërtimi i qendrave të ndryshme të paraburgimit, objekteve për Prokuroritë Publike dhe të Qarkut, pajisje të sigurisë dhe video vëzhgim, blerja e autobлиндave, rrjeti strategjik i komunikimit, zyra dhe garazhe për komponentët rezervë nëpër qendra të ndryshme, ndërtimi i palestrave sportive etj.).

MINISTRIA E DREJTËSISË

I. Misioni

Ministria e Drejtësisë* synon të bëhet mekanizëm qendror për promovimin dhe përforcimin e një sistemi efektiv, transparent dhe të unifikuar të Drejtësisë në Kosovë, luftimin e krimit të organizuar, korrupsionit, trafikimit me qenie njerëzore dhe krimeve të rënda ekonomike si dhe krijimi dhe zhvillimi i një sistemi efikas dhe të pavarur të drejtësisë në Kosovë, i cili garanton sundimin e ligjit, mbrojtje të drejtave lirive dhe pasurisë së qytetarëve, qasje të lehtë dhe të barabartë në drejtësi për të gjithë qytetarët, dhe të cilin janë të mishëruara standardet dhe praktikat më të përparuara ndërkombëtare.

II. Gjendja aktuale

Ministria e Drejtësisë është formuar në vitin 2005 por ka filluar punën në mars të vitit 2006, me përgjegjësi të kufizuara, pasi që një pjesë e përgjegjësive ishin të rezervuara dhe menaxhoheshin nga Departamenti i Drejtësisë.

Në vitin 2009 Ministria e Drejtësisë ka përfunduar disa projekte mjaft të rëndësishme sikurse që është Burgu për dëshmitar të dënuar të mbrojtur në Dubravë, objekti i Prokurorisë dhe Zyra regjionale për mbrojtje të viktimave në Prizren, kurse për Ndërtimin e Burgut të Sigurisë së lartë Ministria e Drejtësisë së bashku me Zyrën Ndërlidhëse të Komisionit Evropian vazhdojnë të impementojnë këtë projekt.

Me procesin e Rishikimit të vitit 2010 përfundimisht edhe dy programe që kanë qenë në kuadër të Departamentit të Drejtësisë (Gjyqtarët special dhe Prokurorët special) janë përfshirë në kuadër të Ministrisë së Drejtësisë kurse si program i ri është themeluar edhe Agjencioni për Menagjimin e Pasurisë së Sekuestruar apo të konfiskuar.

Edhe pas shpalljes së pavarësisë dhe hyrjes në fuqi të Kushtetutës së Republikës së Kosovës kanë mbetur disa përgjegjësi që i përkasin dhe menaxhon EULEX.

Aktualisht në kuadër të programeve Gjyqtarët special dhe Prokurorët special stafi i punësuar është në përbërje nga strukturat e Eulex-it dhe atij vendor dhe mungesa e hapësirave për punë që ka qenë problem i vazhdueshëm për këtë departament përfundimisht është zgjidhur me rindërtimi e ndërtesës së Zyrës së Prokurorëve special.

III. Objektivat Strategjike

- i. Draftimi i ligjeve dhe adaptimi i atyre aktuale sipas standardeve evropiane në të gjitha fushat, veçanërisht harmonizimi me Kushtetutën e Republikës së Kosovës.
- ii. Krijimi i mundësive ligjore dhe kushteve për funksionimin e sistemit të pavarur Prokurorial dhe Gjyqësor, shtimi i efikasitetit të gjetjes dhe identifikimit të personave të zhdukur gjatë luftës.

- Për shkak të kalimit të Departamentit të Drejtësisë në kuadër të Ministrisë së Drejtësisë të gjitha të dhënat janë bartur në Ministrinë e Drejtësisë.

- iii. Ndërtimi i Pallatit të Drejtësisë. Ky projekt do të jetë bashkëfinansim me Zyrën Ndërlidhëse të Komisionit Evropian, dhe kostoja e përgjithshme do të jetë 33

milion €ku Komisioni Evropian do të ndajë 25 milion €kurse Qeveria e Kosovës 8 milion € (në vitin 2010 Ministria e Administrimit Publik do të ndajë 0.3 milion € në vitin 2011 Ministria e Administrimit Publik ndan 2.7 milion €kurse Ministria e Drejtësisë 1 milion euro dhe në vitin 2012 Ministria e Administrimit Publik do të ndajë 3 milion €kurse Ministria e Drejtësisë 1 milion €).

Në këtë institucion do të akomodoheshin institucionet që i përkasin sektorit të Drejtësisë.

- iv. Parandalimi i trafikimit me qenie njerëzore dhe krijimi i kushteve për strehim të sigurt të viktimave të trafikimit dhe risocializimi i tyre.
- v. Krijimi i kushteve dhe të objekteve sipas standardeve evropiane për të dënuar dëshmitar të mbrojtur dhe burgje të sigurisë së lartë për të dënuar të rrezikshëm dhe të dënuar të retarduar mentalisht .
- vi. Rritja dhe avancimi më i madh i shërbimit me dënime alternative dhe lirimit me kusht të dënuarve që do zvogëloj nevojën për rritjen e hapësirave për shtëpi korrektuese dhe do të zvogëloj koston e kërkesave dhe nevojave të Shërbimit korrektues për mbajtjen e të dënuarve në shtëpi korrektuese që do të ketë ndikim të drejtpërdrejtë në kursimin e buxhetit të Kosovës.

Tabela 1; Trendët historike të financimit

	2008	2009	2010 Rishikuar
Total	18,756,959	20,113,765	22,940,348
Paga dhe Mëditje	6,927,557	7,210,522	10,189,136
Mallra dhe Shërbime	8,422,925	8,239,175	8,136,058
Subvencione dhe Transfere	20,000	20,000	70,000
Shpenzimet Kapitale	3,386,477	4,644,068	4,545,154
Numri i stafit	2,310	2,430	2,568

Tabela 2; Kufijtë e vlerësuar të shpenzimeve 2011-2013

	2010 Rishikuar	2011	2012	2013
Total	22,940,348	28,669,825	29,166,955	29,152,623
Paga dhe Mëditje	10,189,136	13,218,925	13,218,925	13,218,925
Mallra dhe Shërbime	8,136,058	8,939,328	9,011,198	9,011,198
Subvencione dhe Transfere	70,000	2,020,000	2,020,000	2,020,000
Shpenzimet Kapitale	4,545,154	4,491,572	4,916,832	4,902,500
Numri i stafit	2,568	2,624	2,624	2,624

Në kufijtë e vlerësuar për vitin 2011-2013 ndër të tjera është përfshirë:

- a) Rritja e pagave për punëtorët shëndetësorë dhe stafin e uniformuar të shërbimit korrektues (Vendimi i Qeverisë nr.07/ 113 të dt.08.03.2010)
- b) Rritja e numrit të punëtorëve dhe masës monetare për Burgun për Dëshmitarë të dënuar të mbrojtur në Dubravë,
- c) Implementimi i ligjit mbi themelimin e Këshillit Prokurorial të Kosovës
- d) Implementimi i ligjit mbi themelimin Prokurorisë së shtetit
- e) Implementimi i ligjit mbi themelimin Agjencionit për Menagjimin e Pasurisë së Sekuestruar dhe konfiskuar,

Tabela 3; Projektet kapitale në nivel të programeve

Emri i programit	Projektet 2010 Rishikuar	Vlerësimet 2011	Vlerësimet 2012	Vlerësimet 2013
Total	4,545,154	4,491,572	4,916,832	4,902,500
Administrata Qendrore	526,165	1,150,000	1,539,072	250,000
Prokuroritë dhe Administrata	330,127	482,772	1,717,228	950,000
Shërbimi Korrektues- Burgjet	3,396,315	2,820,800	1,366,532	3,702,500
Zyra për persona të zhdukur dhe mjekësi ligjore	171,647		266,000	
Prokurorët special	120,900	38,000	28,000	

Tabela 4; Nevojat për financim mbi kufirin buxhetor 2011-2013

	2011	2012	2013
Total	12,190,228	7,607,668	507,500
Shpenzimet operative			
Shpenzimet kapitale	12,190,228	7,607,668	507,500

Kërkesa shtesë për financim ka të bëjë kryesisht për investime kapitale sikurse që janë ndërtimi i qendrave të ndryshme të paraburgimit, ndërtimi i disa objekteve për Prokuroritë Publike dhe të Qarkut, sigurimi dhe integrimi i databazave për Ministrinë e Drejtësisë etj.

GJYKATA KUSHTETUESE E KOSOVËS

I. Misioni

Gjykata Kushtetuese është autoriteti përfundimtar në Republikën e Kosovës për interpretimin e Kushtetutës dhe përputhshmërisë së ligjeve me Kushtetutën.

II. Gjendja aktuale

Gjykata Kushtetuese si datë të fillimit të punës konsideron datën 15 maj 2009, përkatësisht ditën e votimit në Kuvendin e Kosovës të gjyqtarëve të Gjykatës Kushtetuese. Si e tillë, është në proces të konsolidimit të brendshëm dhe aktualisht ka të punësuar punonjës vendorë dhe ndërkombëtarë, dhe së shpejti pritet punësimi i punonjësve të tjerë.

III. Objektivat Strategjike

- i. Të vendosë për raste të ngritura para Gjykatës për çështjen e përputhshmërisë së ligjeve, të dekreteve të Presidentit e të Kryeministrit dhe të rregulloreve të Qeverisë, me Kushtetutën;
- ii. Të vendosë për rastet e ngritura para Gjykatës për çështjen e përputhshmërisë së Statutit të Komunës me Kushtetutën;
- iii. Të vendosë për rastet e ngritura para Gjykatës për çështjen e përputhshmërisë së referendumit të propozuar me Kushtetutën;
- iv. Të vendosë për rastet e ngritura para Gjykatës për çështjen e përputhshmërisë së një amendamenti të propozuar kushtetues me marrëveshjet e detyrueshme ndërkombëtare, të ratifikuar sipas kësaj kushtetute dhe rishikimin e kushtetutshmërisë së procedurës së ndjekur;
- v. Të vendosë për rastet e ngritura para Gjykatës për çështjen nëse është shkelur Kushtetuta gjatë zgjedhjes së Kuvendit;

Tabela 1; Trendët historike të financimit

	2008	2009	2010 Rishikuar
Totali		1,100,000	1,366,050
Paga dhe Mëditje		520,000	448,884
Mallra dhe Shërbime		397,000	544,470
Shpenzimet Kapitale		183,000	372,696
Numri i stafit		45	55

Tabela 2; Kërkesa për financim në KASH 2011-2013

	2010 Rishikuar	2011	2012	2013
Total	1,366,050	1,903,984	1,666,084	1,521,084
Paga dhe Mëditje	448,884	559,084	559,084	559,084
Mallra dhe Shërbime	544,470	759,900	777,000	832,000
Shpenzimet Kapitale	372,696	585,000	330,000	130,000
Numri i stafit	55	64	64	70

Tabela 3; Projektet kapitale në nivel të Departamentit

Emri i programit	Projektet 2010 Rishikuar	Vlerësimet 2011	Vlerësimet 2012	Vlerësimet 2013
Total	372,696	200,000	330,000	130,000
Gjykata Kushtetuese e Kosovës	372,696	200,000	330,000	130,000

Tabela 4; Rekomandimi për financim në KASH

	2010 Rishikuar	2011	2012	2013
Total	1,366,050	1,336,590	1,469,144	1,266,590
Paga dhe Mëditje	448,884	529,288	529,288	529,288
Mallra dhe Shërbime	544,470	607,302	609,856	607,302
Shpenzimet Kapitale	372,696	200,000	330,000	130,000
Numri i stafit	55	55	55	55

Në kufijtë e vlerësuar për vitet 2011-2013, pothuajse tërësisht është përfshirë kërkesa e GJKK në kategorinë e Shpenzimeve Operative, kurse sa i përket Shpenzimeve kapitale, kërkesa është përfshirë pjesërisht dhe atë kryesisht për projektet që janë të rëndësishme më të lartë.

KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS

I. Misioni

Misioni i Këshillit Gjyqësor të Kosovës (KGJK) është zhvillimi dhe mbarëvajtja e një sistemi të pavarur gjyqësor i cili do të ofron shërbime të paanshme të gjithë qytetarëve dhe i cili i do të jetë funksional në të gjitha aspektet e organizimit dhe funksionimit të tij.

Një sistem gjyqësor të Kosovës i cili do të jetë i pavarur, me qasje për të gjithë, i drejtë, efikas dhe i përgjegjshëm në punën e tij dhe i cili do të funksionoi sipas standardeve më të larta të ndershmërisë, integritetit, profesionalizmit dhe transparencës.

II. Gjendja aktuale

Me hyrjen në fuqi të Kushtetutës së Republikës së Kosovës në kapitullin e VII përkatësisht neni 102 deri në nenin 108 të këtij kapitulli janë përcaktuar kompetencat, përgjegjësit dhe funksionet e Sistemit Gjyqësor të Kosovës.

Aktualisht në Sistemin Gjyqësor të Kosovës ka filluar procesi i emërimit të gjyqtarëve dhe prokurorëve nga Komisioni i Pavarur Gjyqësor dhe Prokurorial dhe Këshilli Gjyqësor i Kosovës si dhe aprovimi nga qeveria i Ligjit për Gjykata, hartimi i projektligjeve për Këshillin Gjyqësor të Kosovës, Këshillin Prokurorial dhe Prokurorinë e Shtetit të cilët do të mundësojnë organizimin dhe strukturimin e gjykatave dhe prokurorive në Republikën e Kosovës.

Gjatë periudhës 2008-2009 Këshilli Gjyqësor i Kosovës së bashku me Kuvendin Komunal të Klinës kanë marrë pjesë në financimin e ndërtesës të Gjykatës Komunale në Klinë, kurse brenda vitit 2010 KGJK parashih fillimin e punimeve në ndërtimin e objektit të Gjykatave Komunale dhe Kundërvajtje në Gjilan dhe Prizren.

III. Objektivat Strategjike

- i. Krijimi i kornizës së fuqishme ligjore dhe administrative për organizimin dhe funksionimin e gjykatave.
- ii. Zhvillimi dhe zbatimi i procedurave efektive për emërimin, zhvillimin, promovimin dhe disiplinën e gjyqtarëve.
- iii. Krijimi i procedurave dhe praktikave efektive për menaxhimin e buxhetit dhe financave në dhe për gjykata.
- iv. Krijimi i një strukture përkatëse organizative si dhe të një numri të politikave dhe procedurave efektive për menaxhimin e burimeve njerëzore që është e rëndësishme për funksionimin e gjykatave.
- v. Eliminimi i lëndëve të pazgjidhura dhe zgjidhja me kohë e të gjitha lëndëve të evidentuara nëpër gjykata.
- vi. Përforcimi i kapacitetit për kërkime, analiza dhe raportim statistikor në lidhje me punët e gjykatave.
- vii. Krijimi i politikave dhe procedurave për të siguruar që gjyqtarët e Kosovës dhe kadri jo-gjyqësor t'i marrin trajnimet e nevojshme për funksionim të efektshëm.

Tabela 1. Trendët historike të financimit

	2008	2009	2010 Rishikuar
Total	11,564,743	13,270,274	14,312,003
Paga dhe Mëditje	5,578,777	6,062,682	7,163,042
Mallra dhe Shërbime	4,399,807	4,897,592	4,876,727
Shpenzimet Kapitale	1,586,159	2,310,000	2,272,234
Numri i stafit	1,824	1,829	1,929

Tabela 2. Kufijtë e vlerësuar të shpenzimeve 2011-2013

	2010 Rishikuar	2011	2012	2013
Total	14,312,003	16,531,743	16,281,515	15,441,515
Paga dhe Mëditje	7,163,042	9,211,071	9,211,071	9,211,071
Mallra dhe Shërbime	4,876,727	5,040,187	5,081,544	5,081,544
Shpenzimet Kapitale	2,272,234	2,280,485	1,988,900	1,148,900
Numri i stafit	1,929	1,929	1,929	1,929

Në kufijtë e vlerësuar për periudhën 2011-2013 parashihet që të ndahen mjete për:

- a) Implementimin e Ligjit mbi Gjykatat dhe
- b) Implementimin e ligjit mbi Këshillin Gjyqësor të Kosovës
- c) Kurse sa i përket shpenzimeve kapitale parashihen të jenë afërsisht të njëjta me buxhetin e aprovuar të vitit 2010. Nga investimet kapitale që Këshilli Gjyqësor pritet të financojë për këtë periudhë është vazhdimi i projektit të ndërtimit të objektit të Gjykatave në Gjilan, ndërtimi i Gjykatës Themelore në Malishevë, zgjidhja e lëndëve të pazgjidhura etj.

Tabela 3. Projektet kapitale në nivel të Departamentit

Emri i programit	Projektet 2010 Rishikuar	Vlerësimet 2011	Vlerësimet 2012	Vlerësimet 2013
Total	2,291,945	2,280,485	1,988,900	1,148,900
Gjykatat dhe Sekretariati	2,291,945	2,280,485	1,988,900	1,148,900

Tabela 4. Nevojat për financim mbi kufirin buxhetor 2011-2013

	2011	2012	2013
Total	484,015		
Shpenzimet operative			
Shpenzimet kapitale	484,015		

Kërkesat shtesë për financim kryesisht kanë të bëjnë me rritjen e kërkesës në kategorinë e shpenzimeve operative dhe atë për shkak të strukturës së re në sistemin gjyqësor të Kosovës e në veçanti të gjykatave, kurse kërkesa shtesë për investime kapitale ka të bëjë me disa projekte siç janë: Pajisje të sigurisë dhe video vëzhgim, projekte të audio incizimit etj.

INSTITUTI GJYQËSOR I KOSOVËS

I. Misioni

Misioni i Institutit Gjyqësor të Kosovës (IGJK) është trajnimi dhe aftësimin profesional për të gjithë gjyqtarët dhe prokurorët gjyqësorit të Kosovës, dhe përgatitja profesionale e kandidateve gjyqtarë dhe prokurorë të ardhshëm për sistemin gjyqësor të Kosovës.

II. Gjendja aktuale

Ligji mbi Themelimin e Institutit Gjyqësor të Kosovës, themelon IGJK-në si institucion të pavarur profesional dhe kryesor për aftësim profesional të kandidatëve dhe ushtruesve të funksionit të gjyqtarit dhe prokurorit brenda sistemit gjyqësor të Kosovës. Instituti Gjyqësor i Kosovës është përgjegjës për aftësimin e bartësve dhe bartësve potencial të funksionit në gjyqësi (gjyqtarëve dhe prokurorëve), vlerësimin dhe organizimi e provimit përgatitor për gjyqtarë dhe prokurorë

III. Objektivat Strategjike

- i. Vazhdimin e organizmit të Provimit Përgatitor/Hyrës.
- ii. Vazhdimin e zbatimit të Programit Fillestar për Arsimim Ligjor
- iii. Vazhdimin e zbatimit të Programit të Vazhdueshëm për Arsimim Ligjor
- iv. Zbatimin e Programit Trajnues për Gjyqtar Porotë i cili iu dedikohet të gjithë gjyqtarëve të porotë cilët shërbejnë në kuadër të sistemit gjyqësor të Kosovës
- v. Zbatimi i Programit për Trajnimin e Stafit të Gjykatave

Tabela 1; Trendët historike të financimit

	2008	2009	2010 Rishikuar
Total	341,468	612,425	577,091
Paga dhe Mëditje	69,066	88,423	118,623
Mallra dhe Shërbime	243,902	484,002	442,068
Kapitale	28,500	40,000	16,400
Numri i stafit	17	21	21

Tabela 2: Kërkesa për financim në KASH 2011- 2013

	2010 Rishikuar	2011	2012	2013
Total	577,091	975,105	1,101,288	1,174,522
Paga dhe Mëditje	118,623	143,705	167,388	188,122
Mallra dhe Shërbime	442,068	566,400	616,400	666,400
Shpenzimet Kapitale	16,400	265,000	317,500	320,000
Numri i stafit	21	29	33	37

Nga tabela e mësipërme vërehet që kufijtë e vlerësuar për periudhën 2011-2013 janë afërsisht të njëjtë me buxhetin e aprovuar të vitit 2010.

Tabela 3; Rekomandimet për financim për KASH-in 2011-2013

	2010 Rishikuar	2011	2012	2013
Total	577,091	592,176	593,936	593,936
Paga dhe Mëditje	118,623	121,023	121,023	121,023
Mallra dhe Shërbime	458,468	471,153	472,913	472,913
Numri i stafit	21	21	21	21

Kërkesat shtesë për financim kryesisht kanë të bëjnë me rritjen e numrit të punëtorëve, vazhdimin e trajnimeve kurse si projekt kapital kanë paraparë ndërtimin e ndërtesës për IGJK, blerja e veturave etj.

KOMISIONI PËR NDIHMË JURIDIKE

I. Misioni

Misioni i Komisionit për Ndhmë Juridike është ofrimi i ndihmës juridike për një numër të konsiderueshëm të qytetarëve të Republikës së Kosovës, të cilët për shkak të mungesës së mjete materiale nuk mund të kenë qasje të barabartë në drejtësi.

II. Gjendja aktuale

Ndihma juridike në Republikën e Kosovës funksionon nëpërmjet tri institucioneve të saj:

- Komisionit për ndihmë juridike
- Zyra Qendrore Koordinuese e Ndhmës Juridike dhe
- Byrotë e qarkut për ndihmë juridike në: Prishtinë, Prizren, Pejë, Mitrovicë dhe Gjilan

KNJ përkujdeset që në emër të drejtësisë, të siguroj ndihmë juridike falas dhe të krijoj vetëdije të mbrojtjes së interesave, sidomos grupeve të cënueshme (fëmijëve, pakicave, viktimave të dhunës familjare, të moshuarave, personave me aftësi të kufizuara, të zhvendosurave etj)

KNJ në drejtim të përmbushjes së misionit, bashkëpunon ngushtë me siguruesit e jashtëm, avokatët dhe OJQ-të, si komponent pandarës në sistemin gjithëpërfshirës dhe integrues të ndihmës juridike

III. Objektivat Strategjike

Komisioni i Ndhmës Juridike do të përqendrohet në realizimin e shërbimeve sa më cilësore të ndihmës juridike, në mënyrë që çdo vit, t'ju sigurojë ndihmën e duhur juridike të qytetarëve me gjendje të vështirë ekonomike.

Hapja e zyrave të reja neper komunat e Kosovës, me qëllim të ngritjes së numrit të përfituesve të ndihmës juridike falas.

Tabela 1; Trendët historike të financimit

	2008	2009	2010 Rishikuar
Total	275,672	260,172	296,427
Paga dhe Mëditje	59,560	59,560	99,385
Mallra dhe Shërbime	216,112	200,612	167,042
Shpenzimet Kapitale			30,000
Numri i stafit	21	21	21

Tabela 2: Kërkesa për financim në KASH 2011- 2013

	2010 Rishikuar	2011	2012	2013
Total	296,427	352,500	345,500	427,000
Paga dhe Mëditje	99,385	120,000	120,000	140,000
Mallra dhe Shërbime	167,042	197,500	225,500	257,000
Shpenzimet Kapitale	30,000	35,000		30,000
Numri i stafit	21	25	27	30

Nga tabela e mësipërme vërehet që kufijtë e vlerësuar për periudhën 2011-2013 janë afërsisht të njëjtë me buxhetin e aprovuar të vitit 2010.

Tabela 3; Rekomandimet për financim për KASH-in 2011-2013

	2010 Rishikuar	2011	2012	2013
Total	296,427	272,876	273,876	273,876
Paga dhe Mëditje	99,385	101,785	101,785	101,785
Mallra dhe Shërbime	167,042	171,291	172,091	172,091
Shpenzimet Kapitale	30,000	0	0	0
Numri i stafit	21	21	21	21

Kërkesa shtesë për financim ka të bëjë kryesisht me rritjen e numrit të stafit si dhe me këtë edhe rritjen e kërkesës në shpenzime operative kurse në kategorinë e Investimeve kapitale ka të bëjë kryesisht me kërkesën për blerje të veturave.

MINISTRIA E PUNËVE TË BRENDSHME

I. Misioni

Misioni i Ministrisë së Punëve të Brendshme (MPB) është ndërtimi, ruajtja dhe ngritja e sigurisë për të gjithë qytetarët, mbikëqyrja dhe siguri i sundimit të ligjit, mbrojtja e jetës, pasurisë dhe lirisë së lëvizjes për të gjithë qytetarët. MPB-ja, mbështetur në vlerat profesionale dhe humane, ofron qasje moderne, profesionalizëm, transparencë, respektim të drejtave të njeriut, duke ofruar mundësi të barabarta për të gjithë qytetarët e Republikës së Kosovës.

II. Gjendja aktuale

Ministria e Punëve të Brendshme është në proces të ristrukturimit dhe konsolidimit, duke i zgjeruar funksionet themelore në sektorin e sundimit të rendit dhe sigurisë publike të shoqërisë kosovare, kurse për rritjen e gatishmërisë së menaxhimit të emergjencave, të gjitha njësitë rajonale dhe komunale të emergjencave janë sistemuar në MPB.

Gjatë periudhës së kaluar Ministria e Punëve të Brendshme ka përfunduar ndërtimin e objektit të MPB në Prishtinë, ka bërë ndërtimet dhe renovimet e stacioneve policore nëpër qendra të ndryshme të Kosovës, ka vazhduar me trajnimin e stafit të sigurisë për zhvillimin e aftësive dhe shkathhtësive teknike të stafit lokal për të ruajtur rendin publik dhe për të siguruar shërbime të nevojshme.

Më qellim të ngritjes së aftësive profesionale dhe strategjike të MPB-së, Ministria është fokusuar në qartësimin e funksioneve të planifikimit qendror, monitorimit, koordinimit dhe funksioneve operative të agjencive ekzekutive.

III. Objektivat Strategjike

- i. Implementimin e ligjit, më qëllim të luftimit dhe parandalimit të krimit, për të siguruar jetën dhe pronën e qytetarëve.
 - ii. Mbikëqyrja, kontrolli dhe menaxhimi i kufijve;
 - iii. Menaxhimi i situatave emergjente;
 - iv. Ngritja e cilësisë së shërbimeve ndaj qytetarëve.
-
- i. **i. Implementimi i ligjeve, më qëllim të luftimit dhe parandalimit të krimit, për të siguruar jetën dhe pronën e qytetarëve.**
 - a) Vëzhgimi dhe hetimi i veprave të rënda kriminale dhe qasje në luftimin e krimeve në teknologjinë informative;
 - b) Mundësia e përdorimit të metodave për vëzhgim gjatë hetimeve, me qëllim të marrjes së provave për ndjekje penale,
 - c) Mundësia e parandalimit dhe luftimi i veprimtarive kriminale në teknologjinë informative.
 - d) Përmirësimi i kapacitete njerëzore, posaçërisht në sektorin e luftimit të pastrimit të parasë, hetimit të narkotikeve dhe aftësia për luftimin e korrupsionit, krimit të organizuar dhe terrorizmit.

- e) Shtrirja e sistemit të inteligjencës në të gjitha nivelet, rritja e kapaciteteve të nevojshme për përgjim ligjor të telekomunikimeve;
- f) Sigurimi i personaliteteve dhe objekteve.

ii. Mbikëqyrja, kontrolli dhe menaxhimi i kufijve.

- a) Kufij të hapur për lëvizje të lirë të njerëzve dhe mallrave.
- b) Luftimi dhe parandalimi i aktiviteteve kriminale ndërkufitare;
- c) Kontrolli i vijës kufitare.
- d) Kontrolli i lëvizjes dhe qëndrimit të huajve.

iii. Parandalimi, reagimi në kohë dhe rimëkëmbja nga fatkeqësitë dhe katastrofat natyrore.

- a) Ngritja e aftësisë vepruese dhe kompletimi i sistemit të emergjencave më infrastrukturë dhe pajisje të nevojshme, për parandalimin dhe menaxhimin e krizave.
- b) Menaxhimi i situatave të prishjes së rendit dhe trazirave publike.

iv. Ngritja e cilësisë së shërbimeve ndaj qytetarëve dhe kapaciteteve për edukim dhe trajnime.

- a) Pajisja e qytetarëve me dokumente personale të cilësisë së lartë të sigurisë, sipas standardeve të BE-së, duke siguruar pasaporta biometrike.
- b) Infrastruktura e nevojshme komunikuese-informative, përmirësimi i kushteve dhe sigurisë në punë, si dhe hapësirës për punë.
- c) Ngritja e kapaciteteve për certifikim në edukimin e lartë, në fushën e sigurisë publike.
- d) Implementimi i proceseve të edukimit dhe trajnimeve të planifikuara, për njësit e specializuar për luftimin e krimit

Tabela 1; Trendët historike të financimit

	2008	2009	2010 Rishikuar
Total	74,444,773	70,134,381	81,470,285
Paga dhe Mëditje	30,729,278	32,060,836	43,766,924
Mallra dhe Shërbime	20,108,722	17,756,545	19,144,907
Subvencione dhe Transfere	127,000	127,000	127,000
Shpenzimet Kapitale	23,479,773	20,190,000	18,431,454
Numri i stafit	10,138	10,156	10,169

Tabela 2; Kufijtë e vlerësuar të shpenzimeve për KASH-in 2011-2013

	2010 Rishikuar	2011	2012	2013
Total	81,470,285	82,213,674	82,547,595	82,747,595
Paga dhe Mëditje	43,766,924	44,049,817	44,049,817	44,049,817
Mallra dhe Shërbime	19,144,907	19,070,778	19,070,778	19,070,778
Subvencione dhe Transfere	127,000	127,000	127,000	127,000
Shpenzimet Kapitale	18,431,454	18,966,079	19,300,000	19,500,000
Numri i stafit	10,169	10,169	10,169	10,169

Në kufirin e vlerësuar 2011- 2013 për Ministrinë e Punëve të Brendshme gjegjësisht Policinë e Kosovës është rritur masa monetare në kategorinë e Pagave dhe Mëditjeve në shumë prej 3.5 milion € në emër të implementimit të Ligjit të Policisë.

Disa nga projektet kapitale që do të financohen gjatë kësaj periudhe janë: Pajisje të avancuara për mbikëqyrje dhe kontroll të kufijve shtetëror, Ndërtimet dhe renovimet e stacioneve policore, avancimi i sistemit të rexhistrimit të automjeteve, blerja e veturave të blinduara dhe topa uji etj.

Tabela 3. Projektet kapitale në nivel të programeve

Emri i programit	Projektet 2010 Rishikuar	Vlerësimet 2011	Vlerësimet 2012	Vlerësimet 2013
Total	18,431,454	18,966,079	19,300,000	19,500,000
Shërbimet e Regjistrimit Civil	294,522	350,000	500,000	500,000
Departamenti i Regjistrimit të Automjeteve dhe Patentë Shofereve	3,109,631	2,050,000	1,650,000	1,700,000
Departamenti për Menaxhimin e Emergjencave	785,391	450,000		300,000
Departamenti për Prodhimin e Dokumenteve	3,172,480	2,200,000	2,625,000	2,300,000
Operacionet Speciale	1,001,373	1,950,000	1,950,000	1,100,000
Hetimet	1,205,414	1,073,000	975,000	872,000
Shërbimet e Mbështetjes	6,771,422	8,300,079	8,753,361	10,150,000
Trajnimet	170,571	200,000	200,000	150,000
Policia Kufitare	1,497,520	2,000,000	2,176,639	2,088,000
Qendra e Kosovës për Siguri, Publike, Edukim dhe Zhvillim	423,130	393,000	470,000	340,000

Tabela 4. Nevojat Shtese për financim mbi kufirin buxhetor 2011 – 2013

	2011	2012	2013
Total	42,016,990	32,909,001	29,050,901
Shpenzimet operative	18,549,656	20,761,001	22,291,901
Shpenzimet kapitale	23,467,334	12,148,000	6,759,000

Në kërkesën e paraqitur nga Ministria e Punëve të Brendshme, kemi rritje të kërkesës në të gjitha kategoritë ekonomike, kështu Policia e Kosovës ka kërkuar impementimin e plotë të ligjit të policisë dhe sigurimit shëndetësor, bartja e kompetencave të sigurisë (ruajtja e objekteve të trashëgimisë kulturore), menaxhimi i koordinuar i kufijve, luftimin e dukurive të trafikimit dhe narkotikeve, çështjet e azilit dhe migracionit, ku këto fusha bartin kosto shtese buxhetore, kurse Agjencioni i Rexhistrimit Civil ka kërkuar mjete shtesë për pasaporta me çip letërnjoftime biometrike, certifikatat e gjendjes civile, targat e reja të automjeteve etj.

MINISTRIA E FORCËS SË SIGURISË SË KOSOVËS

I. Misioni

Ministria e Forcës së Sigurisë së Kosovës është përgjegjëse për zhvillimin dhe zbatimin e politikave të FSK-së dhe ka kompetencën e ushtrimit të kontrollit dhe administrimit të përgjithshëm të FSK-së, brenda kornizës së qeverisjes demokratike dhe në pajtim me Kushtetutën dhe ligjet e Republikës së Kosovës.

II. Gjendja aktuale

Ministria e FSK-së është Ministri e Integruar e ndërtuar sipas modeleve të disa shteteve të NATO-së dhe është shtabi i nivelit më të lartë të FSK-së.

Planifikimi i nivelit strategjik zhvillohet nga personeli brenda MFSK-së i cili do të krijojë politika, plane, programe dhe vlerësime të nivelit të lartë që do ta caktojnë drejtimin e FSK-së dhe do të caktojnë resurset për zhvillimin e forcës. MFSK-ja është gjithashtu përgjegjëse për krijimin e rregulloreve të FSK-së.

Arritja e Kapaciteteve Fillestare Operacionale në shtator të 2009 ishte një sukses i madh dhe shumë i vlerësuar nga vendoret dhe ndërkombëtarët. Pjesëmarrja e njësisve tona të kërkim shpëtimit me rastin e vërshimeve në Shqipëri tregoi me se miri se FSK po ec drejtë dhe me hapa të sigurt drejt arritjes së kapaciteteve të Plota Operacionale.

Planifikimi dhe kryerja me sukses e Operacioneve dhe detyrave të parapara në Misionin e FSK-së, kërkon orientim më të avancuar drejt një force profesioniste, konsolidim sa më të shpejtë të njësisve me qëllim të zotërimit të kapaciteteve operacionale reaguese për gjithë spektrin e misioneve të ngarkuara me Kushtetutën e Republikës së Kosovës si dhe buxhet dhe mbështetje financiare.

III. Objektivat Strategjike

Strategjia zhvillimit të FSK-së, Plani Afatgjatë i FSK-së të hartuara nga Ministria e FSK-së përcaktojnë rrugën dhe mënyrën se si FSK-ja të zhvillohet, modernizohet dhe stërvitet për të zhvilluar kapacitete reale për realizimin e misionit të saj kushtetues.

- i. Arritja e Kapaciteteve të Plota Operacionale në bashkëpunim me NATO-në (2012)
- ii. Rritja e aftësive operacionale dhe modernizimi i FSK-së (C2)
- iii. Rritja e aftësive për pjesëmarrje në operacione humanitare në raste fatkeqësish dhe në operacione të mbështetjes së paqes.
- iv. Integrimi në strukturat kolektive të sigurisë evropiane dhe euroatlantike.

Arritja e këtyre objektiveve do të realizohet përmes këtyre programeve dhe aktiviteteve

- a) Rekrutimi, Plotësimi, Trajnimi dhe ngritja e Kapaciteteve të Plota Operacionale të FSK-së

- b) Krijimi i Infrastrukturës për Ministrinë e FSK-së (MKSF)
- c) Krijimi i sistemeve funksionale të logjistikës dhe infrastrukturës të mjaftueshme për trajnim.
- d) Ngritja e rezervës së FSK-së
- e) Operacionalizimi dhe modernizimi të njërive të FSK-së konform standardeve të NATO-së.
- f) Zhvillimi i Kapacitetet Operacionale, krijimi i gatishmërisë së plotë profesionale për të marrë pjesë në operacionet ndërkombëtare (të drejtuara nga NATO, BE, OKB).
- g) Në këtë periudhë FSK duhet të jetë e gatshme për rishikimin e Misionit (Qershor 2013) bazuar në Kushtetutën së Kosovës dhe marrëveshjen e Ahtisarit.

Tabela 1; Trendët historike të financimit

	2008	2009	2010 Rishikuar
Total	745,636	20,465,666	31,099,008
Paga dhe Mëditje	131,199	5,441,696	10,913,023
Mallra dhe Shërbime	334,437	3,900,820	7,953,350
Shpenzimet Kapitale	280,000	11,123,150	12,232,635
Numri i stafit	54	2,060	2,824

Zyra e Koordinatorit të TMK-së ka qenë funksionale deri më 31. Korrik 2009, kurse mjetet e para buxhetore për funksionimin e Ministrisë së Forcës së Sigurisë janë ndarë në fund të vitit 2008 dmth. dy procese janë zhvilluar njëkohësisht, në njërin anë shuarja e ZKTMK-së dhe në anën tjetër fillimi i funksionimit të FSK-së.

Tabela 2. Kufijtë e vlerësuar të shpenzimeve 2011-2013

	2010 Rishikuar	2011	2012	2013
Total	31,099,008	33,366,125	33,458,615	33,606,041
Paga dhe Mëditje	10,913,023	11,537,415	11,537,415	11,537,415
Mallra dhe Shërbime	7,953,350	8,627,577	8,688,126	8,688,126
Shpenzimet Kapitale	12,232,635	13,201,133	13,233,074	13,380,500
Numri i stafit	2,824	2,824	2,824	2,824

Në kufijtë e vlerësuar për periudhën 2011- 2013 pjesërisht është përfshirë pjesërisht kërkesa e Ministrisë së Forcës së Sigurisë për përmbushjen e nevojave për kategorinë e Pagave dhe Mëditjeve (pjesëtarët aktiv, pjesëtarët rezervë dhe ai administrativ), kurse për kategorinë e Mallrave dhe Shërbimeve si dhe të kategorinë e Shpenzimeve Komunale niveli i shpenzimeve mbetet i njëjtë.

Nga investimet kapitale që do të financohen, vlen të theksohen projekti Radio pajisje taktike, pushkë të standardizuara, ndërtime dhe riparime të ndryshme nëpër kazerma, objekte të komandës, garazha etj.

Tabela 3; Projektet kapitale në nivel të programit

Emri i programit	Projektet 2010 Rishikuar	Vlerësimet 2011	Vlerësimet 2012	Vlerësimet 2013
Total	12,232,635	13,201,133	13,233,074	13,380,500
Administrata Qendrore	471,234	240,000	40,000	40,000
Forca e Sigurisë së Kosovës	11,761,401	12,961,133	13,193,074	13,340,500

Tabela 4; Nevojat për financim mbi kufirin buxhetor 2011-2013

	2011	2012	2013
Total	8,688,902	14,842,858	18,804,358
Shpenzimet operative	3,368,035	4,125,858	4,390,858
Shpenzimet kapitale	5,320,867	10,717,000	14,413,500

Kërkesa shtesë për financim ka të bëjë kryesisht në kategorinë e mallrave dhe shërbimeve (shpenzime të trajnimit dhe të përgatitjes së strukturave të saj për pjesëmarrje në strukturat e NATO dhe ato Evropiane) dhe në kategorinë e investimeve kapitale (blerja e autoblindave, Rrjeti strategjik i Komunikimit, Zyra dhe Garazhe për komponentën rezervë nëpër qendra të ndryshme, ndërtimi i palestrave sportive etj.).

SEKTORI I MIRËQENIES SOCIALE DHE SHËNDETËSISË

Misioni i sektorit social është që të gjithë qytetarët të Kosovës të ju mundësoj të jetojnë në një shoqëri kohezive pa varfëri, me punësim të plotë dhe sigurim të resurseve themelore dhe ofrimin e shërbimeve shëndetësore drejt arritjes së standardeve Evropiane.


I. Gjendja Aktuale

Gjendja në Sektorin Social dhe Shëndetësore përkundër përpjekjeve dhe angazhimeve edhe me tej mbetet e rëndë. Në Kosovë, rreth 45% të popullsisë janë të papunësuar dhe rreth 15% të popullsisë kanë vështirësi në sigurimin e nevojave të tyre elementare apo jetojnë në varfëri të skajshme, sipas raporteve të Bankës Botërore. Indikatorët shëndetësorë mbasin ndër më të dobët në regjion.

Nga Buxheti i Kosovës për vitin 2010 janë ndarë, €246.8 milion, ose rreth 26.26%, për këtë sektor. Ministritë që përbëjnë sektorin Social janë: Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale dhe Ministria e Shëndetësisë.

Gjatë viteve 2009-2010 kemi një përmisim të dukshëm në furnizimin me barna dhe material shpenzues, edukim të vazhdueshëm dhe ngritje të kapaciteteve menaxhuese, plotsimi i infrastrukturës ekzistuese të sistemit shëndetësor në përputhje me standartet Evropiane. Ka filluar procesi i avancimi të gjendjes materiale të punëtorëve shëndetësorë në kategorinë e pagave.

Realizimi me sukses i skemave të pensioneve dhe atyre sociale, avancimi i politikave për ngritjen e shkallës së punësimit, krijimi dhe kompletimi i infrastrukturës ligjore nga fusha e punësimit dhe çështjeve sociale.



II. Planet e ardhshme

Qeveria e Republikës së Kosovës në planin afatmesëm një ndër prioritetet kryesore do të ketë avancimin e këtij sektori. Megjithatë sipas këtij plani do të përfitojn më së shumti pensionet – kontributdhënësit dhe përfitusit e skemës për vlerat e luftës.

Ky program është i dizajnuar që të ndihmojnë pjesët më nevojtare të popullatës: të moshuarit, të varfëritë, personat me aftësi të kufizuara, të papunësuarit, ofrim të shërbimeve shëndetësore dhe të tjerët që shumë kanë nevojë për ndihmë nga Qeveria.

Përmbledhje e vlerësimeve të hershme në nivel sektori

	2010 Rishikuar	2011	2012	2013
Paga dhe Mëditje	32,055,219	31,957,864	31,957,864	31,957,864
Mallra dhe Shërbime	34,894,364	37,780,229	37,780,229	37,780,229
Subvencione dhe Transfere	166,584,194	193,494,194	193,794,194	193,794,194
Shpenzime Kapitale	13,356,292	11,629,636	11,600,000	11,500,000
Numri i stafit	8,175	8,175	8,175	8,175
Totali	246,890,069	274,861,913	275,132,287	275,032,287

Përmbledhje e projekteve kapitale në nivel të OB-së

	2010 Rishikuar	2011	2012	2013
Totali i MPMS	3,199,225	2,729,292	2,600,000	2,500,000
Totali i MSH	10,157,067	8,900,334	9,000,000	9,000,000
Totali i Sektorit Social	13,356,292	11,629,626	11,600,000	11,500,000

Projektet kontingjente në burimet shtesë në nivel sektori

	2011	2012	2013
Shpenzimet Operative	27,012,864	47,616,404	56,165,376
Shpenzimet Kapitale	20,341,418	17,844,913	13,006,950
Totali	47,354,282	65,461,317	69,172,326

Mjetet shtesë në nivel sektori janë kërkuar për: ndërtimet dhe renovimet të objekteve, rritjen e programit farmaceutik 40% me qëllim të furnizimit më të mirë me barna, implikimet financiare shtesë për kostot e projektligjeve përfshirë, ligjet e aprovuar plotësimi ndryshimi i tyre, ligjet në procedurë dhe në plan të hartimit.

MINISTRIA PUNËS DHE MIRËQENIES SOCIALE

I. Misioni

Misioni i MPMS-së është që të gjithë qytetarët të Kosovës të ju mundësoj që të jetojnë në një shoqëri kohezive pa varfëri, me punësim të plotë dhe sigurim të resurseve themelore për të gjithë qytetarët në moshë të punës.

MPMS ka obligime ligjore për të ofruar shërbime, përmes programeve të cilat janë dizajnuar që të ndihmojnë pjesët më nevojtare të popullatës: të moshuarit, të varfëritë, personat me aftësi të kufizuara, të papunësuarit dhe të tjerët që më së shumë kanë nevojë për ndihmë nga Qeveria.

II. Gjendja aktuale

Kosova konsiderohet të ketë shkallën më të lartë të papunësisë dhe varfërisë në regjion. Papunësia dhe varfëria është më e lartë në mesin e atyre që jetojnë në familje të mëdha që kanë shumë anëtare të papunë si dhe tek ata që kanë nivel të ulët të arsimimit. Papunësia paraqet një rën nga sfidat kryesore të shoqërisë kosovare. Ndër veçoritë brengosëse të tregut të punës në Kosovë vlerësohet të jetë papunësia e lartë rreth 43% 2008. Janë të nevojshme një mori veprimesh të cilat do të ndikojnë në ngritjen e shkallës së punësimin dhe uljen e shkallës së papunësisë në nivel të Kosovës. Sipas raportit të fundit të vitit 2007 të Bankës Botërore vlerësohet se rreth 45% të popullsisë jetojnë në varfëri, prej tyre 15% në varfëri të skajshme.

Mbrojtja sociale, programet e përfitimeve në Kosovë (pensionet dhe ndihmat sociale) sipas të dhënave mbulojnë rreth 325 000 persona, që d.m.th. rreth 15% e popullsisë kanë qasje në një rën nga skemat e pagesave sociale. Ekzistojnë disa skema të ndryshme të përfitimit në Kosovë: me zhvillimin e mirëqenies dhe përfshirjes së grupeve të rrezikuara në shoqëri, secili individ mund të jetojë me dinjitet dhe i sigurt, si dhe mund të zhvillojë dhe t'i aplikojë shkathtësitë dhe talentet e veta në fazat e ndryshme të jetës. Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale me qëllim të përmirësimit të punësimin dhe mirëqenies sociale ka këto synime.

III. Objektivat Strategjike

Ngritja e mirëqenies dhe mbështetja e familjeve, përmes ofrimit të ndihmave sociale dhe shërbimeve sociale për kategoritë e rrezikuara të shoqërisë

Avancimi në zbatimin e politikave në ngritjen e shkallës së punësueshmërisë në nivel vendi.

Objektivi i parë mund të arrihet përmes këtyre programeve dhe aktiviteteve:

Indeksi i skemave pensionale (pensioneve bazë, të aftësisë së kufizuar dhe kontribut pagues) sipas inflacionit;
 Projektligji për Statusin dhe të drejtat e dëshmorëve, invalidëve të luftës, veteraneve, pjesëtareve të UÇK-së, viktimave civile dhe familjeve të tyre;
 Përmirësimi i kushteve të jetesës së pensionistëve me mundësi të rishikimit të kostos për shportën e ushqimeve në përputhje me trendët e lëvizjes së çmimeve;
 Rritja e pensioneve të Kontributdhëse.

Objektivi i dytë mund të arrihet përmes këtyre programeve dhe aktiviteteve:
 Ulja e shkallës së papunësisë dhe ngritja e aftësive profesionale, varësisht nga nevojat e kërkesës së tregut të punës:

Ligji i punës;

Zhvillimi i bashkëpunimit me vendet në regjion (anëtare të BE-së dhe atyre jashtë BE) për rritjen e mundësive për punësim të fuqisë punëtore nga Kosova;

Rritja vjetore e shkallës së punësueshmërisë të grupit të të rinjve, dhe zgjerimi i programeve aktive të tregut të punës;

Punësimi sezonal i studenteve të rregullt në tregun gjerman;

Ngritja e nivelit të shërbimit të aftësimit profesional në rrjetin e qendrave për aftësime dhe implementimit të skemave të trajnimit të drejtpërdrejt në kompani më qëllim të arritjes së standardeve më të larta;

Forcimi i partneritetit – publik/privat (blerja e shërbimeve të trajnimeve);

Tabela 1- Trendët historike te financimit

	2008	2009	2010 Rishikuar
Total	157,657,459	159,931,028	174,049,273
Paga dhe shtesa	3,437,058	3,437,058	3,166,012
Mallra dhe shërbime	4,446,002	3,575,000	3,189,842
Subvencione dhe Transfere	147,421,140	149,744,500	164,544,194
Shpenzime Kapital	2,353,259	3,174,470	3,199,225
Numri i stafit	1,297	1,297	920

Në vlerësimet e hershme janë përfshi këto projektligje:

- Ligji për sigurinë pensionale: Pensionet Kontributdhënëse për vitin 2011 janë vlerësuar 8.3 milion, Pensionet bazë 5.3 milion, Pensionet për persona me paaftësi 0.9 milion, Pensionet e hershme të Trepçës 0.4 milion, ndërsa rritja natyrore për këto kategori të pensioneve është 5 milion. Për vitin 2012 janë vlerësuar 20 milion për vitin 2013 janë 20 milion, ku është përfshirë edhe rritja natyrore
- Ligji për Statusin dhe të drejtat e dëshmorëve, invalidëve të luftës, veteraneve, pjesëtareve të UÇK-së, viktimave civile dhe familjeve të tyre, për tri vitet në vijim është vlerësuar nga 5.2 milion për se cilin vit.
- Ligji i punës për tri vitet në vijim është vlerësuar nga 1.8 milion për se cilin vit.
- Rritja natyrore e skemave pensionale.

Tabela 2- Kufijtë e vlerësuar të shpenzimeve për KASH-in 2011-2013

	2010 Rishikuar	2011	2012	2013
Totali	174,049,273	200,604,806	200,775,514	200,675,514
Paga dhe shtesa	3,166,012	3,250,373	3,250,373	3,250,373
Mallra dhe shërbime	3,189,842	3,130,947	3,130,947	3,130,947
Subvencione. dhe Transfere	164,544,194	191,494,194	191,794,194	191,794,194
Shpenzime Kapitale	3,199,225	2,729,292	2,600,000	2,500,000
Numri i stafit	920	920	920	920

Për shkak të kufizimeve buxhetore kategoria e Skemës Sociale për vitet në vijim duhet të përshtatet mundësi buxhetore të ndara për këtë natyrë, me qëllim që mos të kemi rritje të përfituesve. Vlerësimet janë bërë për afërsisht për 35,000 familje përfituese në vit.

Tabela 3 - Projektet kapitale në nivel të departamentit totali i kapitaleve

Emri i programit	Projektet 2010 Rishikuar	Vlerësimet 2011	Vlerësimet 2012	Vlerësimet 2013
Totali	3,199,225	2,729,292	2,600,000	2,500,000
Pensionet Bazike	10,867	470,000	428,000	300,000
Mirëqenia Sociale	1,032,835	1,000,000	1,000,000	970,000
Puna dhe Çështjet e punësimit	1,487,180	1,041,132	1,002,000	1,000,000
Shërbimet sociale	168,343	120,000	130,000	200,000
Pensionet e Invalidëve të Luftës	500,000	98,160	40,000	30,000

Tabela 4 – Nevojat për financim mbi kufirin buxhetor 2011-2013

	2011	2012	2013
Totali	17,301,128	35,688,066	39,580,072
Shpenzimet Operative	13,059,260	31,912,800	38,111,772
Shpenzimet Kapitale	4,241,868	3,775,266	1,468,300

Implikimet financiare shtesë për vitet në vijim janë për kostot e projektligjeve përfshirë, ligjet e aprovuar plotësim-ndryshimi i tyre, ligjet në procedurë dhe në plan të hartimit.

MINISTRIA E SHËNDETËSISË

I. Misioni

Zhvillimi i sistemit të qëndrueshëm shëndetësor i cili do të ofroj shërbime shëndetësore cilësore për të gjithë banorët e Republikës së Kosovës me synimin e arritjes së standardeve bashkëkohore.

II. Gjendja aktuale

Sistemi shëndetësor i Republikës së Kosovës është i organizuar në tri nivele: parësor, dytësor dhe tretësor.

Gjatë viteve 2009-2010 kemi një përmisim të dukshëm në furnizimin me barna dhe material shpenzues, edukimi i vazhdueshëm dhe ngritja e kapaciteteve menaxhuese, plotsimi i infrastrukturës ekzistuese të sistemit shëndetësor në përputhje me standartet Evropiane. Ka filluar procesi i avancimi të gjendjes materiale të punëtorëve shëndetësorë në kategorinë e pagave.

Në përpjekje për të përmirësuar dhe zhvilluar shërbimet shëndetësore, Ministria e Shëndetësisë ka mungesë të infrastrukturës ligjore të Sigurimeve Shëndetësore.

Synim kryesor është përmirësimin i situatën ekzistuese dhe implementimin e Strategjisë sektoriale të Ministrisë së Shëndetësisë, drejt arritjes së objektivave strategjike të definuar. Kjo Strategji konsolidon kërkesat nga Propozimi gjithëpërfshirës për marrëveshjen për zgjidhjen e statusit të Kosovës (Plani i Ahtisar-it), Plani i Veprimit për Partneritet Evropian (PVPE), Letra e Bardhë dhe Master Plani.

III. Objektivat Strategjike

- i. Zvogëlimi i sëmundshmërisë dhe vdekshmërisë së popullatës së përgjithshme.
- ii. Përmirësimi i menaxhimit të resurseve ekzistuese dhe cilësisë së shërbimeve, plotsimi i infrastrukturës ekzistuese të sistemit shëndetësor në përputhje me standartet Evropiane.
- iii. Implementimi dhe zhvillimi i Sistemit të Informimit Shëndetësor / SISH.
- iv. Krijimi i sistemit të qëndrueshëm të financimit për sektorin e shëndetësisë.

Objektivi i parë - mund të arrihet përmes këtyre programeve dhe aktiviteteve :

- a) Përforcimi i rolit të shëndetësisë publike, përmes programeve për ruajtjen dhe përmirësimin e shëndetit;
- b) Përforcimi i rolit të Mjekësisë Familjare, si gurthemel i sistemit shëndetësor;
- c) Sigurimi i barnave dhe materialeve shpenzuese nga Lista Esenciale.

Objektivi i dytë - mund të arrihet përmes këtyre programeve dhe aktiviteteve :

- a) Ngritja e llogaridhënies përmes definimit të roleve dhe përgjegjësi të Institucioneve shëndetësore, Departamenteve/njësive dhe të punësuarve brenda tyre, përmirësimi i sistemit të referimit;
- b) Adresimi i çështjeve kyçe të cilat ndikojnë në sistemit shëndetësor në bazë të Master planit;
- c) Furnizimi, funksionalizimi dhe mirëmbajtja e pajisjeve në Institucionet Shëndetësore.

Objektivi i tretë - mund të arrihet përmes këtyre programeve dhe aktiviteteve :

- a) Përcaktimi i qasjes dhe strukturave menaxhuese për zhvillim dhe funksionalizim të SISH-it, identifikimi i pengesave dhe kostos në sistemin ekzistues të informimit shëndetësor për grumbullimin dhe përpunimin e të dhënave si dhe mirëmbajtjen e sistemit;
- b) Përmirësimi progresiv i cilësisë së rezultateve të SISH-it dhe harmonizimi i tyre me standardet e OBSH-së dhe Eurostat-it.

Objektivi i katërt mund të arrihet përmes këtyre programeve dhe aktiviteteve:

- a) Përcaktimi i pakos bazike të shërbimeve shëndetësore;
- b) Përcaktimi i kostos së shërbimeve shëndetësore;
- c) Përgatitja e kushteve për implementimin e sigurimeve shëndetësore.

Tabela 1- Trendët historike të financimit

	2008	2009	2010 Rishikuar
Totali	57,891,404	66,282,033	72,840,796
Paga dhe Mëditje	19,975,409	20,272,409	28,939,207
Mallra dhe Shërbime	27,464,076	32,439,204	31,704,522
Subvencione dhe Transfere	500,000	1,070,420	2,040,000
Shpenzimet Kapitale	9,951,919	12,500,000	10,157,067
Numri i stafit	7,302	7,393	7,255

Tabela 2- Kufijtë e vlerësuar të shpenzimeve për KASH-in 2011-2013

	2010 Rishikuar	2011	2012	2013
Total	72,840,796	74,257,107	74,356,773	74,356,773
Paga dhe Mëditje	28,939,207	28,707,491	28,707,491	28,707,491
Mallra dhe Shërbime	31,704,522	34,649,282	34,649,282	34,649,282
Subvencione dhe Transfere	2,040,000	2,000,000	2,000,000	2,000,000
Shpenzimet Kapitale	10,157,067	8,900,344	9,000,000	9,000,000
Numri i stafit	7,255	7,255	7,255	7,255

Në vlerësimet e hershme në shpenzimet operative janë përfshirë rritja e pagave për punëtorët shëndetësorë 30%, shpenzimet kapitale kryesisht kanë të bëjnë me këto projekte; Renovimi i njeve sanitare për të gjitha klinikat, Pajisje mjekësore për Qendrën Klinike Universitare të Kosovës si dhe për Spitalet Regjionale, Emergjencia-Blloku Operativ, Zhvillimi i Sistemit Informativ Shëndetësorë etj.

Tabela 3-Projektet kapitale në nivel të departamentit totali i kapitaleve

Emri i programit	Projektet 2010 Rishikuar	Vlerësimet 2011	Vlerësimet 2012	Vlerësimet 2013
Totali	10,157,067	8,900,334	9,000,000	9,000,000
Dep.i Shërbimeve të Spitaleve	7,953,981	5,802,914	5,994,000	6,478,000
Dep.i Shërbimeve tjera Shëndetsore	1,977,456	2,947,420	2,906,000	2,522,000
Dep. i Administrates Qëndrore	225,630	150,000	100,000	0

Tabela 4- Nevojat për financim mbi kufirin buxhetor 2011-2013

	2011	2012	2013
Totali	30,053,154	29,773,251	29,592,254
Shpenzimet Operative	13,953,604	15,703,604	18,053,604
Shpenzimet Kapitale	16,099,550	14,069,647	11,538,650
Numri i stafit	335	335	335


Implikimet financiare shtesë për vitet në vijim janë për nevojën e rritjes së numrit të punëtorëve, rritja gjithashtu reflekton edhe në rritjen e shpenzimeve tjera. Ministria e Shëndetësisë kërkon rritje prej 40% për Programin e Farmacisë me qëllim të furnizimit më të mirë të barna për vitet e ardhshme.

SEKTORI I SHËRBIMEVE TË PËRGJITHSHME PUBLIKE

Sektori i shërbimeve publike është sektor i rëndësishëm në të cilin janë të renditura institucionet të cilat kanë të bëjnë me ekzekutivin dhe legjislativin, pra janë të përfshira Organizatat buxhetore të cilat janë të konstituara për të krijuar një bazë juridike të qëndrueshme për një zhvillim ekonomik dhe ofrim të shërbimeve më të mira për qytetaret e Republikës së Kosovës.

I. Gjendja Aktuale

Për Sektorin e shërbimeve publike për vitin 2010 janë ndarë 129,5 milion € ose rreth 13.78%, pra shprehur në përqindje, ky sektorë nuk ka pjesëmarrje të madhe në buxhet krahasuar me sektorët e tjerë.



Ministritë apo institucionet që përbejnë këtë sektorë janë: Kuvendi, Zyra e Presidentit, Zyra e Kryeministrit, Ministria për Ekonomi dhe Financa, Ministria e Punëve të Jashtme, Ministria për Komunitete dhe Kthim, Ministria e Administratës Publik, Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal, Ministria e Integritimit Evropian, Zyra e Auditorit të Përgjithshëm, Komisioni i Pavarur i Mediave, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, si dhe Ombudspersoni.

II. Planet për të ardhmen

Projektet kryesore në KASH për vitet 2011/2013 të propozuara për financim nga buxheti i Kosovës për vitin 2011 janë: Regjistrimi i popullsisë, i cili është njëri ndër projektet me prioritet të lartë të Kosovës, ligji për pagat e shërbyesve civil, zgjedhjet në nivelin qendrorë që priten të mbahen në vitin 2011, shpronësimi i autostradës Merdar - Morine, krijimi i ministrisë për integritet evropian, zbatimi i reformave në pushtetin lokal, renovimi i pikave doganore, implementimi i arkave fiskale, themelimi i trembëdhjetë përfaqësive konsullore, si dhe disa projekte për administratën e shërbimeve publike në përgjithësi të cilat do të ndikojnë në efikasitetin e administratës publike.

***Përmbledhje e vlerësimeve të hershme**

	2010 Rishikuar	2011	2012	2013
Totali	129,519,156	185,962,251	151,770,118	152,514,118
Paga dhe shtesa	24,479,444	31,399,098	31,402,773	31,402,773
Mallra dhe Shërbime	38,734,528	40,011,648	34,851,468	40,551,468
Subvencione dhe Transfere	7,165,165	11,973,704	11,973,704	11,973,704
Rezerva	1,150,929	1,000,000	1,000,000	1,000,000
Shpenzime kapitale	57,989,090	101,577,801	72,542,173	67,586,173
Numri i stafit	3,680	3,635	3,615	3,615

Përmbledhja e shpenzimeve kapitale

	2010 Rishikuar	2011	2012	2013
Kuvendi	1,431,227	1,360,811	1,000,000	500,000
Zyra e Presidentit	1,423,522	1,428,691	1,300,000	1,350,000
Zyra Kryeministrit	2,570,217	2,579,550	2,400,000	2,652,000
Ministria për Ekonomi dhe Financa	13,534,252	58,528,351	29,902,385	24,402,385
Ministria e Administratës Publike	12,483,692	17,143,666	17,599,788	18,231,788
Ministra e Administrimit të Pushtetit Lokal	6,566,805	2,968,933	3,000,000	3,000,000
Ministra e Punëve të Jashtme	12,582,690	9,503,321	9,400,000	9,650,000
Ministria e Komunitete	6,847,630	7,389,778	7,500,000	7,600,000
Ministria e Integriteteve Evropiane	74,355	200,000	200,000	200,000
Zyra e Auditorit Gjeneral	0	0	0	0
Ombuspersoni	0	0	0	0
Komisioni i Pavarur i Mediave	450,000	450,000	240,000	0
Komisioni Qendror i Zgjedhjeve	24,700	24,700	0	0
Totali	57,989,090	101,577,801	72,542,173	67,586,173

Projektet kontingjente në burimet shtesë

	2011	2012	2013
Shpenzime operative	69,756,281	47,061,116	52,705,080
Shpenzime kapitale	50,037,744	40,359,671	38,268,917
Totali	119,794,025	87,420,787	90,973,997

Kërkesat shtesë të vlerësuar të shpenzimeve të cilat janë paraqitur në tabelën janë përcaktuar duke marrë për bazë nevojat për financimin e politikave të reja që përfshihen në këtë sektor.

Kërkesat shtesë për financim kryesisht kanë të bëjnë me: Blerjen e ambasadave, ndërtimi i akademisë diplomatike, ndërtimi, renovimi e ndërtesave dhe shtëpive për komunitet si dhe me rregullimin e infrastrukturës për komunitete, zgjerimi i hapësirave në objektet qeveritare, mirëmbajtjen e tyre, qeverisja elektronike, implementimi i planit të veprimit të Reformës së Administratës Publike në Kosovë, reformimin e administratës komunale, krijimi i komunave të reja, si dhe projekte të ndryshme që janë të rëndësishme për këtë sektor.

* Agjensionet e pavaruara në tabelën përmbledhëse sektoriale janë të përfshira sipas rekomandimeve për financim

KUVENDI I REPUBLIKËS SË KOSOVËS

I. Misioni

Kuvendi i Republikës së Kosovës si organ më i lartë përfaqësues dhe ligjvënës në Kosovë ka fushëveprim të gjerë konform Kushtetutës dhe Rregullores së punës. Andaj misioni i Kuvendit është që detyrat që dalin nga fushëveprimi i tij e posaçërisht tani pas pavarësisë të kryhen me sukses. Kuvendi i Kosovës synon që përmes një strategjie efikase të veprimit të arrijë synimet e tij.

II. Gjendja e aktuale

Kuvendi i Republikës së Kosovës si organi më i lartë përfaqësues dhe ligjvënës ka miratimin e ligjeve dhe akteve tjera nga fushëveprimi i vet. Krahas punëve procedurale të ligjvënësve përgjegjës të Kuvendit shtrihen edhe në çështje tjera të rëndësishme që kanë të bëjnë me integrimin e vendit në institucione të ndryshme ndërkombëtare.

Me buxhetin e vitit 2010 Kuvendi i Republikës së Kosovës synon që të intensifikoj punën e vet në të gjitha lëmit e posaçërisht në nxjerrjen e ligjeve, duke vazhduar harmonizimin e tyre me legjislacionin e BE-së, ti mbulojë shpenzimet operative dhe të bëjë investime në projektet kapitale për të cilat është ndarë buxheti i këtij viti. Shtimi i përgjegjësive dhe procedimi i ligjeve çdo ditë e më tepër detyrimisht shton kërkesën për më shumë mjete buxhetore.

III. Objektivat Strategjike

Objektivat kryesorë të Kuvendit të Republikës së Kosovës në planin afatmesëm janë:

- i. Organizimi dhe funksionimi sa më efikas i Kuvendit të Kosovës, në zhvillimin e më tej të një procesi ligjvënës efikas dhe gjithëpërfshirës,
- ii. Procedimi dhe miratimi i ligjeve dhe akteve tjera dhe harmonizimin e tyre me legjislacionin e BE-së,
- iii. Shtimi i aktiviteteve në diplomacinë parlamentare si dhe shërbime të konsulencës për të gjitha komisionet parlamentare dhe për aktivitete,
- iv. Mbështetjen sa më profesionale komisioneve parlamentare në hartimin, shqyrtimin dhe amendamentimin e projektligjeve,
- v. Ngritja profesionale permanente e shërbimeve administrative në aspektin buxhetor, financiar e kadrovik,
- vi. Të krijohen hapësira dhe kushte të nevojshme për punën e deputetëve dhe organeve të Kuvendit.

Tabela 1: Trendët historike të financimit

	2008	2009	2010 Rishikuar
Totali	8,719,962	9,244,727	9,761,100
Paga dhe Mëditje	3,902,486	4,253,585	4,816,070
Mallra dhe Shërbime	1,391,143	1,391,359	1,612,020
Subvencione dhe Transfero	1,901,783	1,901,783	1,901,783
Shpenzimet Kapitale	1,524,550	1,698,000	1,431,227
Numri i stafit	292	327	340

Tabela 2: Kufijtë e vlerësuar të shpenzimeve për KASH- in 2011-2013

	2010 Rishikuar	2011	2012	2013
Totali	9,761,100	12,327,547	11,966,736	11,466,736
Paga dhe shtesa	4,816,070	4,515,800	4,515,800	4,515,800
Mallra dhe shërbime	1,612,020	1,581,955	1,581,955	1,581,955
Subvencione dhe transfero	1,901,783	4,868,981	4,868,981	4,868,981
Shpenzimet kapitale	1,431,227	1,360,811	1,000,000	500,000
Numri i stafit	340	327	327	327

Në tabelën 2 shihet që kategoria e Subvencioneve dhe Transfereve për vitet 2011,2012, 2013 janë të rritura dhe kjo për arsye se janë shtura 3 mil euro për Fondin e Partive Politike sipas rekomandimeve të FMN.

Tabela 3: Projektet kapitale në nivel të departamentit

	2010 Rishikuar	2011	2012	2013
Totali	1,281,227	1,360,811	1,000,000	500,000
Administrata e Kuvendit	1,281,227	1,360,811	1,000,000	500,000

Tabela 4: Nevojat për financim mbi vlerësimet për KASH 2011-2013

	2011	2012	2013
Totali	2,364,851	3,995,333	5,385,837
Shpenzimet Operative	1,495,662	3,115,333	2,455,837
Shpenzimet Kapitale	869,189	880,000	2,930,000

Kërkesat e vlerësuar të shpenzimeve të cilat janë paraqitur në tabelën janë përcaktuar duke marrë për bazë koston e politikave ekzistuese dhe vlerësimin fillestar të kapacitetit për financim dhe iniciativave të reja të cilat janë: 1. Hapja e zyrave nëpër komuna për komunikim me qytetarët, 2. Diplomacia Parlamentare, 3. Zgjerimi dhe pavarësimi i Teknologjisë Informativë të Kuvendit të (TIK-ut) dhe mbështetja e komisioneve.

ZYRA E PRESIDENTIT

I. Misioni

Misioni i Zyrës së Presidentit është përfaqësimi i unitetit të popullit të Republikës së Kosovës. Garantimi i funksionimit kushtetues të institucioneve të Republikës së Kosovës të përcaktuara me Kushtetutën e Republikës së Kosovës. Misioni i Zyrës së Presidentit është të ofroj informata të sakta dhe këshilla të paanshme e profesionale për Presidentin e Republikës në mënyrë që të sigurohet përmbushja e tyre.

II. Gjendja e aktuale

Zyra e Presidentit të Republikës së Kosovës që nga themelimi kryen punët dhe detyrat që janë në pajtueshmëri me Kushtetutën e Republikës së Kosovës, të bazuar në Ligjin Nr.03/L-094 për Presidentin e Republikës së Kosovës, Për momentin janë të punësuar 51 punëtorë dhe në bazë të Rregullores së brendshme të ZPRK-së është paraparë rritja e numrit të punëtorëve në 110 më qëllim të kryerjes dhe funksionalizimit sa ma efikas të detyrave të ZPRK-së.

III. Objektivat Strategjike

Objektivat kryesore të Zyrës së Presidentit të Kosovës në planin afatmesëm janë:

- i. Zbatimi i Ligjit për Presidentin e Republikës së Kosovës, si dhe funksionalizimi i Zyrës së Presidentit të Republikës në përputhje me dispozitat e këtij Ligji si Institucion i veçantë në kuadër të shërbimit civil,
- ii. Zbatimi i politikës jo diskriminuese ndaj personelit të zyrës, duke përfshirë përfaqësimin e barabartë gjinor në të gjitha fushat dhe nivelet, dhe sigurimin që struktura e personelit të pasqyrojë karakterin shumë etnik të Republikës së Kosovës,
- iii. Zbatimi i Ligjit për të Drejtat e Komuniteteve dhe Pjesëtarëve të tyre në Republikën e Kosovës – funksionalizimi i plotë i Këshillit Konsultativ për Komunitete.

Tabela 1: Trendët historike të financimit

	2008	2009	2010 Rishikuar
Totali	2,588,898	2,471,891	3,152,890
Paga dhe Mëditjet	213,432	213,432	373,823
Mallra dhe Shërbime	1,259,716	1,090,459	1,272,871
Subvencionet dhe Transfere	15,750	68,000	82,674
Shpenzimet Kapitale	1,100,000	1,100,000	1,423,522
Numri i stafit	59	59	86

Tabela 2: Kufijtë e vlerësuar të shpenzimeve për KASH- in 2011-2013

	2010 Rishikimi	2011	2012	2013
Total	3,152,890	2,969,426	2,845,328	2,895,328
Paga dhe Mëditjet	373,823	319,772	319,772	319,772
Mallra dhe shërbime	1,272,871	1,138,289	1,142,882	1,142,882
Subvencionet dhe Transfere	82,674	82,674	82,674	82,674
Shpenzimet Kapitale	1,423,522	1,428,691	1,300,000	1,350,000
Numri i stafit	86	79	79	79

Në tabelën 2 shihet që shpenzimet operative mbesin në nivel të njëjtë edhe për vitet në vijim.

Tabela 3: Projektet kapitale në nivel të departamentit

	2010 Rishikimi	2011	2012	2013
Totali	1,423,522	1,428,691	1,300,000	1,350,000
Shpenzimet Kapitale	1,423,522	1,428,691	1,300,000	1,350,000

Tabela 4: Nevojat për financim mbi vlerësimet për KASH 2011-2013

	2011	2012	2013
Totali	875,010	1,338,729	1,942,628
Shpenzimet Operative	655,010	854,729	1,141,828
Shpenzimet Kapitale	220,000	484,000	800,800

Në shpenzimet operative kërkesa shtesë është për numër të punëtoreve të cilat reflektohen edhe në kategorinë e mallrave dhe shërbimeve ndërsa për kapitale kërkesa shtesë është për projektin e Shtëpisë së bardhë.

ZYRA E KRYEMINISTRIT

I. Misioni

Misioni i Zyrës së Kryeministrit është ushtrimi i pushtetit ekzekutiv në përmbushjen e detyrave programore të Qeverisë së Republikës së Kosovës, sipas funksionit dhe detyrave të përcaktuara me Kushtetutën e Republikës së Kosovës. Udhëheqjen, koordinimin dhe monitorimin e Institucioneve të Republikës së Kosovës në përmbushjen e kriterëve që dalin nga proceset që po kalon Kosova, si dhe zbatimin e Ligjeve që janë në fuqi.

II. Gjendja e aktuale

Zyra e Kryeministrit të Kosovës funksionon në bazë të skemës organizative, që është e ndarë në agjenci dhe zyra. Agjencitë dhe zyrat e ZKM-së kanë të përcaktuara mandatin e tyre, standardet e punës dhe fushën e veprimit konkret. Agjencitë ekzekutive kanë mandat të veçantë si dhe përgjegjësi e funksione të veçanta të përcaktuara në legjislationin e hartuar. Agjencitë udhëhiqen nga kryeshefat ekzekutivë ndërsa zyrat nga drejtorët të cilët janë shërbyes civil.

Kosova në vitin 2010 ka thelluar dialogun teknik dhe politik me Komisionin Evropian përmes Dialogut të Procesit të Stabilizim Asocimit, (përmes të cilit mbahet dialogu Qeveria e Kosovës – Komisioni Evropian me qëllim të reformës institucionale, legjislative, ekonomike dhe sociale), qasjes më të madhe në programet e Komunitetit, dhe marrëveshjes tregtare me Bashkimin Evropian. Pjesa e rëndësishme e këtij procesi janë Partneritetet Evropiane dhe Raportet e Progresit. Koordinimi i donacioneve është jashtëzakonisht i rëndësishëm me qëllim të rritjes së produktivitetit ekonomik të vendit dhe përmirësimit të standardit të jetës.

III. Objektivat Strategjike

Objektivat kryesore të Zyrës së Kryeministrit të Republikës së Kosovës janë:

i. Zbatimi i ligjeve që janë të aprovuara nga Kuvendi i Republikës së Kosovës.

Ndihmon në hartimin e ligjeve që diskutohen në qeveri dhe procedohen në Kuvendin e Kosovës për aprovim, nxjerr vendime dhe udhëzime administrative, kryen detyra në suaza të kornizës së përgjegjësisë të përcaktuara me ligj.

ii. Integrimi në strukturat Botërore dhe Evropiane si dhe bashkëpunimi më Shërbimet Veterinare në rajon e më gjerë.

Si parakusht për integrim është detyrë primare siguria e ushqimit, mbrojtja e shëndetit të kafshëve, mbrojtja e shëndetit publik, luftimi dhe eliminimi i sëmundjeve zoonotike, stimulimi i prodhuesve dhe përpunuesve vendor dhe mundësin e eksportit, reduktimi i importit.

iii. Avancimi dhe Strukturimi i Arkivave të Kosovës.

Mbrojtja, evidencimi, klasifikimi, përpunimi, shfrytëzimi, ruajtja e dokumentacionit arkivor me vlerë historike dhe shkencore si dhe organizimi dhe funksionimi i shërbimit arkivor në Republikën e Kosovës.

Tabela 1: Trendët historike të financimit

	2008	2009	2010 Rishikuar
Totali	5,700,664	4,598,324	8,376,505
Paga dhe Mëditje	870,916	1,053,263	2,133,151
Mallra dhe Shërbime	3,472,700	2,154,971	2,426,194
Subvencione dhe Transfere	1,330,996	1,390,090	1,246,943
Shpenzimet Kapitale	26,052		2,570,217
Numri i stafit	246	276	478

Tabela 2: Kufijtë e vlerësuar të shpenzimeve për KASH- in 2011-2013

	2010 Rishikuar	2011	2012	2013
Totali	8,376,505	9,574,561	9,405,810	9,657,810
Paga dhe shtesa	2,133,151	3,051,744	3,051,744	3,051,744
Mallra dhe shërbime	2,426,194	2,553,267	2,564,066	2,564,066
Subvencione dhe Transfere	1,246,943	1,390,000	1,390,000	1,390,000
Shpenzime Kapital	2,570,217	2,579,550	2,400,000	2,652,000
Numri i stafit	478	478	478	478

Brenda vlerësimeve të KASH-it janë përfshirë edhe dy agjensione të reja, Agjensioni për luftimin e terrorizmit dhe Agjensioni kundër krimit të organizuar, me nga 0.5mil €të cilat janë të pozicionuara në kategorinë e pagave dhe mëditjeve.

Nuk janë të përfshirë inspektoratet sanitare dhe fitosanitare komunale që pritet të transferohen nga niveli komunal në nivelin qendror në bazë të ligjit të ushqimit. Agjensioni për integritet evropian nuk është i përfshirë në këto tabela për arsye të është transferuar në Ministrinë për Integritet Evropian.

Tabela 3: Projektet kapitale në nivel të departamentit

	2010 Rishikuar	2011	2012	2013
Totali	2,570,217	2,579,550	2,400,000	2,652,000
Agjensioni i Veterinës dhe Ushqimit	2,570,217	2,579,550	2,400,000	2,652,000

Tabela 4: Nevojat për financim mbi vlerësimet për KASH 2011-2013

	2011	2012	2013
Totali	16,910,783	16,432,712	16,180,712
Shpenzimet Operative	1,788,333	1,680,712	1,680,712
Shpenzimet Kapitale	15,122,450	14,752,000	14,500,000

Kërkesa shtesë për shpenzimet operative dhe kapitale mbi kufirin e vlerësuar është vetëm të AVU, ku në bazë të Ligjit të Ushqimit 03-L-016 Inspektorati Sanitar dhe ai Fitosanitar komunale duhet të transferohet në këtë agjension, ku afërsisht 125 punëtorë duhet të kalojnë në nivelin qendror.

Ndërsa kërkesa shtesë për shpenzime kapitale prej 12.mil euro është kërkesë për donatorët .

MINISTRIA E EKONOMISË DHE FINANCAVE

I. Misioni

Misioni i Ministrisë së Ekonomisë dhe Financave është sigurimi i menaxhimit të përgjegjshëm të drejtë dhe transparent të fondeve publike, dhe të këshillojë Qeverinë e Kosovës lidhur me politikat e saj ekonomike dhe fiskale.

Përmirësimi i standardit të jetesës për të gjithë njerëzit në Kosovë, përmes përkrahjes së një mjedisi stabil të shëndoshë për investime, zhvillim ekonomik të qëndrueshëm dhe me bazë të gjerë.

Monitorimin dhe raportimin për ngjarjet ekonomike dhe forcat që ushtrojnë ndikimin e tyre në Kosovë.

Do të zhvillojë dhe zbatojë politika të shëndosha makro-ekonomike në bashkëveprim me Kuvendin e Kosovës, ministritë tjera, institucionet huadhënës ndërkombëtare dhe donatorët.

II. Gjendja e aktuale

Ministria e Ekonomisë dhe Financave është duke analizuar dhe siguruar parashikimet e zhvillimeve makroekonomike, përgatitjen e dokumenteve kryesore buxhetore, strategjinë ekonomike dhe të gjitha politikat ekonomike dhe fiskale të Qeverisë.

Përmes kontributit të lartë profesional në shqyrtimin që u bënë Qeveria programeve shpenzuese, Ministria është duke punuar në planifikimin e buxhetit të Kosovës si mjetin kyç strategjik të Qeverisë për planifikimin dhe alokomin e resurseve, duke arritur para shikueshmërinë, drejtësinë dhe përgjegjshmërinë në financat publike dhe duke përmirësuar dukshëm cilësinë dhe efikasitetin e kostos së shërbimeve.

Dogana e Kosovës është duke u zhvilluar në mënyrë progresive, në kontrollin e të hyrave, ngritjen dhe zhvillimin e sistemeve, promovimin në komunikim dhe bashkëpunimin me komunitetin e biznesit, ndërtimin dhe profesionalizimin e kapaciteteve njerëzore, inteligjencën, hetuesinë dhe elementet anti-kontrabandë, politikën dhe njësitë ligjore së bashku me funksionet e drejtorisë qendrore.

Gjatë kësaj periudhe është duke u realizuar delegimi i shpenzimeve buxhetore nëpër organizata buxhetore.

MEF-i është duke siguruar të ardhura të parashikueshme të Qeverisë, përmes zbatimit efikas, të frytshëm dhe të drejtë të sistemit transparent, të detyrueshëm dhe të menaxhueshëm të taksave, që është i favorshëm për zhvillimin stabil me bazë të gjerë të sektorit privat, aktualisht ka të punësuar 1,496 punonjës në ministri dhe së shpejti pritet punësimi i 83 punonjësve të tjerë.

III. Objektivat Strategjike

- i. Sigurimi i praktikave më të mira në menaxhimin e fondeve publike,
- ii. Ruajtja e stabiliteti makroekonomik të Kosovës duke fuqizuar politikat të cilat sigurojnë një rritje të qëndrueshme ekonomike të Kosovës,
- iii. Shfrytëzimi i fuqive dhe procedurave të Kodit Doganor dhe Kodit të Akcizave për efekt më të mirë për të përmirësuar përmbushjen dhe të lehtësojë aktivitetet ekonomike në bashkëpunim me tregtarët,
- iv. Mbledhja dhe regjistrimi i rregullt, efikas dhe i saktë i të gjitha të hyrave qeveritare (fillimi i implementimit të arkave fiskale) dhe granteve të përcaktuara të donatorëve,
- v. Përgatitjen e pasqyrave financiare dhe sigurimin që ato të jenë transparente, të sakta të dobishme dhe të kuptueshme nga shfrytëzuesit e atyre informacioneve financiare,
- vi. Përmbajtjen e standardeve ndërkombëtare të kontabilitetit, saktësisë dhe rregullsisë në llogari mbajtje dhe standardeve ndërkombëtare në menaxhimin e aseteve financiare të Qeverisë së Kosovës,
- vii. Luftimi i aktiviteteve ilegale, rritja e sigurisë përmes prezencës në pikat kufitare, luftimi i krimit kufitar, luftimi i trafikut të drogës etj .

Tabela 1: Trendët historike të financimit

	2008	2009	2010 Rishikuar
Total	182,311,294	114,718,590	36,355,957
Paga dhe shtesa	6,534,576	22,604,817	9,442,593
Mallra dhe shërbime	10,299,263	14,119,553	10,182,596
Subvencione dhe Transfere	1,612,000	1,594,800	3,196,516
Shpenzimet e Kapitale	133,274,235	17,484,395	13,534,252
Rezerva	30,591,220	58,915,025	
Numri i stafit	1,432	1,474	1,572

*Në tabelën e lartë shënuar për vitin 2008 – 2010 është përfshirë edhe buxheti i Doganave të Kosovës.

Tabela 2: Kufijtë e vlerësuar të shpenzimeve për KASH- in 2011-2013

	2010 Rishikuar	2011	2012	2013
Totali	36,355,957	87,524,205	59,134,335	53,634,335
Paga dhe shtesa	9,442,593	15,951,423	15,951,423	15,951,423
Mallra dhe shërbime	10,182,596	8,149,631	8,385,727	8,385,727
Subvencione dhe Transfere	3,196,516	4,894,800	4,894,800	4,894,800
Shpenzimet e Kapitale	13,534,252	58,528,351	29,902,385	24,402,385
Numri i stafit	1,572	1,572	1,572	1,572

Shpenzimet operative për vitin 2011 janë vlerësuar më të mëdha për arsye të zbatimit të ligjit mbi shërbyesit civil që parashihet të kushtoj 6.5 mil, ligji për depozita nga 3.3 mil për tri vitet e ardhshme. Ndërsa në kapitale është për shpronësim të autostradës Merdar – Morinë ku janë të përfshira 50 mil. në 2011, 20 mil. në 2012 si dhe 14 mil. në 2013, për bashkfinacim me IPA janë paraparë 5 mil.

Duhet cekur se këtu nuk është i përfshire buxheti i Njesisë për politikat dhe monitorimin e ndërmarrjeve publike.

Tabela 3: Projektet kapitale në nivel të departamentit

	2010 Rishikuar	2011	2012	2013
Totali	13,534,252	58,528,351	29,902,385	24,402,385
Administrata Qendrore	733,890	317,395	317,000	817,000
Administrata Tatimore	934,377	1,396,687	2,191,392	2,191,392
Doganat e Kosovës	1,734,733	1,740,000	2,318,993	2,318,993
Shpronësimi për Autostradën Merdar - Morinë	5,890,434	50,000,000	20,000,000	14,000,000
Bashkëfinancim me IPA	3,672,342	5,000,000	5,000,000	5,000,000
Thesar	68,476	74,269	75,000	75,000
Fondi për Mitrovicën e Veriut	500,000			

Tabela 4: Nevojat për financim mbi vlerësimet për KASH 2011-2013

	2011	2012	2013
Totali	5,308,419	8,685,830	9,232,435
Shpenzimet Operative	4,564,018	4,584,018	5,094,018
Shpenzimet Kapitale	744,401	4,101,812	4,138,417

Kërkesa shtesë është për shpenzime operative të ndryshme kryesisht në administratën tatimore, në administratën qendrore si dhe në doganë, ndërsa kërkesa për shpenzimet kapitale është për disa projekte të vogla kapitale.

Projektet të cilat priten të financohen nga Institucionet Ndërkombëtare janë:

Ndërtimi i linjës 400KW Prishtinë – Tiranë 240 KM – 17 mil. kredi dhe 16.5 mil. grant, si dhe

IDA – Modernizimit i Sektorit Publik- 2.3 mil. kredi si dhe 2.7 mil. grant.

MINISTRIA E PUNËVE TË JASHTME

I. Misioni

Misioni i Ministrisë së punëve të Jashtme (MPJ) është formulimi dhe zbatimi i politikës së jashtme të Republikës së Kosovës, më saktësisht kjo Ministri është përgjegjëse për zhvillimin dhe bashkërendimin e politikave në raport me shtetet e tjera. Në këtë kontekst MPJ mbron dhe përfaqëson interesat e Republikës së Kosovës në raport me shtetet tjera dhe organizatat ndërkombëtare, në bashkërendim të plotë me ministrinë e tjera, varësisht nga kompetencat e tyre.

II. Gjendja aktuale

Kjo Ministri ka nisur funksionimin efektiv nga data 15 qershor 2008, pas hyrjes në fuqi të Ligjit për Ministrinë e Punëve të Jashtme dhe Shërbimin Diplomatik të Kosovës. Si e tillë, është në proces të konsolidimit intern, ku aktualisht ka të punësuar 90 punonjës në ministri dhe së shpejti pritet punësimi i punonjësve të tjerë brenda Ministrisë (edhe 15 pozita të reja) janë në proces. Ministria përfshin nëntëmbëdhjetë misione diplomatike, që janë themeluar gjatë vitit 2008 -2010.

Gjithashtu janë në proces të themelimit edhe trembëdhjetë përfaqësi konsullore. Numri i stafit në misione diplomatike dhe konsullore momentalisht arrin në 92, prandaj duhet të planifikohet rekrutim i stafit shtesë me hapjen e misioneve të reja të pasqyruara më poshtë.

III. Objektivat Strategjike

i. Lobimi dhe aktivitetet diplomatike për intensifikimin e njohjeve të shtetit të Kosovës dhe për përshpejtim të anëtarësimit në organizatat politike dhe financiare ndërkombëtare.

- a) Pjesëmarrja në konferenca ndërkombëtare,
- b) Pjesëmarrja në nisma rajonale,
- c) Dhënia e mbështetjes dhe përgatitja e procedurë për aplikim për pranim në organizatat e caktuara,
- d) Organizimi i konferencave dhe forumeve të ndryshme.

ii. Vazhdimi i ndërtimit dhe funksionalizimi i Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe Shërbimit Diplomatik të Kosovës

- a) Ministria e Punëve të Jashtme si institucion formulues dhe implementues i politikës së Jashtme të Republikës së Kosovës synon që në periudhën e ardhshme trevjeçare të hapë edhe disa misione diplomatike dhe konsullore. MPJ planifikon hapjen edhe të përafërsisht 12 (dymbëdhjetë) misioneve diplomatike si dhe 5 (pesë) misioneve konsullore shtesë,

- b) Ministria e Punëve të Jashtme gjithashtu synim në periudhën e ardhshme trevjeçare ka edhe hapjen e akademisë diplomatike e cila do të ketë rol kyç në sigurimin e vazhdimësisë profesionale të stafit të ministrisë dhe atij në shërbim,
- c) Krijimi në vazhdimësi i infrastrukturës ligjore,
- d) Rekrutimi i personelit, riorganizimi i strukturave të sektorit dhe konsolidimi i shërbimit diplomatik dhe konsullor.
- iii. Promovimi i interesave ekonomike të Kosovës në botë dhe tërheqja e investimeve të jashtme në vend dhe integrimi në proceset Euro-Atlantike.
- a) Hulumtimi i procedurave të anëtarësimit në institucionet financiare ndërkombëtare (në Bankën Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim), dhe në institucionet ekonomike ndërkombëtare si në Organizatën Botërore të Tregtisë, dhe në një fazë të mëvonshme, aplikimi për anëtarësim,
- b) Hartimi i strategjive për tërheqjen e investimeve të huaja dhe hartimi i materialeve informuese siç janë informatorët, broshurat dhe/ose materiale tjera të ngjashme,
- c) Ofrimi i ndihmës për bizneset vendëse rreth promovimit të produkteve dhe shërbimeve jashtë vendit,
- d) Organizimi i panairëve dhe konferencave ekonomike, si dhe i vizitave studimore brenda dhe jashtë vendit,
- e) Plotësimi i veprimeve të veçanta që dalin nga Plani i Veprimit të Partneritetit Evropian,
- f) Pjesëmarrja në forumet e ndryshme lidhur me procesin e anëtarësimit në NATO.
- iv. Marrëveshjet dy dhe shumëpalëshe.
- a) Hulumtimi dhe krijimi i procedurave për nënshkrimin e marrëveshjeve ndërkombëtare,
- b) Hulumtimi i procedurave për anëtarësim në institucionet politike ndërkombëtare, si në Organizatën e Kombeve të Bashkuar, përgatitjen e aplikimit për anëtarësim në këtë organizatë,
- c) Inicimi i marrëveshjeve ndërkombëtare, në veçanti i marrëveshjeve dypalëshe për heqjen e regjimit të vizave,
- d) Inicimi i marrëveshjeve të mundshme për investime të huaja në vend.

Tabela 1. Trendët historike të financimit

	2008	2009	2010 Rishikuar
Total	2,300,000	24,739,107	26,001,554
Paga dhe Mëditje	313,757	2,646,793	2,761,566
Mallra dhe Shërbime	1,636,243	9,052,014	10,657,298
Subvencione dhe Transfere	50,000	0	0
Shpenzimet Kapitale	300,000	13,040,300	12,582,690
Numri i stafit	80	211	211

Tabela 2. Kufijtë e vlerësuar të shpenzimeve 2011-2013

	2010 Rishikuar	2011	2012	2013
Total	26,001,554	23,186,047	23,123,731	23,373,731
Paga dhe Mëditje	2,761,566	2,783,940	2,783,940	2,783,940
Mallra dhe Shërbime	10,657,298	10,898,786	10,939,791	10,939,791
Shpenzimet Kapitale	12,582,690	9,503,321	9,400,000	9,650,000
Numri i stafit	211	211	211	211

Nga tabela e më sipërme vërehet që vlerësimet për shpenzimet operative në periudhën 2011-2013 mbeten afërsisht të njëjta me vitin 2010, kurse nga investimet kapitale që MPJ vazhdon të financoj është blerja e ambasadave dhe projekteve që janë në vazhdim.

Tabela 3. Projektet kapitale në nivel të programit

	2010 Rishikuar	2011	2012	2013
Total	12,582,690	9,503,321	9,400,000	9,650,000
Administrata Qendrore	974,529	1,098,500	1,106,500	1,052,700
Ambasadat	11,608,161	8,404,821	8,293,500	8,597,300

*Shënim: Me buxhetin e vitit 2010 janë ndarë mjetet me vlerë prej 7.9 milion € për Ambasadat, me ligjin e buxhetit për vitin 2010 është e paraparë me një nen të veçantë bartja e mjeteve të pashpenzuara nga viti 2009. Shuma e pashpenzuar për këtë projekt është në vlerë prej 5 milion €

Tabela 4. Nevojat për financim mbi kufirin buxhetor 2011-2013

	2011	2012	2013
Total	41,273,527	35,246,619	40,013,245
Shpenzimet operative	28,033,348	32,555,118	37,635,545
Shpenzimet kapitale	13,240,179	2,691,501	2,377,700

Në vlerësimet për periudhën 2011-2013 nuk është përfshirë kërkesa për rritje e stafit të brendshëm dhe atij të jashtëm (për vitin 2011 numri 287 punëtorë, për vitin 2012 numri 385 punëtorë si dhe për vitin 2013 numri 390 punëtorë), si dhe shtesat për stafin e ambasadave që Ministria e Punëve të Jashtme ka paraparë.

Kërkesa e MPJ nuk ka mundur të plotësohet tërësisht as në kategorinë e Shpenzimeve kapitale sikurse që janë blerja e Ambasadave, Ndërtimi i Akademisë Diplomatike, etj.

MINISTRIA PËR INTEGRIME EVROPIANE

I. Misioni

*Koordinimi dhe orientimi i veprimeve të Qeverisë së Republikës së Kosovës në çështjet e procesit të Integrimit Evropian dhe politikat e zhvillimit me qëllim të lehtësimit në përafrimin e praktikave dhe aktiviteteve legjislative të Qeverisë me prioritetet e parapara në Planin e Veprimit për Implementimin e Partneritetit Evropian si dhe dokumente të tjera strategjike të Integrimit Evropian, si dhe bashkërendimi i mekanizmave të koordinimit me Donatorë, duke mos ndikuar në përgjegjësitë dhe mandatet sektoriale të Ministrive dhe institucioneve tjera publike.

II. Gjendja aktuale

Kosova në vitin 2010 ka thelluar dialogun teknik dhe politik me Komisionin Evropian përmes Dialogut të Procesit të Stabilizim Asociimit, (përmes të cilit mbahet dialogu Qeveria e Kosovës – Komisioni Evropian me qëllim të reformës institucionale, legjislative, ekonomike dhe sociale), qasjes më të madhe në programet e Komunitetit, dhe marrëveshjes tregtare me Bashkimin Evropian. Pjesë e rëndësishme e këtij procesi janë Partneritetet Evropiane dhe Raportet e Progresit. Koordinimi i donacioneve është jashtëzakonisht i rëndësishëm me qëllim të rritjes së produktivitetit ekonomik të vendit dhe përmirësimit të standardit të jetës.

III. Objektivat Strategjike

- i. Menaxhimi efektiv i procesit të Dialogut të Stabilizim Asociimit,
- ii. Koordinimin Efektiv i ndihmës së jashtme,
- iii. Ngritja e kapaciteteve institucionale dhe komunikim informimi,
- iv. Koordinimi i përafrimit dhe përkthimit të legjislacionit.

Tabela 1: Trendët historike të financimit

	2008	2009	2010 Rishikuar
Total	393,107	305,145	658,883
Paga dhe shtesa	70,063	113,424	257,465
Mallra dhe Shërbime	113,000	191,721	327,063
Subvencione dhe Transfere			0
Shpenzimet Kapitale	210,044		74,355
Numri i stafit	21	34	77

* Këtu është i paraqitur buxheti i Agjencionit për Integritet Evropian që ka qenë në kuadër të Zyrës së Kryeministrit.

Tabela 2: Kufijtë e vlerësuar të shpenzimeve për KASH- in 2011-2013

	2010 Rishikuar	2011	2012	2013
Total	658,883	1,811,520	1,811,520	1,811,520
Paga dhe shtesa	257,465	268,985	268,985	268,985
Mallra dhe shërbime	327,063	1,342,535	1,342,535	1,342,535
Subvencione dhe Transfere	0			
Shpenzimet Kapitale	74,355	200,000	200,000	200,000
Numri I stafit	77	77	77	77

Rritja e buxhetit për tri vitet e ardhshëm është për arsye se kjo ministri është në formim e sipër. Mjetet e ndara për shpenzimet operative që kanë të bëjnë me mbulimin e shpenzimeve në mallra dhe shërbime dhe për arsye të rritjes së numrit të punëtoreve për 43 punëtore shtese. Ndërsa kërkesa për shpenzime kapitale është kryesisht për blerje të veturave.

MINISTRIA PËR KOMUNITETE DHE KTHIM

I. Misioni

Misioni i Ministrisë për Komunitete dhe Kthim (MKK-së) është që të promovojë krijimin e kushteve të përshtatshme për realizimin e procesit të kthimit, si dhe të sigurojë një qasje ndaj kthimit që bazohet në të drejta.

Roli i MKK-së është që tu ofrojë shërbime sa me të mira qytetarëve për çështje të realizimit të drejtave dhe kthimit, të jetë partner aktiv dhe i besueshëm i komunitetit ndërkombëtar, si dhe krijimi i sigurisë dhe besueshmërisë në institucionet vendore.

Ministria për Komunitete dhe Kthim zhvillon dhe përparon qëllimet në zbatimin e ligjshmërisë për mbrojtjen e të drejtave të bashkësive etnike dhe përkatësive të tyre, duke përfshirë edhe të drejtën për kthim, integrimin e barabartë në të gjithë komunitet dhe anëtarët e përkatësive të ndryshme të cilat momentalisht jetojnë në Kosovë, përkatësisht pikat 3 dhe 4 të Kornizës Kushtetuese, krijon kushte të favorshme për kthim dhe siguron qasjen në kthim i cili është i mbështetur në të drejtën për kthim.

II. Gjendja aktuale

Ministria për Komunitete dhe Kthim (MKK) është ministri relativisht e vogël me mandat për të koordinuar çështjet që kanë të bëjnë me komunitetet dhe kthimin e personave të zhvendosur. Për shkak të ndjeshmërisë politike të agjendës, MKK është në mesin e atyre ministrive që janë formuar me vonë përkatësisht në janar të vitit 2005, është cilësuar si një hap i rëndësishëm drejt kalimit të përgjegjësive për komunitete dhe kthim të lidershipi vendor.

Qeveria e Kosovës është e përkushtuar për një shoqëri multietnike, dhe zotohet për përkrahjen e vazhdueshme për integrimin e komuniteteve, qëndrimin dhe kthimin e qëndrueshëm të gjithë të zhvendosurve. Themelimi i një Ministrie të veçantë përgjegjëse për çështje të komuniteteve (minoriteteve) dhe kthim (vullnetar) i personave të zhvendosur reflekton rrethanat politike në Kosovën e pas vitit 1999.

Duke pasur parasysh faktin se mijëra qytetare të Kosovës janë të zhvendosur dhe shpesh jetojnë në kushte të renda dhe shumica e tyre janë të strehuar nëpër qendra kolektive.

Ministria për Komunitete dhe Kthim bënë sigurimi e qëndrueshmërisë ekonomike dhe sociale për të kthyerit, është shumë i rëndësishëm si dhe përkrah 4 kushtet bazë për të siguruar qëndrueshmërinë e kthimit, ato janë: Siguria dhe lëvizja e lirë, Qasja në shërbimet publike (në shërbimet komunale, në shërbimet sociale, në arsim, dhe në përkujdesjen shëndetësore), Qasja në strehim, (nëpërmjet riposedimit të efektshëm të pronës, apo ndihmës në rindërtimin e shtëpive, në ato raste kur është e nevojshme), dhe Realizueshmëria ekonomike përmes qasjes së drejtë dhe të barabartë të mundësive për punësim.

III. Objektivat Strategjike

Për realizimin e objektivave të saj MKK-e fokusohet në tri synime:

i. Komuniteti stabil.

Fuqizimi dhe Stabilizimi i Komuniteteve në Kosovë, të drejtave të tyre, sigurimi dhe pjesëmarrja në shoqërori dhe qasja e tyre në të gjitha shërbimet publike, sigurimi i zbatimi i ligjit aktual për komunitete.

ii. Kthimi i qëndrueshëm dhe reintegrimi ekonomik i komuniteteve.
Kthimi i qëndrueshëm i personave të zhvendosur nga Kosova, sigurimi i mbështetjes për të gjithë të kthyerit, mbështetja për zhvillim ekonomik si një parakusht kryesor për stabilizimin e komuniteteve dhe kthimit të qëndrueshëm, sigurimi i kushteve adekuate për integrimin në shoqëri.

Tabela 1: Trendët historike të financimit

	2008	2009	2010 Rishikuar
Totali	9,118,553	8,707,057	8,050,088
Paga dhe Mëditje	401,189	351,618	402,544
Mallra dhe Shërbime	658,931	555,439	499,914
Subvencione dhe Transfere	536,622	300,000	300,000
Shpenzimet Kapitale	7,521,811	7,500,000	6,847,630
Numri i stafit	117	117	104

Tabela 2: Kufijtë e vlerësuar të shpenzimeve për KASH-in 2011-13

	2010 Rishikuar	2011	2012	2013
Total	8,050,088	8,641,476	8,755,373	8,855,373
Paga dhe shtesa	402,544	413,015	416,690	416,690
Mallra dhe shërbime	499,914	538,683	538,683	538,683
Subvencione dhe Transfere	300,000	300,000	300,000	300,000
Shpenzimet Kapital	6,847,630	7,389,778	7,500,000	7,600,000
Numri i stafit	104	104	104	104

Në tabelën 2. shihet se shpenzimet operative mbesin në nivel të njëjtë edhe për vitet në vijim, ndërsa shpenzimet kapitale kanë një rritje të vogël, kryesisht kjo rritje ka të bëjë me projektet për përmisimin e kushteve të jetesës dhe kthim të qëndrueshëm në Kosovë.

Tabela 3: Projektet kapitale në nivel të programit

	2010 Rishikuar	2011	2012	2013
Totali	7,426,913	7,389,778	7,500,000	7,600,000
Projekti i konsoliduar për te kthyerit	7,426,913	7,389,778	7,500,000	7,600,000

Tabela 4: Nevojat për financim mbi kufirin buxhetor 2011-2013

	2011	2012	2013
Total	34,083,348	5,950,000	6,150,000
Shpenzimet Operative	28,033,348	200,000	200,000
Shpenzimet Kapitale	6,050,000	5,750,000	5,950,000

Kërkesa shtesë mbi kufirin e vlerësuar është për projekte të ndryshme që kanë të bëjnë me ndërtimin, renovimin e ndërtesave dhe shtëpive për komunitet si dhe me rregullimin e infrastrukturës për komunitete.

MINISTRIA E ADMINISTRATËS PUBLIKE

I. Misioni

Misioni i Ministrisë së Administratës Publike është i përqendruar në Reformën e Administratës Publike me qëllim krijimi të një administrate dhe shërbimi civil të qëndrueshëm, funksional, efikas dhe profesional në zbatimin e politikave dhe ofrimin e shërbimeve cilësore, të shpejta dhe më të lira për institucionet, qytetarët, bizneset dhe shoqërinë civile në Republikën e Kosovës. Krijimin e kushteve për akomodim të administratës qeveritare, rindërtimin dhe konsolidimin e sistemit kadastral si dhe mbajtjen e Regjistrimit të popullsisë, ekonomive familjare dhe të banesave që mundëson gjenerimin e të dhënave të sakta dhe njëherazi konsolidimin e mëtutjeshëm të sistemit statistikor.

II. Gjendja e aktuale

Ndonëse Kosova tashmë ka krijuar një bazë të mirë për ndërtimin e strukturave të mirëfillta qeveritare, megjithatë mbetet ende për tu bërë. Në këtë kontekst Ministria e Administratës Publike në Kosovë, duke qenë bartëse kryesore e implementimit të Strategjisë së Qeverisë për Reformën e Administratës Publike, tashmë ka finalizuar draftimin e legjislacionit në sferën e qeverisjes administrative dhe të shërbimit civil.

Ndërkohë është në prag të finalizimit procesi i Rishikimit Funksional dhe riorganizimit të strukturës administrative, si një prej qëllimeve kyçe të Planit të Veprimit të Strategjisë mbi Reformën e Administratës Publike. Duke marrë në konsideratë ambiciet e integritimit Evropian, kjo do t'i kontribuojë qëllimit që Qeveria e Kosovës të krijojë Institucione të Administratës Publike efektive dhe efikase për të përmbushur përgjegjësit e tyre të mandatuara.

Në Kosovë, për shkak të ngjarjeve të zhvilluara gjatë historisë së saj, nuk ka pasur regjistrim të popullsisë që nga viti 1981 dhe në këtë drejtim konsiderohet nevojë imediate mbajtja e regjistrimit të popullsisë, ekonomive familjare dhe të banesave për të gjeneruar të dhëna të sakta statistikore dhe mundësi të planifikimeve strategjike në kontekst të zhvillimit ekonomik e social.

Krijimi i institucioneve të Kosovës solli edhe mungesën e hapësirës për vendosjen e punonjësve në ndërtesa qeveritare. Në këtë drejtim, sigurimi i infrastrukturës së nevojshme fizike për funksion efikas të institucioneve përmes akomodimit standard dhe të përhershëm të administratës qeveritare, konsiderohet objektive prioritare. Gjendja në Kadastrën e Kosovës nuk përputhët me gjendjen reale në terren, andaj ndihet nevojë e lartë për rindërtimin e Kadastrit në të gjitha zonat kadastrale, e veçanërisht në zonat me zhvillime të intensitetit të lartë drejt konsolidimit të mëtutjeshëm të sistemit kadastral.

III. Objektivat e Ministrisë së Administratës Publike 2011-2013

